


# HEJZA




## Salajdin SALIHU

*Letërsia s'na edukon. Për këtë punë janë çerdhet, kopshtet dhe shkollat. Brodski nuk kërkon që poeti të jetë misionar dhe as të krijojë letërsi me ndikim shoqëror. Poeti, sipas tij, ka vetëm një detyrim: të shkruajë bukur, ta krijojë poezinë – "formën më të lartë të ekzistimit të gjuhës".*

*Pēr frymēzimin, procesin krijues, kohēn...*

# LIRIA KRIJUESE QË FALË PËRJETËSINË

**Librat e Adelinës janë të jetueshëm. Kjo pasuri e vlefshme është dhurata më e bukur dhe fisnike që shkrimtarja nëpër vite i ka bërë Bibliotekës së Letërsisë përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, dhe Kulturës shqipe**



Avni HALIMI

Krijuesi i Parë tashmë kishte krijuar Hapësirën dhe Kohën! I duhej një krijim i përsosur që t'ia bëjë peshqesh këto dy krijime esenciale për jetën! Frymëzimi i Tij ishte që të sjellë diçka të bukur, të bukurën e përjetshme; ishte tërësisht i lirë që të krijojë atë çfarë i thoshte Mendja Absolute!

Pra, njeriu është rrjedhojë e Lirisë së Plotë pér ta prekur të bukurën e pérjetshme! Është e kuptueshme nevoja pér të folur pér frymëzimin si liri, si liri krijuese që të ofron gjithë mundësitë pér të arritur deri te ai frymëzim që i hap shqetësuesit pér ta krijuar të bukurën, pér të bërë art. Nëse krijuesi artistik, frymëzimin e vet e kërkon në kohë dhe në

histori, atëherë, mjerisht, kemi të bëjmë me një "frymëzim parazit", i cili, si ushujzë kapet për një trup dhe nuk shkëputet deri sa të bymehet me gjak! Pasi të fryhet, shkëputet dhe plandet në lluc! Të kërkosh frymëzinin në kohë dhe në histori, do të thotë të jesh "kopjues estetik" i ngjarjeve, "kronist estetik", do të thotë të jesh letrarizues i ngjarjeve të ndodhura, të cilat kryekëput janë politike! Jo në histori, por edhe në kohën e tashme e ke "lirinë absolute" për ta gjetur frymëzinin! Megjithatë, je i robëruar, të robëron koha dhe të nxjerr në "oborrin shëtitës" vetëm si krijues që vrapon pas aktuales. Aktualiteti është proces i kohës, është një fraksion gati i papërfillshëm i shiritit të kohës! Aktualiteti mbulohet me aktualitet dhe krijohet qio piramidë e kohës, në

majën e së cilës të pret fryshtëzimi. Sapo ta arrish atë fryshtëzin, rrënohenet dhe shkërmogenet tërë ajo piramidë dhe, nëpër ato gërmadha zhduket diku edhe vetë krijuësi!

Me kthimin e Skënderbeut në Krujë, jo vetëm që u ndalua gërryerja nëpër palçen e skeletit të identitetit kombëtar që kishte nisur shekuj e mileniume më parë, po, u përcaktua qartazi edhe orientimi perëndimor i përjetshëm i identitetit tonë kulturor. Shumë pak e tejkaluam këtë problem që ishte zgjedhur që në çastin e Kthimit të Madh! Gjashtë shekuj krijuam e u përpoqëm ta mbajmë krijimin si fakti mbi faktin që e kishte dëshmuar botërisht Skënderbeu! Tërë krijimin tonë e orientuam kah dëshmimi se jemi pro-perëndimorë, duke u vetë-shndëruar në rob të një fakti të cilin nuk na e mohonte askush, sepse argumentet të përgjithshme ishin dhe janë në anën tonë! Krijimtaria jonë artistike ngeli pa atë liri absolute veprimi siç e patëm në humanizëm (Nëna Tereze), në thellimin e njohive shkencore (Ferid Murati)!

A jemi të gatshërm që një ngjarje, natyrish, si fiksion, por, pse jo, edhe me brumë të reales, ta bartim në një hapësirë dhe kohë ku e gjen krejt lirinë e mundshme për t'ia falur përjetësinë krijimtarisë tënde! Një ngjarje e nxjerrë nga koha dhe historia, pas fryshtimit nga liria e shenjtë pér të krijuar në të tjera dimensione, ka sjellë krijimtari letrare të papërsërithshme, të pavdekshme, të përjetshme! Vetëm liria si fryshtim mund t'ia sjellë njerëzimit një krimi si "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", i Kadaresë, "Alkimisti" i Kohelos, "Don Kishoti" i Servantesit, "Pedro Paramo" i Rullos, "Njëqind vjet vetmi" i Markezit, "Plaku dhe deti" i Hemingueit, "Pirgu" i Teki Dërvishit, "Oh" i Anton Pashkut eti.

Kush mund ta sfidojë kohën përveçse liria krijuese! Prq, nuk po flasim për atë

liri që ta jep apo ta cungon politik! Po flasim pér atë liri që e tall edhe politikën, duke e anashkaluar dhe duke mos e përfillur fare. Një krijues i mirëfilltë e tejkalon politikën, nuk merret me të! Ky konstatim nuk e nënvlerëson Kiplingun, i cili herë pas herë hoqi dorë nga krijimtaria, duke u dhënë pas opinioneve politik. Dhe, çka ndodhi pas vdekjes së Kiplingut? Borhesi thotë se, pas vdekjes së tij, nuk ia dhamë vendin meritor krijuesi, ngaqë u ndikuam nga opinionet e tij politike. Nisëm ta gjykojmë si politik-bërës. Vetëm kur nisëm ta tejkalojmë këtë fakt, e pamë se sa i madh kishte qenë shkrimtari!

Liria që e ka krijuesi është përtej fuqisë së lirisë politike! Liria politike është vrastare, është acid që shlyen dhe zhduk gjurmët e kohës, kurse liria e krijuesit falë jetë. Prandaj, sot, njerëzimi njeh një duzinë emrash të shkrimtarëve dhe artistëve botërorë, ndërsa nuk i kujton goftë edhe tri emra të politikanëve përgjatë historisë dhe kohës!

Si krijues bëj pjesë në mesin e atyre që çdo fryshtim, gjumin, pushimin, meditimin, çdo sekondë të jetës e kanë proces krijues. Libri, si produkt final, është teknikisht, "pasojë" e këtij procesi. Kur na merr malli për Lirinë Absolute, ulemi, i sistemojmë, i shtrijmë, i palosim të gjitha materie e atij procesi dhe, ja ku del produkti final – veprai! Asnjë vepër nuk është qëllim më vetvete! Ajo del sa përtak provokuar kritikën e cila i shpluhuros dhe i mbindërton konceptet estetike, që e provokon debatin artistik! Vepra jonë artistike ka kohë që ka ngelë pa këto dy gjëra që në fakt janë eliksiri i jetëgjatësisë së krijimtarisë artistike. Pa kritikë e debat, ndaj dhe vepra mund të flejtë gjumë dhe mund të zgjohet në një epokë ku mund t'i gjejë lexuesit e vet që do të fascinohen nga krijimi i një kohë shumë të shkuar dhe, njëkohësisht, shumë të largët përkrijuesin, artistin e sotëm....

## *Nga këndi im*

# INSTINKTI I FJALE S

**Edhe pse fëmijë, unë e pata kuptuar se nëna ime fliste më bukur se të gjithë njerëzit që njihja. Përveç zërit të ëmbël dhe pësh-përitës, që në veshin tim vinte si një kompozim mahnitës, ajo vazhdimisht shqiptonte fjalë që unë nuk i dija, ose shprehje që duhej të ishin shumë të vjetra e vinin nga thellësia e kohës**

Lazër STANI

Gjuha shqipe gjithmonë më ka magjepsur në gojën e nënës time. Ditën fliste pak, merrej me punë, nuk kishte kohë as të merrete frymë. Po, ndërsa hynte e dilte në dhomën tonë të ndenjes, gjithmonë thoshte ndonjë fjalë, ndonjë shprehje, herë duke m'u drejtuar mua e herë pa iu drejtuar askujt, duke e lënë fjalën ose fjalinë pezull në ajër, në prite që dikush ta dëgjonte para se fjala ose shprehja të shuhej, të varrosej në heshtjen që lëshonin muret e trashë në atë qoshe të humbur të botës ku jetonim. Por kishte edhe raste kur nëna ulej pranë meje e bisedonte vetëm me mua, ose lëvizte nëpër shtëpi gjithë gjallëri dhe vazhdonte të më fliste, sikur donte të ndante barrën e rëndë te fiofëve me mua. Edhe pse fëmijë.

unë e pata kuptuar se nëna ime fliste më bukur se të gjithë njerëzit që njihja. Përveç zërit të ëmbël dhe pëshpëritës, që në veshin tim vinte si një kompozim mahnitës, ajo vazhdimisht shqiptonte fjalë që unë nuk i dija, ose shprehje që duhej të ishin shumë të vjetra e vinin nga thellësia e kohës, të ngjeshura e të lëmuara, si gurët e zallit të bartur prej larg, nga thellësitë e maleve. Kjo gjuhë bëhej më e gjallë dhe më e pasur kur ajo më tregonte histori, përralla të dëgjuara apo rrëfime të krijuara prej saj, me personazhe që ajo dinte t'i veçonte prej gjuhës që flisin. Fjala në gojën e saj sikur gjente vetveten, rikrijohej e shqiptohej, sikur thuhej për herë të parë. Trupi i imët dhe i brishtë i sime mëje dukej sikur ishte krijuar prej fjalëve dhe sa herë fliste, rrëfente, ose këndonte, mua më dukej se

ajo do tē shndérrohej e téra nē fjalē, e téra  
nē gjuhē, do tē shndérrohej nē gojē tē  
drurëve, gurëve, lumenjve, shkëmbinjve,  
maleve, horizontit, qellit deri sa tē tretë  
e tē shubhei kreit nē fiqlë e fundit

Ligjërimi i saj ishte i thjeshtë, i butë, muzikor, kumbues, i çlirët, i natyrshëm, magjepsës. Instinktin e fjalës, natyrisht duhet ta kem trashëguar prej saj, edhe pse gjuha ime nuk i afrohet kurrkund magjisë së gjuhës dhe aftësisë së saj të lindur për të folur e treguar bukur. Kur rri e mendoj tanë pas kaq vitesh, them me vete se ajo qe mësuesja ime e madhe e gjuhës shqipe, po jo vetëm mësuesja, po prej saj trashëgova edhe instinktin e fjalës, instinktin e përdorimit të fjalës së duhur në vendin e duhur që është edhe sekreti i parë i shkrimit letrar. Më vonë, duke patur një lidhje të fortë emocionale me fjalët, nisi të kuptoj se babai, gjyshi, nëna, por edhe njerëzit e tjerë të afërm flisnin secili nga një gjuhë më vete, kishte secili fjalët që i përdorte më shpesh, madje ishin edhe disa fjalë tekanjoze që qëndronin në majë të gjuhës si lyth e përdoreshin vend e pa vend. E njëjta gjë ndodhët edhe me shprehjet që përdoreshin nga nëna, babai, gjyshi e të tjerët. Ndërsa nëna përdorte më shpesh shprehje me bekime e lutje për të Plotfuqishmin, Krijuesin tonë, babai sillte nga mbledhjet dhe gazetat fiole, dbe shprehje të reja.

Unë gazetën tijale unë shpërtej të reja, ndërsa gjyshi, përdorte edhe ndonjë sharje a mallkim, që dukej i helmët dhe shpues, si maja metalike e shigjetave të lashta. Unë, si një dëgjues i mirë, vetëm mbaq yesh magjepseshq pas fjalëve që

ata shqiptonin, përpinqesha të mbaj mend shprehje e fjalë të reja, pyesja vazhdimiشت përfjalët që nuk ua dija kuptimin. Raporti im me fjalët ishte krejt i veçantë: kishte fjalë që më ngazëllën kur shqiptoheshin, edhe pse ato nuk kishin të bënin me mua, po kishte edhe fjalë që mezi i duroja, më dukeshin të pistë, cinike, të liga, sikur ndillnin fatkeqësi. Të tjera fjalë më dukeshin të shëmtuara, të gjyntuara, gungaçe, të rropatura e të lodhura, të rrënuara dhe të vjetruara si teshat e të varfërve të varura në tel. Ime më, edhe pse përdorte fjalë, që zakonisht i përdornin edhe të tjerët – edhe ajo fliste shqip - prapë fjalët në gojën e saj më dukeshin gjithmonë ngazëlluese, më emociononin, më krijonin ankth, ose më tronditnin, ose binin mbi mua si një frymë hyjnore dhe më magjepsnin. Në gojën e nënës sime çdo fjalë dukej e re, dukej sikur shqiptohej përfherë të parë. Nga ana tjetër, babai më merrte shpesh me vete dhe bisedonte me mua, ndërsa punonte. Herë pas here ndalej e më thoshte: "Ti i thua disa fjalë të çuditshme, fjalë që të lënë në ëndërr". Unë në përgjithësi as që e vrisja mendjen se si flisja, çfarë fjalësh përdorja. Ato vinin instinktivisht në buzë, përfshirë treguar veprime, ose thjeshtë përfshirë treguar diçka që më pëlqente.

Në shkollë ndërkaq, mësuesit më hiqnin herë pas here vërejtje se shprehesha ngatërrueshëm dhe përdorja disa fjalë e mbaresa, sipas tyre të plakura e të dala mode. Giuhë e re është po flitej në

shkollë me dukej e zbrazët dhe shpesh tingëllima e saj më kujtonte zhurmën e shëmtuar që lëshon një fuçi e zbrazur që shkon duke u përplasur nëpër gurë, ndërsa rrrokulliset teposhtë një brinje. Gjithsesi edhe në libra, edhe në shkollë, gjeja plot fjalë që më pëlqenin e lidhesha me to, por në veçanti tronditesha, kur gjeja ndonjë fjalë ose shprehje të veçantë që së pari e kisha dëgjuar nga nëna dhe kjo me çudiste: Si ka mundësi që edhe ky e paska ditur këtë fjalë të nënës sime? Më ngjante sikur dikush, i panjohur, ishte futur vjedhurazi në shtëpinë tonë dhe kishte plaçkitur fjalët tona të shtrenjtë. Sepse, në fakt, gjuha që flitej në shtëpinë tonë, ndryshonte shumë nga të gjitha gjuhët që fliteshin rrëth e rrotull, te fqinjet, miqtë, në shtëpitë e shokëve të babait, ose në shkollë. Shtëpia e fqinjëve të më për shembull, i ngjante një shtëpie xhindësh. Kjo shtëpi mund të quhet me të vërtetë shtëpia e mallkimeve. Që në mëngjes herët, pa dalë ende dielli, dëgjoheshin mallkime që shqiptoheshin me zë të lartë e që vazhdonin gjithë ditën e ditës: qenit që lehte në qejf të vet apo i sapozgjuar nga një èndrrë me rivalë, i klithnin "Pusho, të preftë ujku në Sh'Ndre", vajzës që flinte ende i thërrisin "Çohu, fjetsh gjumin e madh!", plakut që ankohej për re umën ia prisnin "Mos e cilëtë drita nesër se na çmendi". Mallkime të tjera si "I thaftë krahi, si i ka tha", "E shoftë kolera", "Mos e pruftë kryet", "I rëntë pika", "E marroftë Zoti", "I humbtë fara", "Treti Zo'farën", "Mos u rritsh ma i madh", "E përpiftë dhei", dëgjoheshin gjithandje dhe mua më bënte përshtypje se ku i gjenin të gjitha këto fjalë për të mallkuar, ndërkohë që fjalët e dashurisë ishin më të pakta e përdoreshin më rrallë, shqiptoheshin me ndruajtje dhe me një ndjenjë fajësie, sikur dashuria të ishte "molla e ndalume" përgjithmonë dhe njerëzit të kishin frikë të bënin mëkatin e dytë të madh. Ndërsa rritesha, unë pyesja për fjalët që nuk i kuptoja dhe gjyshi herë pas here ma priste: "Çe don. Nuk është fjalë e hajrit". Thoshtë kështu sidomos për fjalët që po sillte civilizimi i fshatit, termat e rinx që sillnin të ardhurit nga qyteti, mësuesit, gazeta dhe radioja. Po unë doja t'i kuptoja të gjitha fjalët dhe me gjithë zemërimin e gjyshit, prapë vija rrotull pa e hequr nga mendja fjalën e re, pyesja në - nën ose babain, dhe kur mbetesha pa përgjigje, pyesja edhe mësuesit në shkollë, të cilët, edhe pse më përgjigjeshin, me siguri mendonin me vete: "Diçka nuk është në rregull me këtë djalë". Unë, ndër kaq po rritesha midis një babilonie gjuhësh: gjuhës që dëgjoja në shtëpi, gjuhës që dëgjoja në fshat dhe gjuhës së re, asaj që dëgjoja në shkollë e që, s'do mend, duhej të ishte gjuhë e qytetërimit të ri, edhe pse njëherë desh e hëngra për shkak të kësaj gjuhe. Se nga më ishte fiksuar dhe përdorja vend e pa vend shprehjen "ku vete?". Njëherë babai më kë qyri me çudi dhe pastaj, si u vërenjt në ftyrë, tha kërcënueshëm: "Mos ta dëgjoj më atë fjalë". Pas disa ditësh, unë e përdorja prapë pa dashje të njëjtën shprehje dhe atëherë babai më kapi për veshi dhe ma shkuli fort, duke më kërcënuar me fjalë edhe më të ashpra. "Fol si njeri, më tha. Ndryshe do t'i kesh punët keq me mua".

Përpjekja ime për qytetërim gjuhësor kiske përfunduar keq, ashtu siç kishin përfunduar keq edhe përpjekjet për qytetërim të shumë paraardhësve të mi, të cilët, sa herë shkonin e vinin nga qyteti sillnin edhe ndonjë fjalë të re, fjalë të qytetërimit të atëherëshëm, që fatkeqësish, ishte qytetërimi i një qyteti të pushtuar nga otomanët për shekuj me radhë. Edhe pse të krishterë, që e kishin ruajtur besimin dhe lirinë e tyre, duke u ngjujar mes maleve, prapë ata ishin ndotur nga pushtimi. Në klasë të shtatë bëra një listë të gjatë të fjalëve turke, arabe, perse që përdoreshin në fshat, fjalë që ishin sellë sigurisht nga qyteti, se fshati nuk që pushtuar kurrë. Vendosa të hakmerrem me babain, që përdorte shpesh fjalë turke kur fliste sidomos kur donte të tallej, ose



kur donte të dukej i veçantë. Ithashë se ai nuk duhej të përdorte më fjalë të tillë si "penxhere, hava, sabah, akshan, sevap, zaman, bujrum, hoshgjelden", etj., sepse ato janë fjalë turke. "Ku te shkon mendja edhe ty. Turqit na e kanë marrë të keqen ka herë", tha babai, duke me këqyrur i çuditur, qortueshëm. Mua më dukej se turqit me qallma të kuqe ishin ende këtu, të struktur në ato fjalë që kur e kur i përdorte edhe babai. Ai që mësuar me ato fjalë, të ardhura prej shekuish, të futura ilegalisht në shtëpinë tonë, si krimba që gjerryjnë trarët dhe hatullat e vjetra që mbajnë çatinë e rëndë të mbuluar me rrasa guri. Turqit vetë nuk patën arritur të hynin me ushtarët, po me fjalët e tyre po, kishin ardhur si "qytetërim", duke vdekur e varrosur fjalë të mëparshme të shqipes. Pushtimi nuk sjell vetëm dhunë dhe shtypje. Ai sjell ndotje, ndotje në shpirt, ndotje në fjalë, ndotje në gjuhë e kjo sjell edhe ndotje në mendim e në ndjenjë. Edhe ata shqiptarë që kishin mundur të qëndronin, të mos nënshtroheshin, të jetonin të lirë dhe të ruanin besimin e tyre, fenë e tyre, prapë ishin ndotur në shekujt e gjatë të pushtimit. Kontakti me qytetin e pushtuar, nevojën e vazhdueshme të njeriut për informacion dhe qytetërim, e kishte ushqyer me ndotje dhe kur e zbulova këtë, sa herë i dëgjoja këto fjalë më krijohej ndjesia se isha duke pirë ujë të fëlliur nga i njëti pellg ku pinin edhe lopët ose shqipëshin derrat. Gjithsesi neveria nuk rraffon për të shmangur ndotjen gjuhësore.

Adolfo Bioy Casares në tregimin e tij të njohur "Për të kujtuar Paulinën" na flet për një ndotje tjetër gjuhësore, përmënyrën se si ne i ndotim gjuhën njeri-tjetrit, se si një marrëdhënie dashurie, ose urrejtjeje është edhe një lidhje e ngushtë gjuhësore, ku të folurit, ose ndotet, ose përtërihet. Me sa duket, gjuha ashtu sikurse teshat që veshim, është në kontakt të përditshëm me qindra ndotje dhe ne duhet të kujdesemi për pastërtinë e saj çdo orë, çdo ditë. Gjuna shkallmohet nga zhargoni i rrugës, nga barbaria e mediave dhe sidomos nga shkrimi i keq letrar. E

theksoj "shkrimi i keq letrar" sepse, sikurse shprehet Anton P. Çehov "shkrimtar para së gjithash është gjuhë", sepse letërsia nuk e ka gjuhën thjeshtë mjet, lëndë, por mbi të gjitha e ka pasion, ndjenjë, shpirt. Nga kjo pikëpamje ka të drejtë Josif Brodski kur shkruan se "për shkrimtarin ekziston vetëm një formë patriotizmi: qëndrimi i tij ndaj gjuhës". Mungesa e këtij patriotizmi gjuhësor krijon shkrimin e keq letrar, që sjell ndotjen e vazhdueshme gjuhësore, shtrembërimin dhe varfërimin e saj, humbjen e gjallërisë dhe shterrimin e aftësive shprehëse. Por shkrimi i keq letrar (nuk po përdor termin "shkrimtar" që e përdorin disa shkrimtarë që e trajtojnë shkrimin letrar si zeje) nuk vjen vetëm nga mungesa e patriotizmit gjuhësor, sepse shumica e shkrimtarëve, jo vetëm kanë një lidhje emocionale me gjuhën në të cilën shkruajnë, por edhe përpinqi ta pasurojnë gjuhën e shkrimit, të krijojnë e shtojnë fjalë të reja, të shkriptojnë sintaksën, të sjellin kuptime e nuanca të reja te fjalët. Pothuajse në çdo bibliotekë shkrimtar serioz gjen fjalorë të rinj e të vjetër të gjuhës dhe fletore ku janë shënuar fjalë të rralla, fjalë të humbura, fjalë e shprehje të zbuluara rastësisht prej tij gjatë një bisede në udhëtim, ose gjatë shfletimit të një libri të vjetër. E megjithatë gjatë shkrimit të keq letrar, gjuha lëngon, shtrydhet, rrudhoset, zhuravitet, zvetënohet, humbet fuqinë shprehëse dhe kënaqësinë e komunikimit. Tek disa shkrimtarë të zellshëm, shkrimi i keq letrar, i ngjan një tabloje, ku edhe pse janë përdorur të gjitha ngjyrat dhe kombinimet e mundshme të tyre, prapë kemi një njollosje pa shije dhe të rrëmuishme që ngjan më shumë me një derdhje të shëmtuar ngjyrash. Për më tepër, në një shkrim të tillë të keq letrar, fjalët duken të vjetra, të shumëpërdorura, të pajeta, ngjajnë me rrobat e frikshme të të vdekurve. Çdo krijim letrar është edhe një kriesë e re gjuhësore, është një gjuhë e re, e pashqiptuar dhe e padëgjuar më parë. Kjo është dhuntia e letërsisë, magjia e krijimit, misteri i pashpjegueshëm i shkrimit, që në fund të fundit lidhet me instinktin e fjalës. Është

shumë i njohur fakti, që disa fëmijë, jo vetëm flasin shpejt, po edhe na mahnitin me fjalët që thonë, me fjalitë që shqiptojnë, kur ata nuk dinë ende as shkrim dhe këndim dhe kur nuk kanë lexuar kurrë një libër. Janë thjeshtë fëmijë "të lindur me gojë". Më këtë instinkt të lindur gjuhësor, me këtë prirje të mbinatyrorë për fjalën, lidhet edhe aftësia e krijimit letrar, të shprehur në një gjuhë gjithmonë të re.

Shqipja, si një ndër gjuhët me të vjetra, u krijua si gjuhë jo nëpërmjet shkrimit letrar (shkrimi i saj është fatkeqësish i vonë), po nëpërmjet këtyre fëmijëve "të lindur me gojë" që gjatë mijëra vjetëve shprehën në shqip ndjenjat e tyre, ankthet vizionet, éndrrat, shpresat. Dhe arritën të krijojnë një gjuhë të jashtëzakonshme. Gjuna e Konicës, Naimit, Fishtës, Mjedës, Nolit, por edhe shkrimtarëve dhe përkthyesve të tjerë shqiptarë të shekullit të njëzetë nuk erdhë si një rastësi dhe as falë gjenisë së tyre gjuhësore. Kjo gjuhë tashmë ishte krijuar prej shekuish, por ata mundën, falë instinktit të tyre të lindur për fjalën, të shprehën në shqip, duke e çluar këtë "gjuhë të Perëndisë" me aq sa mundën nga ndotjet dhe barbaritë gjuhësore. Është e padiskutueshme se, ashtu si instinkti seksual i ka paraprirë ndjenjës së dashurisë, instinkti i fjalës i paraprin gjithmonë dashurisë për gjuhën. Dante Aligeri në njëren prej këngëve të tij ka një varg të pavdekshëm: „Donne ch'avete l'intelletto d'amore“ („Gra që e keni intelektin e dashurisë“ Vita Nova, XIX). Me këtë varg ai i ndan gratë në dy kategorit, në gra që e kanë intelektin e dashurisë dhe në gra që nuk e kanë këtë intelekt, pavarësisht se të gjitha gratë e kanë instinktin e seksit. Shkrimit të keq letrar, si një nga kërcënimet më të mëdha për çdo gjuhë, duke i munguar instinkti i fjalës, i mungon edhe intelekti i gjuhës edhe ndjenja e dashurisë për gjuhën. Në shkrimin e keq letrar, gjuha vjen duke u tkurrë, duke humbur fuqinë dhe freskinë, natyrshëmërën dhe lirizmin, ndjenjën dhe intelektin.

Nënshtrimi i vazhdueshëm ndaj shkrimit të keq letrar e çon një gjuhë drejt ndrydhjes, plakjes, vdekjes. Ndryshtë nga c'ndodhët në të shkuarën, kur ndotjet, barbarizmat gjuhësorë dhe shkrimi i keq letrar, nuk arrin të shkatërronin gjuhën e komuniteteve të izoluar, sot, kur fjalë mund të shtegtojë brenda një çasti të vetëm nga kompjuteri im deri në skajin më të largët të globit, gjuhët janë me të vërtetë të kërcënuara. Nëse gjuha e nënës sime ishte e mbrojtur jo plotësisht, gjuha ime është krejtësisht e zbuluar, kërcënohet jo vetëm nga gjuhët e tjera që po globalizohen, po edhe nga zhargoni i rrugës, gjuha shterpë e mediave që të bombardon çdo orë, shkrimi i keq letrar që të përndjek nga të gjitha anët: në poezi, në prozë, në teatër, në përkthime, kudo. Atëherë, pra, si do të shpëtohet gjuha ime? Sa herë mendoj i shqetësuar për këtë, them me vete se, nëse ka një shpëtim, ky është instinkti i lindur i fjalës dhe zëri i nënës, që më pëshpërit në vesh edhe sot e kësaj dite në gjuhën e saj të dliës shqipe si dhe lidhja shpëtore me gjuhën e atyre shqiptarëve të hershëm që lindën, u rritën e vdiqën në një rrëthim të pashpresë të mbyllur fort pas fjalës shqipe dhe besimit. Këta anonimë të historisë, duke pasur si dhundi të lindur instinktin e fjalës, çka me sa duket ua bënte më të lehtë dhe më të kuptimit qenien në këtë jetë të pashpresë, të mbushur me vuajtje dhe dhimbje, e sollën shqipen e bukur deri te unë dhe e shndërruan atë në gjuhë të éndrrave të mia, në gjuhë të ekzistencës sime. Gjuna e tyre gjithmonë më ka kujtuar gjuhën e Biblës, gjuhën më të përkryer të përdorur deri më sot, që është një provë më shumë për prejardhjen e saj hyjnore. Ndoshta është kjo natyrë biblike e gjuhës shqipe që e ka shpëtuar atë në shekujt e errët të historisë dhe mbron atë nga rrebeshet dhe tramat shkatërruese të kohëve modern.

# PËR POLICINË GJUHËSORE, GJUHËN DHE STILIN

Për të kuptuar rëndësinë dhe shtjellat e gjuhës, s'ka nevojë për spekulime të zjarra teorike; mjafton ca kërshëri dhe një vullnet i mbarë.



## Ledi Shamku SHKRELI

Nëse shtyni derën e ndërtuesës së gjuhës së folur e të shkruar, keni hyrë në Mbretërinë e Lirisë. S'ka pse trembemi, pra, nga ata që prej së jashtmi kërkojnë t'i vënë zgjedhë mënyrës sonë të të shprehurit, nga ata që zhvoshkin nga milli e shpalosin lista e lista me fjalë e shprehë, të akuzuara sipas tyre për aksh faj e gabim: kjo ka prejardhje të huaj, kjo tjetra është ca si tepër popullore, bie erë dialekto apo stil bisedimor dhe më pas krasitja... Të vetmit që mund t'i diktojnë rregulla sérënditjes sonë të fjalëve janë ata me të cilët ne komunikojmë. Po ashtu, e vetmra rregull e vërtetë është ajo që mbikqyr nëse një tekst, periudhë a fjalë ia del mbanë të përcjohë mirë e saktë mesazhin që rrekimi t'i japid tjetrit. Shtigjet nga kalon përdorimi i fjalëve nuk janë thjesht dilemat nëse janë fjalë të përdorura apo të rralla, a nëse janë fjalë të çlira apo të stilët formal. Si do ta gatuajmë ne fjalën varet po aq edhe nga dëgjuesit (lexusit) që përfytyrojmë apo kemi përballë.

Sikurse pohon Vygotsky, gati gjithmonë ne fjalët i shtierë në punë në rungesë të dëgjuesve. Kjo s'do të thotë se nuk jemi fort në rregull; shumicën e herëve të folurit na shërben për të shoshitur e ripërtypur ndonjë gjasë o mbrësë, ndaj dhe fjalët nevojiten enkas për të kujtuar e nxjerrë në pah veçantitë e asaj që po shqyrtojmë. Dihet, pra, se njerëzve u takon shpesh të flasin me veten, thënë ndryshtë të flasin së brendmi.

Sidomos në gjuhën e folur (por edhe në kode të tjera semiologjike) ushtronhet më së miri ky përdorim "i brendshëm" apo, me një term disi më teknik, përdorimi "endofazik" (éndon "brenda" dhe phásis "shprehje" greq.). Është fjalë për një përvjojë që gjithkush e fiton përtet një farë moshe. Të vegjlit, para se të mbërrijnë te ligjërimi endofazik, njohin fillimisht atë ekzofazik (éxo "jashtë" greq.) dhe më pas e përdorin

këtë të fundit për të folur me vetveten: ligjërimi egocentrik. Keni vënë re ndonjë fëmijë kur luan? Ai shpesh i flet apo i tregon vetes për atë që po bën. Kësosoj, ligjërimi endofazik është një përsosje dhe vazhdimësi e kësaj praktike fëminore.

Në ligjërimin tonë të brendshëm nuk kemi kurrrafë kufijsh. Askush s'mund të na thotë "gabon", "duhet të shprehesh ndryshtë" apo "kujdes, po flet në dialekt!". Jemi krejt të lirë në vetvete.

Kur përdorim fjalët, thamë se mund t'i përdorim edhe në mënyrë ekzofazike, për së jashtmi, e atëhere gjendemi përballë një labirinti zgjedhjesh e mundësish. Le të marrim njërin syresh, fjalë vjen gjuhën e folur; me anë të saj kurritimi ynë mund t'i drejtohet një apo disa dëgjuesve. Madje ka mësue një shekull që gjuhja e folur ka hyrë në erën e saj të re. Shpkja e telefonit, radios, televizionit, shpërndarja e disqeve të regjistrues, i kanë celur morë mundësish komunikimit zanor në largësi sikurse shpkja e shkrimit u kishte bërë të mundur njerëzve të komunikonin me anë fjalësh së në hapësirë ashtu edhe në kohë.

Të flasësh me dikë që e ke aty pranë apo me një që ndodhet larg, t'i flasësh një rrëthi të ngushtë miqsh apo një turme njerëzish, të flasësh para mikrofonit të radios apo para kamerave të televizionit, që, veç zërit, paradesin edhe shembellitë të gjatë kohës që flet, të flasësh apo të shkruash e, më tej akoma, t'u shkruash miqve apo të panjohurve: ja një labirint zgjedhjesh që ia beh para nesh sapo lemë pas ligjërimin e brendshëm e matemi të kururisim në ligjërimin ekzofazik.

Një fjalë krejt e qartë dhe e natyrshme për një situatë mund të shndërrohet në një thënë të vagullt e pa kuptim nëse ndërron mjedis. Ta zëmë, librave të mij në bibliotekë e vërshon uji e dërmohen. Kur dua t'i qahem një të njohuri që e kam aty pranë, mjafton t'i them p.sh. "Uuu, shih ç'u bë!" dhe ai ka marrë vesh gjithçka. Kur ky person i njohur gjendet tjetëkund, po t'i

them a t'i shkruaj vetëm "shih ç'u bë", ai s'do të kuptojë kurrgjë; sidooqoftë mund të mjaftohesh p.sh. duke i thënë "Me librat e mij u bë nami". Krejt ndryshtë paraqitet gjendja semasiologjike nëse për dëmin që pësova duhet të njoftoj zyrtarisht dikë. Atëherë më duhet t'i them në që ditët ngjau, shkakun e dërmimit, numrin e përgjithshëm të librave në bibliotekën time, cilët janë dëmtuar e cilët më shumë etj.

Ja, pra, sa shumë liri kemi të zgjedhim kur vendosim të përdorim fjalët. Madje detyrohemë me qenë të lirë! Ky është stil: është mënyra si organizojmë fjalët në fjali e fjalitë në përbajtje, me qëllim që të shprehim një mendim o domethënë. Kur themi zgjedhje kemi thënë stil e anasjelltas. Porse zgjedhje nuk do të thotë tek apo rrëmuji; përkundrazi me të nënkuptohet një përdorim bashkërendues i mjeteve fjalore në përputhje me situatën në të cilën ndodhemi.

Llojet e zgjedhjeve që përmendëm janë të pavarura nga njëra-tjetra, së paku në parim, por s'do mohuar se herë-herë ato priren edhe drejt shkrirës në një të vetme. Në përgjithësi, ai që i drejtohet një publiku të gjerë e të panjohur, përpigjet të qërmtojë fjalë që atij i dukën të mirënjoyura, duke iu shmangur lokacioneve tipike krahinore apo dialekto. Po për të njëjtën arësyte do të përdorë edhe ca regjistra gjuhe më formalë se po t'i drejtohej lirshëm një të njohuri. Edhe shkrimi do parë si shtysë përfundim, ndërsa dialekti na grish të jemi sa më pak formalë.

Si përfundim, ndonëse është e pacënueshme pavarësia e këtyre tri mundësive zgjedhjesh, gjithsecila do të kërkojë doemos ta ndihmojnë dy të tjerat. Lindin kështu "stilet kolektive".

"Stili i folur" është tërësia e zgjedhjeve që mpleksen më shpejt e më kollaj, ndërkohë që ne flasim. Të folurit, pos tjerash, është edhe një proces improvizues, ndaj s'kemi fort kohë të pikasim fjalë e shprehje të rralla. Kështu priremi të rrëm-

bejmë me ngut fjalë nga fjalori ynë i zakontë, nga fjalori i habitatit tonë, pikërisht ato fjalë që dëgjojmë, mendojmë e themi më shpesh, që i kemi "gjysmë të gatshme". Këtu ndizet llamba e alarmit: sa më të gjerë e të larmishme ta kemi gamën e fjalëve dhe shprehjeve që presin ashtu gati të rraken e përdoren vetiu në bisedë, që më lirshëm, shkoqur, saktë e këndshëm do të flasim. T'i lemë, pra teorizimet shterpë e bokërrimat e ashtuquajtura "gramatikore" - emancipimi dhe hijeshimi i gjuhës kombëtare e ka zanafillën te gjuhë e folur. Ai është një proces që te gjithkush nis me belbëzimet e para e imbaron me imbarimin e jetës së tij mbi tokë. Ndaj hartuesit e teksteve shkollore, shkrimitarët e poetët përfmijë, edukatorët e mësuesit, përkthyesit e visareve botërorë, redaktorët e botuesit, kallauzët e kësaj Anijeje Shqipfolëse nuk munden me qenë të pakujdeshëm e sidomos..., ca më tepër dashuri! Po le të mos shmangem më tej nga tema jonë. Thamë, pra, që stil i folur është një stil aspak formal, i pasur me fjalë të sojtit të përditshëm që hasen shpesh. Këtë stil ka të ngjari ta imitojmë edhe në të shkruar, po që se përfshijmë ato elemente joformale që sapo cituan.

Ndryshe nga ai "i folur", "stili i shkruar" cilësohet nga fjalë e struktura më të rralla e më specifike, gjithë në përputhje me temën që trajtohet. Fjalitë janë ca më formale e më të ftohta ndaj gjendjes që përshkruajnë. S'është çudi që edhe në të folur të na duhet kur e kur të përdorim regjistrat e gjuhës së shkruar; veç nëse kjo ndodh gjatë bisedave me shokë a të afërm, rrezikojmë të bëhem qesharakë e, si thuhet kështu rastesh, mund të na shpotitit "Mos ke ngrënë gjë gazetë?"

Të njohësh mirë një gjuhë do të thotë të lundrosh lehtë e paq mes stileve kolektive që ajo ofron. Jo ta gjesh veten të zaptaur nga to, por të jesh i qetë se mund t'i përdorësh kurdo që ta lypë shtysa për t'u shprehur.

Një spirale enigmatike

# PARASHKRIMI I LETËRSISË

Një pjesë të letërsisë së realizmit socialist andej dhe këndeje kufirit i ka humbur shpirti dhe ka mbetur vetëm si "dosje" letrare. Cili lexues sot i bie në fund romanit "Këneta" të Fatmir Gjatës, apo "Rrushi ka nisë me u pjekë" të Sinan Hasanit

Afrim DEMIRI

Parashkrimi i lëndëve juridike, për një arsy apo tjetër, vazhdimisht më ka ngjallë një ndjenjë pakënaqësie mos të them mos besimi. E shtrirë deri te publiku i gjërë, kjo shmangje e dhënies së një verdikti një vepre të caktuar të kryer penale, e cila ka shkelur më shumë se një të drejtë, nëpërmjet një afati kohor, më ka ngjallur një tërmet moral duke mos pasur mundësi të krijoj një drejtshem në mes të asaj që është e drejtë juridike dhe asaj që është e drejtë morale! Kjo gjë më ka ndodhur jo njëherë gjatë punës si gazetar, kur edhe më është dashur ta mësoj fjalën p a r a sh k r i m.

Këto ditë kur kam nëpër duar një përbledhje me tregime, që mëton t'i përfshijë brenda kopertinave 40 tregime të krijuara përgjatë një periudhe prej para lufte e deri më tash, po më ngjallen pothuaj të njëjtat ndjenja sikut kur isha gazetar për lëndët juridike, sikut tash që jam autor, krijues i këtyre tregimeve. Madje për herë të parë po më imponohet sintagma parashkrimi i letërsisë, si homologe me sintagmën parashkrimi i lëndës juridike. Ku qëndron ojo njashëmëri që po më dërgon në të njëjtën spirale enigmatike?

Po ia filloj nga xixat e para të dyshimit përmundësinë e parashkrimit të letërsisë. Siç e dimë, një pjesë e letërsisë sonë, për brezin tonë që jetuan pothuaj gjysmën e jetës nën socializëm kurrë nuk na erdhë e plotë as si letërsi e pastër, as mësim mbi të as kritikë për të. Me një fjalë, ishim të privuar nga qasje për të, si psh. vepra e plotë e Fishës, e Koliqit apo shumë studime shkencore të franceskanëve etj. Në kohën kur ato erdhën në mesin tonë, mbasë asnjëherë nuk arrita në mënyrë

shkollore, zërthyese analizuese t'i shijoj në palcë dhe t'i përvetësoj, sikur bie fjala autorët që sado pak i kishim punuar në mënyrë më sistematike në sistemin tonë shkollor, disa prej të cilëve i kisha mësuar edhe përmendësh, si p.sh. Frashërin, Nolin, Migjenin etj. Ku qëndron këtu problemi, ku mbështillet paqartësia apo ku shkëputet komunikimi në mes veprës dhe lexuesit? Mbështetje shkaktuar nga disa qëndron tek njësia e kohës, e moshës, tek aftësia e përvetësimit e cila si duket e ka moshën e vet. Mos ishte parashkruar aftësia ime reflektouese? Psh. pse tregimet e Koliqit nuk i përvetësova kurrë si skicat e Migjenit? Kjo më ka çuar deri te konstatimet se nuk jemi të vetëdijshëm çfarë prerje kulturore ka shkaktuar censura dhe ndalimi i kësaj pjesë të letërsisë.

Kjo gjë na përballë me shumë pyetje, në rend të parë me vazhdimësinë kulturore e cila fatkeqësish tek ne nuk ka ndodhë që nga krijuesit filo-biblik e deri vonë në mes të raporteve të letërsisë që krijojët në Shqipërinë administrative si dhe në Kosovën e okupuar. Shkëputjet kanë sjellë shkëputje! Andaj, a parashkruhet një tekst letrar apo me kohë shndërrrohet në dokument kohe. Psh., me çfarë qasje të lexohet sot Bogdani, Fishët e Koliqit, a është duke e kultivuar lexuesin shkolla e jonë për vlerat tona klasike! Apo aq më paradoksale tingëllon një pjesë e letërsisë së realizmit socialist andej dhe këndeje kufirit, të cilës i ka humbur shpirti dhe ka mbetur vetëm si "dosje" letrare. Cili lexues sot i bie në fund romanit "Këneta" të Gjatës, apo "Rrushi ka nisë me u pjekë", të Sinanit.

Sikurse te parashkrimi juridik, edhe te një parashkrim i mundshëm letrar koha dhe rrëthanat kohore po janë ato, që po e mbizotërojnë një gjykim të tillë. Parash-

krimi i letërsisë sikur po e shndërron atë në një lëndë vetëm për kritikët, studiuesit e letërsisë kurse lexuesin po e dëbon nga kënaqësia artistike apo shpesh nga mos mundësia e shijimit të vlerave të njëmdenta letrare. Pothuaj njëloj si tek parashkrimi juridik i cili e privon realizimin e një të drejtë vetëm pse i ka ikur koha e saj e paracaktuar nga disa rregulla në fuqi.

Dikush mund të thotë a vlen kjo gjë edhe për letërsinë e huaj? Të përpigrem të jemi i singertë dhe në fillim të mendoj sa e sa autorë të shkëlqyeshëm as që i njoh unë e as që janë të njohur ne letrat tona. Sqarimi më sfidues po është Çmimi Nobél, cili po na befason me emra të panjohur për realitetin tone letrar. Ku është letërsia e tyre në raport me lexuesin tonë? Mos është e parashkruar?! Veprën "Plaku e deti" të Hëminguejt e kam lexuar kaherë, madje e kam përjetuar si libër hirnn, mirëpo "Larmtumirë armë" e kam lexuar gjatë pandemisë dhe disi mezi i rashë në fund dhe nuk e gjeta dot Hëminguejin tim. Pata bindjen se ai libër ishte parashkruar për mua, nuk ishte ajo që e prisja. Dikush nga miqtë më pat thënë, ndoshta ke hasur një përkthim jo të mirë. Ta marrim një rast tjetër, më ranë në dorë tregimet e De Mopasanit, thash do t'i lexoj me një frymë, por mezi që u rashë tejpërtej!

Shembuj të tillë mund të kerni të gjithë ne që si lexues pasionant notojmë në detin e letërsisë, ndoshta deti është i njëjtë po ka ndërruar sasia e kripës në të. A duhet të jetë letërsia në marrëdhënie me kohën si një vazo që nuk është shitura gjatë në dyqan, por me heqjen e pluhurit ajo sérish shkëlqen, apo letërsisë i ikën koha e vet, parashkruhet, nuk ka kuish t'ia hjekë pluhurin!

Këto dilema më vritnin derisa i shtrija tregimet nëpër kapitujt e librit, derisa doja që ta ruajo porosinë e tyre nga koha kur i kam shkruar, kur kërkova një vazhdimësi kohore, por kisha frikën se po i botoja me vonesë, kisha frikën mos janë parashkruar! Kritikët shpesh kanë pasur dëshirë të japid vlerësimet se kjo apo ajo vepër i qëndron kohërave, nuk dyshoj në shumë prej tyre që përbëjnë thesarin tonë letrar apo edhe atë botëror, por problem është tek ndryshimi dinamik i lexuesit, i cili ose po zhbëhet ose po shndërrohet në një marrës të informatës së koduar. Kodet letrare dita ditës po ngjallin neveri që të zbrëtorehen.

Pa dashur që parashkrimin e letërsisë ta shoh si fundin e saj edhe një segment tjetër i shfaqur në atë të quajtur "vërshtimë letrare" më dyotron të jem skeptik përfatim e letërsisë, së paku në hapësirën tonë letrare. Ka shumë informacione për shkrimin e librave me porosi, sikur ajo shpallja e marketingut "shkruajmë diploma, disertacione", "lexojeni shkruajmë libra me poezi, tregime apo romane". Kjo është formë më e vravhdë e parashkrimit sepse kjo prodhon para-autorin.

Edhe në botë po hasën shumë libra në të cilat sqarohet se në këtë apo në atë libër kanë punuar shkrimtarë apo studiues të ndryshëm. Atëherë shtrohet edhe një pyetje më fundamentele, a po krijohet libri integrues, i përbashkët me shumë autorë dhe lexuesi nuk ka nevojë të krijon mitin e autorit ai në të vërtetë duhet ta lexoj vetëm librin. Të shprehem kushtimisht vdekja e autorit sikur e merr me vete autenticitin e librit posaçërisht kur është fjalë përf librin letrar, ndoshta ndryshe është tek librat shkencorë, teknik apo enciklopedik.



HEJZA me Salajdin Salihun, shkrimtar

# PA ARTIN E LEXIMIT S'BËHET ARTII I SHKRIMIT

**Letërsia s'na edukon. Për këtë punë janë çerdhet, kopshtet dhe shkollat. Brodski nuk kërkon që poeti të jetë misionar dhe as të krijojë letërsi me ndikim shoqëror. Poeti, sipas tij, ka vetëm një detyrim: të shkruajë bukur, ta krijojë poezinë – "formën më të lartë të ekzistimit të gjuhës".**



Avni HALIMI

Salajdin Salihu, i lindur në Tetovë, aktualisht profesor në Universitetin e Tetovës, që me librin e parë, "Vdes pas gjërvave të imëta", pati paralajmëruar se bëhet fjalë për një krijues të veçantë. Këtë e dëshmoi edhe me botimet tjera, të cilat botime, nga ana e kritikës do të marrin vlerësimë të larta. Poezitë e Salihut janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përfshirë në shumë antologji.

**HEJZA:** A mjafton fakti se sot, meqë kemi shumë shkrimitarë që "po shkrujnë", mund të konstatojmë se po bëjmë letërsi?

S. SALIHU: Letërsia nuk ka raporte të mira me sasinë. "Letërsia e njeh vetëm një gradë, gradën e parë", tha Lasgush Poradeci. Sipas Ali Podrimjes, kur një letërsie kombëtare i mungojnë poezitë për një antologji, atëherë mjaftojnë lehjet. Fatmirësisht, letërsia shqipe ka poezi për antologji që do na nderonte kudo që të batohej. Sot btohen libra shumë të mirë, për të cilat flitet pak. Në sistemin tonë kulturor, në shoqërinë shqiptare, kemi gjendje anomie. Është përzier ari dhe rrëra... Shkrimitari s'duhet të shpejtojë. Horaci tha se poeti duhet t'i botonte poezitë pas disa vitesh. Poeti duhet "të ngusat ngadalë". Shkrimitari më shumë gris se boton.

Shkrimitarit i duhet kultura e madhe. Nuk mund ta përvetësosh artin e shkrimit pa e mësuar artin e leximit. Shkrimitari mund të jetë skandaloz në përditshmëri, por ai s'mund të jetë shkrimitar nëse i mungon kultura e madhe. Sigurisht, krijimi kërkon edhe dhundi krijuese. Pa

këtë dhundi, një lexues i pasionuar mund të bëhet, të shumtën, një studiues.

**HEJZA:** Pse sot nuk kemi gjenerata krijuesish si dikur, që në viset etnike jashtë atdheut, po shënonin "epoka letorraine": gjenerata e Pasluftës së Dytë Botërore, gjenerata e viteve 70-80-90! Ku qëndron problemi: te shkëputja e kontaktit krijues - lexues, te "heshtja krijuese" si pasojë e shkëputjes kohore, e cila kërkon një hedhje të hapit gjigant në krijimtarinë letrare, apo si pasojë e "vdekjes" së kritikës letrare?

S. SALIHU: Është e bukur për një letërsi dhe për një kulturë kur asaj i shfaqet një gjeneratë shkrimitarësh dhe mendimtarësh. Kjo ndodhi disa herë në historinë tonë kulturore. Mund ta përmendim "letërsinë e vjetër". Librat e autorëve të kësaj periudhe u përkthyen në shumë gjuhë europiane. Mund ta përmendim edhe Rilindjen Kombëtare, elitën e viteve '30 dhe periudhat që i përmendni Ju. Ka edhe periudha kur një letërsie jo vetëm nuk i shfaqet ndonjë brez i fuqishëm, por i mungon edhe një emër i shquar. Kjo ka ndodhi edhe me letërsitë tjera evropiane...

Për sa i përket kritikës le t'i referohemi Fan Nolit. Ai tha se për zhvillimin e letërsisë dhe të artit duhet ambient kulturor dhe vlerësues. Sot s'kemi as ambient kulturor dhe as ambient vlerësues. Sfera kulturore është në gjendje anomie. Dominon "filozofia e pallangës", siç e quan një filozof. Kemi gjendje kaotike. Branko Merxhani, duke iu referuar Niçes, kërkon që shoqëria shqiptare të krijonte prioritetet dhe ta organizonte kaosin. Në kaos ka humbje energjje. Nuk dihet kush se çfarë është...

Sot jetojmë në kohën e simulakrave dhe simulimeve, në epokën e hiperrealitetit, kur banalja është bërë kategorë estetike, siç tha Jean Baudrillard. Letërsia nuk është në vërmenden e këtij qytetërimi. Vendin e saj e ka zënë spektakli. Kësaj gjendjeje i shkon edhe alegoria e shpellës nga Platon. Në shpellë njerëzit nuk e shohim realitetin, por reflektimin e tij...

Kur jemi te kritika, duhet thënë se krijuesin e mirë s'ë bën kritika letrare. S'ka ndonjë shkollë për tu bërë shkrimitar. Shumë shkrimitarë gjenialë s'janë çmuar fare nga kritika. Edhe më keq: janë përcmuar dhe akuzuar rëndë. Kësia shembujsh kemi nga antikiteti e deri në ditët e sotme.

Edhe kritika letrare shqiptare shpesh veproi si polici shpirtërore. Ajo foli me një diskurs që s'i shkon letërsisë. Disa shkrimitarë u quajtën "dekadentë", "reaksionarë", "traditarë". Kjo kritikë, madje, u bëri lexim të keq edhe veprave të mira. Kritika dogmatike, e ngulfatur nga irregullat, kufizimet apo dogmat ideologjike është e dërmshme për një kulturë. Është si Prokrusti. Ia pret flatratë pasionit krijues.

Kundër kësaj kritike u rebelua edhe Danilo Kishi. Në sproven "Për pluralizmin", të botuar më 1974, e kritikoi kritikën tradicionale, pozitiviste, sociologjike. I kritikoi kritikët letrarë që dëshironin të dominonin me idetë dhe shijet e tyre në mënyrë tiranike, totalitare. E kritikoi kritikën letrare "realiste" që tentonte letërsia të ishte "imazhi i jetës popullore", "literaturë e kritikës shoqërore" dhe e "angazhuar në dobi të popullit". Ai kërkoi pluralizëm idesh. Pa këtë pluralizëm një kulturë s'ë arrin lirinë elementare.

Kundër këtyre kufizimeve ishin shumë kritikë dhe shkrimitarë shqiptarë. Mjafton

ta përmendim manifestin "Vox clamantis in deserto", të qarkut të Prishtinës, që i kundërvihet realizmit socialist.

Kritikët mendjehapur janin ndihmesë të madhe. Në vitet 80-të, në Prishtinë, kishte mendim të avancuar kritik, që ishte në të mirë të vlerës letrare.

**HEJZA:** A mund të ketë kritikë bashkë-kohore letrare në kohën kur na ngulfat amatorizmi dhe diletantizmi në bërjen e "letërsisë"?

S. SALIHU: Mund të ketë nëse do të dëshironim. Ose: duhet të ketë. Po cili i është përkushtuar sot kritikës letrare? Cili paguhet për këtë punë? Cili e ka profesion?

Në vendet me industri libri ka edhe kritikë letrare. Mendimi i tyre ndikon që një libër të bëhet edhe bestseller. Shtëpitë botuese e reklamojnë një libër të mirë, sepse kanë edhe përfitime materiale. Te ne mungojnë edhe recensionet në media. Në skenën e kulturës janë ngjitur ata që s'ë dinë as dormethënien e kësaj fjale. Ata që kulturën e kuptojnë si garë, si spektakël. Në kësia rastesh një kritik duhet të ketë nerva të forta. Ai do të sulmohet nga lukunia e mediokrititetit, që kudo e valëvit flamin e patriotizmit dhe arit e letërsisë i jep "misione". E ngatërojnë letërsinë me atdhe-dashurinë. Sipas Konicës, letërsia dhe atdhe-dashuria janë dy gjëra të ndryshme. Mund të jesh atdhetar i madh, por jo edhe shkrimitar i madh. Dhe e kundërtë: mund të jesh shkrimitar i madh, por jo ndonjë atdhetar i dëshmuar. I janë letërsisë edhe misione shoqërore dhe edukative. Letërsia s'na edukon. Për këtë punë janë çerdhet, kopshtet dhe shkollat. Brodski nuk kërkon që poeti të jetë misionar dhe as të krijojë letërsi me ndikim shoqëror. Poeti, sipas tij,

ka vetëm një detyrim: të shkruajë bukur, ta krijojë poezinë – "formën më të lartë të ekzistimit të gjuhës".

Ka që e ngatërojnë ende letërsinë me ideologjinë. Letërsia s'njeh ideologji. Ajo qëndron përmbi ideologjitet. Letërsia nuk e ndryshon aktualitetin. Letërsia e mirë mund ta ketë shtresën aktuale, por ajo s'mjafton kur veprës letrare i mungon shtresa universale. Letërsia nuk është gazetari. Letërsia e mirë u flet të gjithë kohërave. Ajo u flet edhe lexuesve që ende s'kanë lindur.

**HEJZA:** A shihni ndonjë rol në profilimin e krijuesve të mirëfilltë nëpër portale apo redaksi elektronike gjithë-kombëtare që do të ishin nën përkujdesin institucional të shteteve tona shqiptare?

S. SALIHU: Është e domosdoshme të ketë portale për kulturë. Portalet janë si gjithë mediat tjera dhe duhet të përfitojnë nga fondet publike, por nëse udhëhiqen nga profesionistë. Mediat e reja duhet të ofrojnë të dhëna për krijuartarinë e shkrimitarëve. Pa e përjashtuar traditën. Mjerisht, shteteve tona s'u intereson kultura. Ministritë e kulturës janë për këtë punë. Sot ende shërbëheni me histori letërsie ku flitet për shkrimitarë "dekadentë" dhe "reaksionarë". Librat e domosdoshëm për një kulturë duhet të digitalizohen. Të prezantohen edhe në gjuhë të tjera...


**HEJZA:** Librin elektronik, bibliotekën elektronike, digjitalizimin e botimeve, e shihni si "vdekje të librit" apo si një proces të cilin, detyrimisht duhet ta pranojmë dhe të jemi në hap me kohën! A mund ta konceptojmë këtë proces të librit si fat i shkrimit të pergamenave, të shkrimit nëpër lëvore drush, në rrasha guri, në lëkurë kafshës, në shpat mali, në shpella!

S. SALIHU: Unë e pëlqej librin e shtypur. Besoj se lexusit e letërsisë janë më konservatorë. Ata s'do ta lejojnë vdekjen e librit të shtypur. Leximi vertikal, pra leximi i librave, siç thuhet, i bën dijet e qëndrueshme, për dallim nga leximi horizontal. Besoj se zhvillimet teknologjike s'ndikojnë fare në cilësinë artistike të një libri. Veprat më të mira letrare u krijuan kur s'kishte rrymë elektrike. Epi i Gilgameshit, një vepër e krijuar në kohën fëmijërorë të njerëzimit, është kryevepër e letërsisë botërore. Ose veprat e Homerit, Hesiodit, Eskilit, Sofokliut, Euripidit, Aristotelit, Platonit, Virgilit, Servantesit, Shekspirit, Dantes, Gëtes etj.

Nuk e paragjykoj librin elektronik. Sot mundesh shumë lehtë ta gjesht një libër që të intereson. Nëpër arkiva e biblioteka digitale ka shumë libra të çmuar dhe të panjohur për shqiptarët dhe për kulturën e tyre.

**HEJZA:** A po e vuani kritika jonë letrare mungesën e gazetave dhe revistave kulturo-letrare! Nga ana tjetër, janë të pakta edhe përpjekjet e kritikës sonë që të gjiej vend e strehë nëpër faqe profesionale, nëpër rrjete sociale të profilizuar ku mund të japid kontribut të pamohueshmë.

S. SALIHU: Në hapësirën shqiptare botohen disa revista letrare cilësore. Në Maqedoninë e Veriut, fatkeqësisht, janë shuar shumë revista letrare për mungesë mjete finansiare. Revistat letrare janë të domosdoshme. Uroj që një ditë edhe "Hejza" të botohet në versionin e shtypur. E vlerësoj këtë revistë shumë, veçanërisht sepse boton krijime të autorëve që "u harruan" prej se nuk janë në mesin e të gjallëve. Ata janë emra që do të mbeten përgjithmonë në historinë e letërsisë sonë, si: Azem Shkreli, Anton Pashku, Ali Podrimja, Rrahman Dedaj, Din Mehmeti, Teki Dervishi, Mirko Gashi e shumë të tjerrë. Hejza më pëlqen sepse trajton edhe probleme të ndryshme socio - kulturore... Uroj të kemi revista e portale me këtë cilësi edhe për artet pamore, artet skenike, veçanërisht përmuzikën.



# E VËRTETA DHE E SHËMTUARA

Vetëm injorantët dhe të pamoralshmit mund të tallen me vlerat universale (të sanksionuara madje, qysh në librat e shenjtë) morale të mos zhgënjinimit, mos mashtrimit, mungesë së solidaritetit etj.

## Bejtush ISUFI

Dogma në vetën e parë

Vendet dhe popujt që jetuan në komunizëm e besonin dogmën apo gjykimin se individi, duhej që t'i nënshtrohej shoqërisë. Ndërsa, pas rënies së komunizmit kjo dogmë u kthye në të kundërtën e saj! Tani, sot, besohet në dogmën tjetër, se: shoqëria duhet t'i nënshtrohet individit, interesit të tij...! Duket goxha mirë se, në ditët e sotme për shkak të arsyeve të shumta (varfëria, papunësia, padrejtësia, korruptioni, krimi i organizuar etj.), jeta është kthyer në një luftë për ekzistencë. Epo, nga dogma e thjeshtë e deri te marrëdhënia e ndërlidhkuar, e ndërvavarur në mes të individit dhe shoqërisë, është një rrugë e gjatë e cila, duhet të ndërtohet me shumë durim dhe përkushtim. Deri atëherë, deri te ndërtimi i "rrugës", do të vazhdojmë të besojmë se qenja jonë shoqërore mund të kufizohet në cilësinë tonë themelore: si shtetas në regjistrat e gjendjes civile dhe në prezencën tonë gjithnjë e më të madhe në rrjetet sociale. Pra, "e vërteta" nuk është edhe aq e sofistikuar! Dogma, po.

Megjithatë, individi nuk mund ta zëvendësoj nevojen për tjetrin vetëm nga fotografitë dhe porositë nga interneti. Kjo sepse, nëse e gjithë qenia jonë shoqërore t'kurret në informatë, në letër apo imazh apo mesazh elektronik, kjo në masë të madhe do ta zhdukte përmbytjen tonë të tanishme - njëzore. Prandaj, pavarësisht nga zhvillimi i sotshem teknologjik, njeriu nuk mund të mohojë domosdoshmérin e tij që ta njohë vetveten si pjesë e integruar e shoqërisë. Individ, edhe mund të provoj të ikë nga shoqëria, ose edhe nga liria, mirëpo kjo ikje e tij nuk do ta shpie atë te shpëtimi, përkundrazi, do ta shpie te vetëmohimi!

P.s. Ende është e largët koha kur nga fotografia mund të ngjallët njeriu (siç, kjo krijuhet në fiksionet elektronike), përderisa



shumë më afër e kermi të kundërtën e kësaj, pra, që njeriu e gjallë ta transformojmë në një fotografi (letër apo imazh elektronik).

### E vërteta dhe gjenjeshtra

Sipas të gjitha rregullave morale, religioze dhe juridike, e kermi të ndaluar ta themi të pavërtetën (gjenjeshtren, mashtrimin), me ndonjë përjashtim të rrallë, si për shembull, kur e gënjejmë armikun, dhe vetveten! Pra, duhet ta themi vetëm të vërtetën...! Pse? E vërteta, është tepër e vlefshme për njeriun, shoqërinë dhe shtetin, prandaj ka aq shumë shkenca që e studiojnë të vërtetën, të vërtetën objektive (të jashtrme). Të vërtetën subjektive, ligji na

e obligon që ta themi kur ftohermi si dëshmitar, por atë nuk jemi të obliguar t'a themi secilit, përpos atyre që e meritojnë...

E vërteta, shpesh mund të jetë e hidhur (fillimisht) por, ajo del në dritë, ndërsa gjenjeshtra në fillim duket e bukur (e hijshme) por, gjithmonë përfundon te e shëmtuara. Prandaj, se sa e shëndoshë dhe e lumtur është një shoqëri, besoj shumë që kjo varet edhe prej asaj se, sa një shoqëri është e vërtetë! Për këtë arsy, për të vërtetën sakrifikojmë, sakrifikoherni etj. Po ashtu, e himnizojmë atë (në dritë të së vërtetës).

Të pa vërtetën duhet ta shmangim, ta urejmë në çdo formë të saj: si lajthim, mashtrimin, përcarje, përfitim, denigrim etj. Forma e saj, saj, na intrigon dhe na

shërton! Na nxjerrë lakuriq...! Dhe krejt në fund, thelbi i saj na shpie ose, na mbanë gjithnjë në errësirë.

E kundërtë: vetëm shoqëria njerëzore jeton në bazë të rregullave morale, etike, ligjore përkatësish, njeriu nuk mund të jeto jashtë tyre...

### Gjenjeshtra si mënyrë jetese

A ka mbetur më diçka e moralshme në këtë vend, apo morali na ka braktisur (e kemi braktisur), dhe tani është fushë e lirë (e shpërlarë), deri atje ku fillon krimi? Qindra e mijëra ton rrrend e mashtime, veprime nepotiste e korruptive (veprime të ndryshme të pamoralshme) prodhojnë ditë e natë. Pra, si mund të ecet përparrë në këtë "fushë" të kontaminuar? Është e çuditshme se si veprimet tonë të këtilla, nuk përfundojnë në gjykatë! Në çdo komb/shoqëri të shëndoshë, ka qëndrim të rrept ndaj sjelljeve të pamoralshme, ka sanksione septe, po t'i lihet që gjykatë ta mbroj moralin shoqërorë, herët a vonë gjykatë do të bankrotoj!

Ky fenomen i rrenës si mënyrë jetese që na shtynë drejt shturjes totale, në vende me parametra të një demokracie funksionale, parandalohet e dënohet: fillimisht nga shoqëria civile, e pastaj nga institucionet edukative, fetare, nga familja, mediat, gjykatat e nderit etj. Pra, a është e mundur që skuaja është zhdukur si "ngjyrë" nga ftyra jonë, dhe njeriu ynë të gjenjen pesë herë në ditë? Dhe sikur të mos mjaftohet, vazhdon me të gjashtën...? Cilën të ardhme e presin gjeneratat që rritën në këtë krizë të rëndë të moralit shoqërorë dhe publik? Kur, do të marrim guximin e të mbrojmë vlerat themelore mbi të cilat bazohet një shoqëri bashkohore?

Vetëm injorantët dëshët pamoralshmit mund të tallen me vlerat universale (të sanksionuara madje, qysh në librat e shenjtë) morale të mos zhgënjinimit, mos mashtrimit, mungesë së solidaritetit etj.

## Dallime gjuhësore

# DY SHQIPTARË DHE NJË FJALI FARE E THJESHTË!

## Ilmi REXHEPI

Po marrim një tekst konkret dëshët që ta analizojmë se si dy shqiptarë, njëri i Shqipërisë e tjetri nga Kosova, e kuptojnë krejt ndryshe nga njëri-tjetri:

"U lajmërua urgjencia, por fërmija humbi jetën rrugës" (teksti është marrë nga një portal i Shqipërisë). Shqiptari i Shqipërisë, qoftë toskë e qoftë gegë, kupton se urgjencën dikush e paska lajmëruar për rastin e atij fërmijës. Kurse shqiptari nga Kosova dëshët që kanë jetuar në ish-Jugosllavi kuptojnë nga po ky tekst se urgjencia qenka paraqitur. (po përjashto leximin me vetëdijen për kuptimet e saktë të kësaj foljeje).

Dallimi në të kuptuar nuk është sipas kundërvënies toskë/gegë, por sipas kundërvënies qytetar i Shqipërisë/qytetar i shteteve, banorët e të cilave kanë jetuar në Jugosllavi. Pra, sipas gjeografisë politike dëshët që sipas asaj dialektore.

Gazetari ka përfshirë vetëm kuptimin që urgjencën e kanë lajmëruar. Pse ndodh kuptimi tjetër?

Folja "lajmërohem" në shqipen ka kuptimin "më jep lajm dikush". Janë joshqipe për kuptimet përfshirë cilat përdoren fjalitë: nuk po më lajmërohet në telefon, lajmërohu te sportet-

li, a po të lajmërohen djemtë, pse nuk m'u lajmërove... Duhet: nuk po më thërrret, nuk po më paraqitet, paraqitu... Përdorimi i foljes "lajmëroj" në formën joveprore "lajmërohem" me kuptimin e foljes "paraqitem", është nga ndikimi sllav dhe e përdorin vetëm shqiptarët që kanë jetuar në ish-Jugosllavi.

Dikush do të "arsyetonte" kështu se derisa njerëzit e kuptojnë që "u lajmërua Thaçi" i bie "u bë i gjallë, u paraqit, u duk", pse të mos llogaritet në rregull, a vec pse jena gegë a e duhet me e duru zullumin e toskëve?

Jo pse jemi gegë, sepse edhe gegë e Shqipërisë e kuptojnë njëjtë si toskë e jo si ne tash! Madje, edhe tanët, para se të na jugosllavizohet nga pak gjuha, do ta kuptonin vetëm si ata, tjetër pse forma joveprore e foljeve "nuk u ka shkuar për goje" shqiptarëve të mëhershëm.

Por, sepse këtë ndikim nuk mund ta shtrijmë tek të gjitha viset shqiptare, pra i mungojnë aftësitë që të shtrihet e të bëhet i kuptueshëm nga të gjithë, prish njësinë e menduar të kuptimit shqip, aq më tepër që është ndikim (kalk) sllav siç e shpjegojnë gjuhëtarët.

Passhkrim Shprehja me pretendim terminologjik "dallime gjuhësore brendashqiptare" të përfshitura sipas gjeografisë politike" është nga unë, mendoj që ka arsyë të shërbejë si ide drejtimi për studime të reja gjuhësore

# FAKTORI X I GJENIVE

Gjenialiteti në art lind, por ai edhe mund të zhvillohet. Ai ka nevojë për disa faktorë ekonomikë, shoqërorë dhe kulturorë. Ai zhvillohet zakonisht aty ku ka një humus pjellor krijues



Artur SPANJOLLI

Shumë herë kam pyetur veten, çfarë ka më tepër një gjeni nga një artist normal, i mirë, i mrekullueshëm apo jashtë normës? Për të mos thënë artist mediokër, me të cilët bota është e mbushur plot e përplot. Çfarë e dallon pra një gjeni nga pjesa tjetër e grüpit të cilët kontribuojnë në të njëjtën fushë? Sipas mendimit tim modest, përvëç dhuntisë së tyre natyrale dhe predispozitës përfshirë krijuar art, talentit pra përfshirë vizuatuar dhe krijuar me baltën, ngjyrën apo gjendur me daltën, duhet patjetër edhe faktori X. Në radhë të parë duhet që gjeniu të jetë një punëtor i pandalur. Vetëm në saj të punës sistematike realizohen kryeveprat. Mund të kesh talent sa të duash, por po nuk pate vullnet? Por, nuk mjafton as vullneti. Ka pasur bota talente të mrekullueshme në rini apo shkollë. Talente të habitshëm që profesorët thonin me besimin më të patundur se ai do të bëhet i madh, por me kalimin e viteve, o prej demblizmit, o prej humbjes se entuziazmit, apo kushteve te reja shoqërore dhe ekonomike, ato janë zbehur si në shpirt ashtu edhe mëndje dhe nuk i kanë dhënë asnjë njëzimit. Kanë humbur pra çdo interes krijimi dhe kërkeshë ndaj vvetves. Por, ka edhe raste të kundërtat. Studentë mediokër, të cilët veç mbasi kanë dalë në jetë, e kanë zhvilluar talentin e tyre, duke dhënë në fushat e artit vlera të padiskutueshme. Një nga veçoritë, kusht themelor pra përfshimin e një gjeniu është edhe dalja e tij nga pellgu artistik që e ka lindur. Shumë artistë ndërkombëtarë, veç kur kanë dalë nga pellgu i vogël dhe hermetik që i lindi, duke parë, duke hulumtuar, duke vëzhguar, duke reflektuar, duke punuar dhe kërkuar, kanë arritur të jepin gjëra të mrekullueshme në çdo fushë të artit. Vlera të mirëfillta shpirtërore. Mikelanxhelo ishte një shpirt i madh? Ai jetonte një skizofreni të çuditshme. Nga njëra anë ishte artisti -hyjnor i cili në mënyrë të mistershme, të pakuptueshme, të mrekullueshme, bashkë me daltën skaliste tek dora e Davidit gjithë energjinë e 16 vjeçarit, lëvrimin e gjakut ndër deje, forcën madhështore të shpirtit të njeriut, bukurinë ideale të adoleshentit hebre, por nga ana tjetër, ishte i tërhequr si njeri. Fare i pakomunikueshëm, kapriçoz, inatç, mendjernadhë dhe sidomos kurnac. Aq shumë kurnac ishte Mikelanxhelo sa në pleqëri, i fshihi

verdhushkat poshtë dyshekut me një arkë dhe e dënonët venet dhe ndihmës të tij duke ngrënë bukë të zezë, qepë dhe pak djathë. Kjo skizofreni më ka bërë disa herë të reflektoj mbi shpirtin njëzor. Është e mundur pra që një shpirt aq i madh artisti i cili kishte mbuluar 5 mijë metra katrorë të Kapelës Sikstine me afreske, që kishte gjendur me daltë Mojsiun dhe Davidin, të ishte pra në jetën e përditshme kaq meskin, gjenieshtar dhe kapriçoz? Duke i lënë mënjinanë këto pyetje themelore, dua të theksoj se askurrë më parë dora e artistit nuk kishte arritur një përsosje kaq të madhe sa ajo e artistit nga Kaprese, të Arezzo-s. Nga vinte energjia e Mikelanxhelo-s? Është veç energjia që çlironi është mbi veprën e artit që e dallon një kryevepër nga të tjerat kriesa artistike? Njerëz me energji të theksuar i kemi parë shpesh në historinë e njëzimit. Gjithë ata njerëz të ndritur. Filozofë, artistë, mbretë, shkencëtarë, profetë. Duke filluar nga Krishti e Buda, të cilët e kishin Pranë e tyre aq të shndritshme sa i pari bënte mrekulli, spostohej në materie, materializonte sende, shndërrohej në figurë drite, fliste me gjuhën e Kozmosit, që është veç gjuha e dashurisë, ndërsa i dyti arriti dritën e Nirvanës. Pastaj duke kaluar tek Aleksandri i Maqedonisë, hyjnori Aleksandër, i cili arriti të bënte të pamundurën. Kjo e pamundur që ai e arriti as edhe 33 vjeç nuk mund të arrihet pa mështetjen e një Hyjnie. Bota ka njohur pra filozofë dhe artistë, udhëheqës karizmatike dhe lider plot shpirt frysmezues, shkencëtarë dhe profetë që falë energjisë së tyre në trup dhe në mëndje i kanë falur njëzimit dritë. Drita që Mikelanxhelo i fali njëzimit ishte ajo e veprave të tij, ku shprehet një forcë aq madhështore, sa sinqerisht nuk arrij ta besoj së ajo ka veç origjinë njëzore. Nëse Dante, pararendësi i tij, përfshirë cilin M. kishte një adhurim total, i fali me Pranën e tij, me energjinë e tij njëzimit Komedinë Hyjnore. Vepra më e thellë dhe sublime që njëzimi ka lexuar dhe pasur ndonjëherë ndëruar. Nëse Dante pra, i fali njëzimit modelin më të lartë të përsosjes morale në optikën, vizionin Kristian; Mikelanxhelo e derdhi tërë energjinë e shpirtit të tij mbi format e skulpturave sublimë dhe mbi afresket madhështorë që ai na la. Kemi parë se si energjia e Van Goghut, falë duarve të tij mbruej, mpleksej me ngjyrat në penel, dhe në mënyrë fare të mistershme, tërë

ajo dashuri e marrë përfjetësish, përfjetësish aty, mbi ngjyrat e tij pastoze. Gjithçka nga gjaku dhe shpirti i tij, tanë i dhurohet njëzimit ta kundrojë me çmimin modest të një biletë dhjetë euro. Vepra e tij është tashmë përherë e gatshme të na mrekullojë, lumturojë nga ana estetike. Gjeniu atëherë na qenkerka një sërë komponentësh bashkë. Janë këto shpirta të ekzaltuar, të përgjedhur, me një Pranë të dendur energjje, nga nuk e di se Kush, që arrinë t'i jepin, t'i falin dritë të re njëzimit? Po njëlljo edhe në mendim, në filozofi, në shkencë. Si në mendim, si në sjellje morale, në art? E njëjtë Pranë energjetike e theksuar, e mbulonte, vishtë pra, edhe Michael Jackson, i cili me mjete të tjera artistike, më bashkëkohore, si një vullkan energjje, arrinte të transmeton vitalitetin e tij të mrekullueshëm, duke e transformuar atë në tinguj eksplozivë dhe në një kërcim mahnitës. Po e njëjtë gjë i ndodhi edhe Mozartit apo Beethovenit, në epoka të tjera të njëzimit. Këta artistë të cilët çlironin energji në formë arti nga duart, duke manipuluar formën dhe materien, arriten të farkëtonin vepra të mirëfillta arti, vlera shpirtërore përfshirë tërë njëzimit. Ata pra janë edhe gjenitë më të plotë dhe të paarritshëm në shërbimin tonë. T'i shijojmë atëherë ç'na lanë dhe t'i gëzojemi veprave të tyre të pavdekshme.

Gjenialiteti në art lind, por ai edhe mund të zhvillohet. Ai ka nevojë për disa faktorë ekonomikë, shoqërorë dhe kulturorë. Ai zhvillohet zakonisht aty ku ka një humus pjellor krijues. Në Firenzen e 1400-500 kishte një humus shumë pjellorë. Në Parisin e 1800-1900-tës e kishte një humus pjellorë. Dhe kështu me radhë. Në epokën e Mozartit, Beethovenit, Bahut etj. Veti kryesore e një gjeniu është se ai arrin jo vetëm të absorbojë gjithçka që e shkuara na ka lënë në trashëgim, por ai është i zoti sidomos që të krijojë rrugë të reja. Të gjiej shqiptarë të reja në art. Pra, risitë që ai sjell në art janë vetia e tij kryesore. Mikelanxhelo, Roden, Manxu, Rrembrand, Picasso, e tjerë, e tjerë. Lista është e pafund. Po ashtu edhe në letërsi. Homeri, Eskili, Virgilji, Dante, Shekspiri, Servanetsi, Gethe, Dostoevski e tjerë, e tjerë. Gjeniu duhet të ketë një intuitivë, fantazi, atësia hulumtimi dhe sintezë në mendim, por sidomos duhet të ketë një stil krejt të fuqishëm në art përfshirë disi mendimet dhe botën e tij të brendshme. Me mjetin e tij zotëruar, si në letërsi, në muzikë, në pikturë apo në skulpturë, arkitekturë etj, ai arrin të materializojë gjithçka që mëndja e tij pjellorre krijon, realizon.

Gjeniu zakonisht është i vëtmuar. Vëtmua e numrit një, është një vëtmë e cila ka të bëjë me disa arsyë. Drita e Pranës së tij, energjia e tij kriesore, në një pjesë artistësh krijon ndarje, distancë. Pra, krijon ftohtësi dhe zili. Por, gjithashtu ai shpesh bëhet disi mospërfillës, sepse mediokriteti i shumë të tjerëve veç e mërzit atë përfshirë. Mikelanxhelo thonë se mërzitë deri në neveri. Artistët e tjerë përfshirë duke ndoshta që dinin më shumë se ai, fillonin dhe i llomotisnin pa fund, duke i dhënë mënd mjeshtrit. Gjeniu shpesh,

paraprinx epokat e artit, ndaj shpesh ai është gati i pakuptueshëm, i pakapshëm. Ose nuk kuptohet fare. Shumë teori gjeniale si ajo e Ajnshtajnit, si pikura e Van Goghut, si rrymat e reja abstrakte në art, si teoritë e Tesllës, nuk kuptoheshin dhe as nuk pranoheshin.

Faktori X ka të bëjë me aparatin krijues të gjeniut. Aftësia e tij themelore është përthithja, absorbimi i gjithçkaje përreth, eksperiencia dhe pjekuria krijuese, rjeti artistik me të cilin do të shprehet: fjala, ngjyra, forma, tingulli. Stili pra i artistit. Dhe sidomos, bing bangu brenda trurit te tij. Shkëndija krijuese që i jep idenë gjeniale, fillestare. Ide të cilën ai pastaj do ta materializojë me artin e tij. Ky Bing bang, zgjat veç disa sekonda dhe është shkëndija më misterioze e trurit të tij pjellor. Tru i cili do të lindë kryeveprën. Thonë se Mikelanxhelo kur shihte gurin që do të gdhendte, ai kishte një imagjinatë aq të zhvilluar, një fantazi aq të ndezur dhe të theksuar, sa ai e shihte formën e figurës, akoma ende pa i hequr copat e gurit me daltë. Shihte figurën e Davidit akoma brenda bllokut të mermertë. "Ndaj unë", pohon ai pak a shumë, "nuk bëj gjë tjetër, veç se çliroj figurën, e cila ishte në robëri brenda mermertit!" Jo vetëm kaq. Por, mjeshtëria e lartë krijuese, energjia që ai çlironi me duart e tij, siç e thashë pak më sipër, bënte që ai të krijonte mrekullinë. Kryeveprën.

Gjeniu, artisti gjeni, ka dy binarë paralelë jete. Njëra është ajo mediokrja, e përditshme, me ushqimin, veshjet, kontratat, taksat, pagesat, e tjerë, ndërsa tjetra është ajo kriesja, sublimja. Ajo ia merr shpirtin artistit. Sidomos, gjatë stinëve të ethshme të krijuar, ai është dhe nuk është i pranishëm. Ndoshta flitet përshtatje e madh i cila ka përmbytur fushat, përfshirë bukën që është ngritur çmimi, përfshirë thashethemet e komoshiut. Ndërsa artisti duket sikur thotë: "Mos më çani kokën me këto budallallëqe. Ku e kam mendjen unë. Dhe çfarë përrallisni ju!" Ai e dëgjon veç me veshë faktin. Pohon me kokë, por e tërë qenia e tij, shqisat, përqendrimi, bota e tij është tutje. Larg. Tek një personazh, tek një tonalitet ngjyre, tek një gjendje shpirtërore që nuk din me çmijet artistike ta shprehë, tek një melodi të cilën akoma e ka dhe nuk e ka të qartë në mëndje se si mund ta shprehi atë me tingujt renditur mbi pentagram. Ndoshta mëndja e tij rend në kohërat e largëta ku gjithçka është shkrumb e hi, ose ndoshta ai mundohet ta gjejë se si ta vazhdojë një vepër, apo si t' mbylli atë. Adrenalina krijuese, lëngu që truri prodhon gjatë krijuarit të një vepre arti është edhe substanca më ndjellëse, përthithëse dhe joshëse që mund të ekzistojë tek qenja njëzore. Në saje të kësaj substance krijuese, njeriu ka krijuar aq shumë objekte dhe vepra arti përreth tij. Artisti pra, në ato çaste ai, është dhe nuk është aty i pranishëm. Kjo bashkekzistencë paralele, e bën atë shpesh të huaj, të largët, të pakapshëm. Të duket snob, mendjernadhë, plot mospërfillje. Ky alienim prodhon heshtje, vëtmë, çudi dhe moskuptim nga ingranazhet monotone dhe shpesh mediokre të jetës së përditshme e cila është gjithashtu shumë e rëndësishme përfshirë. Gjeniu nuk është "La norma". Ai është "L'eccezione".....

Profile: UMBERTO EKO

# ASKUSH SI AI

(Njëri nga intelektualët më të famshëm italianë, "qytetar i botës", që me "punë kalamajsh", "kur e mori seriozisht", u bë i përbotshëm)

**Grigor JOVANI**

U largua ngajeta në moshën 84 vjeçare shkrimitari dhe filozofi italian Umberto Eko. Ngjarja tragjike ndodhi rrëth orës 21:30, të së premtës, 19 të shkurtit, në shtëpinë e tij, siç njofton "La Repubblica", bazuar në të dhënat e familjes. Shkrimitari italian me famë botërore, që rronte në Milano, vuante nga kanceri. Ai e mbaroi.

Lamtumira e fundit njeriut të shquar të letrave dhe mendimit do t'i jetet javës së ardhshme, të martën, tek "Kastello Sforzesko" e Milano. Zgjidhet vetë për ndarjen një kështjellë monumentale, në vend të kishës, sepse sipas redaktorit të tij të gjithëshëm, Mario Andeoze, "ishte thellësisht ateist, gjithë jetës". Siç duket, ngaqë u ngjit vetë në qiej, nuk kishte nevojë për ndihmën e etërve të shenjtë dhe të engjë-jve.

Ardhur në jetë në Alessandria, në veri të Italisë, më 5 janar 1932, studioi filozofi në Universitetin e Torinos. Për tu bëre i përbotshëm në "shkencën e mendimit". Ndërsa u afroheshe të 50-tave, Eko njoft sukses të papritur me romanin e tij të parë, "Emri i trëndafilit", që u botua më 1980 dhe shiti miliona kopje, pasi u përkthye në 43 gjuhë të botës. U transferua në ekranin e madh nga regjisori frëng Zhan Zhak Ano, me protagonist Shon Konerin, në rolin e Guljelmit, ish gjykatës i shenjtë, që merr përsipër të hetojë vdekjen e dyshimtë të një murgu, në një manastir të Italisë veriore.

"Umberto Eko, njëri nga intelektualët më të famshëm italianë, është i vdekur", ky është titulli rreth lajmit i "Corriere della

Sera". "Umberto Eko ishte një prezencë e rëndësishme e jetës politike italiane të 50 viteve të fundit, por emri i tij mbetet pagjigjdhshmërisht i lidhur, në shkallë ndërkombëtare, me suksesin e Jashtëzakonshëm të romanit të tij "Emri i trëndafilit" - vazhdon "Corriere della Sera". "Bota humbi njërin nga njerëzit më të rëndësishëm të qytetërimit modern", rezymon ky organ i rëndësishëm i medias italiane.

Umberto Eko, bashkë me emra të tjera të njoftur të letërsisë italiane kishin vendosur të tërhiqen nga Shtëpia historike botuese "Bompiani", e blerë nga simotra e saj "Mondadori", e interesave të familjes Berlusconi, për t'u akorduar Entit të ri të pavaruar botues "La nave di Teseo". Ngaqë, sipas tyre, mendimi i lirë nuk mund të kushtëzohet prej asgjëje. Elisabeta Sigarbi, titullarja e këtij Enti botues, njëri prej themeluesve të së cilët ishte edhe Eko, tha -për ANSA-n, se në majin e ardhshëm do të dalë nga shtypi libri i tij i fundit, shkrime publicistike dhe ese, të periudhës 2000-2015, botuar tek "L'Espresso", me theks shoqëror.

Poliglot, bashkëshort i një gjermaneje dhe "qytetar i botës", Eko ligjëroi në shumë universitete, kryesishët në Bolonjë, ku kishte katedrën e vet të semantikës gjër në tetorin e 2007-ës, kur doli në pension.

Është rrëfyer se u mor vonë me letërsinë, ngaqë e quante shkrimin e romaneve një "punë kalamajsh", ndaj dhe nuk e merri seriozisht. Pas "Emrit të trëndafilit" botoi ndër të tjera "Ishulli i dites së kaluar" (1994), "Flaka misterioze e mbretëreshës Loana" (2004) dhe romani i fundrë



"Numri zero" (2014), ku trajton tentakulat e medias së Apenineve, që kishin mbërthyer përfyti shoqërinë italiane të viteve 90-të.

Shkroi ndërkohë me qindra ese, shkrime kritike, sprova filozofike, duke dëshruar gjithmonë nivel botëror më mendim dhe shprehje. Në "tornon" e tij të fjalës dhe mendimit morën trajtë të përkryer zbulimet dhe komentet mahnitës për poetikën e Xhojsit, guximin e Xhejms Bondit, estetikën mesjetare, historinë e së bukurës, por dhe të shëmtuarës. Bëri filozofi dhe estetikë të shkallës së lartë me kuptueshmërinë më efikase. Askush si ai.

Eko, që nuk e fshehu kurrë se i takonte të Majtës, nuk u mbyll kurrë në një "kështjellë prej xhami". Vazhdonte të shkruante vazh-

dimisht në rubrikën e vet tek "L'Espresso", duke mos iu shmangur kurrë gjykimit të problemeve aktuale shoqërore. Gjithmonë vështronë me një sy kritik shoqërinë moderne, ku edhe vetë bënte pjesë.

"Faqt e rrjeteve sociale u dhanë mundësi shprehjeje legjioneve të idiotëve, që dikur flisnin vetëm kafeneve, pasi kishin zbrazur ndonjë kupë vere, pa dëmtuar shoqërinë. I detyronim menjëherë të pushonin, por sot kanë të njëjtën mundësi shprehjeje me ata që fitojnë Nobelin. Rrojnë ofensivën e idiotëve", ka thënë Eko, sipas gazetës "Messaggero".

Kush nuk e kuptoi mendimin e mësipërm? Kush mund ta kundërshtojë? Natyrish, vetëm idiotë!

*Rreth procesit krijues*

## LETËRSI E SË TASHMES SË INTENSIFIKUAR

Teknika e metarrëfimit është shfaqur që me letërsinë, por vetëdijshëm atë e ka përdorur i pari Borges me veprën *Ficciones* (Fikzionet)

Durim TAÇI

Qasja ndaj ngjarjes si fakt, nga njëra anë, apo si mundësi fikzioni në ngjizje, nga ana tjetër, është ai bigëzim i parë që na shfaqet sa herë ulemi i shkruajmë letërsi artistike. Dyshimi, se cila rrugë duhet ndjekur, por më shumë humit para lëndës së parë më potencial letrar, përmua u shua me romanin Extra Time, vetja jote e dytë/Extra Time, la tua seconda persona (Botimet Fishata 2019 Tiranë/Mimesis Edizioni 2020 Milano), i cili shënon fillimin e një fazë të re në procesin tim krijues, periudhë të cilën mund ta cilësoj si 'letërsi e metarrëfimit', apo si 'letërsi e së tashmes së intensifikuar' duke thënë ndryshtë, në terma kohorë, përafërsisht të njëjtën gjë.

Po të përmend terma të tjerë që përdorin studiuesit e letërsisë, do i shkonte për shtat letërsi postmoderne, apo post-postmoderne. Në fakt gjithçka lidhet me vetëdijen e shkrimitarit për ta përdorur rrëfimin artistik si 'matës' e prodhues i një kohe tjetër, letrare. Jo më kot ndricimi më erdhë nga Extra Time, pra nga koha shtesë, koha tjetër.

Në këtë hulli janë formësuar edhe veprat pasuese, "Një prani në ikje/Una presenza che sfugge" (Botimet Fishata 2020, Tiranë/Lubrina Editore 2021 Itali), Nga një derë tjetër/Da un'altra porta (Botimet Fishata 2021/Besa Editrice 2023, Itali, si dhe romani më i fundit, Ligeni në mes të detit/Il lago in mezzo al mare (Uet Press 2022, Tiranë/në proces botimi edhe në italisht).

Teknika e metarrëfimit është shfaqur që me letërsinë, por vetëdijshëm atë e ka përdorur i pari Borges me

veprën *Ficciones* (Fikzionet) 1944, ku shkruhet për herë të parë për letërsinë brenda letërsisë, pasi metarrëfimi ka të bëjë me ndërhyrjen e autorit në brendësi të vetë tekstit që po thur, një rrëfim që ka si objekt vvetven, vetë aktin e rrëfimit. Ndodh të zhvillosh një tregim tjetër brenda tregimit, apo një roman tjetër brenda romanit. E gjitha kjo është mënyrë manipulimi me kohën.

Ky proces i marrëdhënies së shkrimitarit me vetë rrëfimin mund të jetë pasojë e përvjovës së tij personale në kohë, vepër pas vepre, i cili mund të shfaqet pastaj si zbulim, si në rastin tim, por sidomos më krijuhet ideja se arrij të projektoj vetë aktin e leximit. Ka qenë rendja ime pas leximit në fakt që më ka sjellë deri këtu.

Edhe teknikat si: thyerja e kronologjisë racionale shkak-pasoje me fragmentarizmin emocional elipsoid, rivlerësimi i vetës së dytë të dobët për të rrëfyer përballë vetës së tretë të gjithëpushtetshme, përdorimi i ironisë dramatike e cila zhvesh personazhin përpara syve të lexuesit, zbehja e dialektikës për pranëvënien, janë të gjitha veprime narrative në shërbim e në harmoni me projektin tim për një letërsi të së tashmes së intensifikuar.



# "SHQIPËRIA, SI NJË PËRALLË DIMRI?"

**Ekziston një poemë e bukur e Hajnrih Hajnes që nxënësit në Gjermani e mësojnë përmendësh: quhet "Gjermania-një përrallë dimri"; është një copë e fortë e ngulur në zemër, që nuk u shqitet**



Gersa RRUDHA

Rasti humbet lehtësish; që nga kohët e tragjedive greke ta rrokësh, është njëra nga sfidat njerëzore më të vështira. E kjo përfaktin se fshehja, zbulimri apo imajinimi i një realiteti tjetër është një tundim i shpeshtë i demokrative të sotme. E në periu-dhat e fushatave elektorale, në vend që të zvogëlohet, ky tundim shpërhapet kudo. Nuk diskutohet përfakt, por përopinje, që janë petku që i vishet reales dhe joreales përfakt, i ngatëruar më mirë. Mendjet nuk hapen ndaj realitetit dhe arsyes, por bien pre e gjurmët të ideologjive. Në një kohë kur ky nuk është momenti i èndrrave, por i përgjigjeve konkrete. Nuk është momenti i vijimit të zakonit të shumë fushatave të mëparshme, të afirmit përfbllokun të një masë të madhe fjalësh, premtimesh që marrin formën e èndrrave, por që në thelb janë fluska iluzionesh.

Edhe pse ihtarët mund të kërkojnë përdorimin e shpeshtë të kësaj fjalë, qëndron pikërisht këtu forca sekrete e një politikani që kërkon të kapërcejë hendekun e një politike të re: të "zhgënjejë" ihtarët e të gjithë ata që i kërkojnë të përdoren nëpër fjalime fjalë "ëndërr", barabar me premtimet e mëdha e të bujshme; sepse është kjo forca e vërtetë e premtimit të bazohet tek carpe diem-i i Horacit, që mbërrthen realitetin e sotëm që i përgjigjet pyetjeve të realitetit të sotëm, duke e ditur mirë që ka shpresë që politikanët i krijojnë e i shpërhapin me art, por pa i besuar as vetë, pa pasur as mjetet e financat e atyre qyteteve e të asaj Shqipërie që përshtakuajnë, madje pa e ditur edhe se èndrrat e shpresat janë flakë që ndizen, por edhe që bëhen hi; janë instrumente që përdoren përfakt, por edhe përfakt të joshur besimtarët. Mirëpo, pas asaj masakre iluzionesh që kemi pas supeve të gjithë këtyre viteve, nuk na lipset asnjë premtim i llojut që mund të na bëjë të besojmë se po "tunden malet", se po "fluturojmë në horizonte të qetë e të sigurt". Jo, nuk u lipsen të tilla èndrra skeptikëve; ata kënaqen edhe me shumë më pak. "Na mjafton të mos ndjejnë përcim, çdo zgjim në mëngjes!", thonë deri në cinizëm.

Ekziston një poemë e bukur e Hajnrih Hajnes që nxënësit në Gjermani e mësojnë

përmendësh: quhet "Gjermania-një përrallë dimri"; ajo jo vëtëm që është e vështirë në përkthim por e vështirë edhe të transmetohet se çfarë nënkopon vërtet përfjetshme: është një copë e fortë e ngulur në zemër, që nuk u shqitet. Poeti rrëfen se si kthehet një ditë në atdhe, e dëgjon një ninullë të çuditshme të kënduar nga një vajzë, me një ndjenjë të vërtetë, por me zë të gënjeshtët: ninulla evokon dashurinë dhe mizoritë e dashurisë, sakrificën dhe ritakimin në një botë më të mirë, ku rreshtin të gjitha vuajtjet.

Është një këngë që evokon tokën si një luginë lotësh, që evokon gjëzimet që zhduken shpejt në Botën e Përtjejme, ku shpirti noton e transfigurohet në èmbëlsitë e përfjetshme. E përpikërisht në këtë pikë, në këtë atmosferë të magjishme, Hajne e ndryshoi tërësisht tonin, aq sa e këpup krejt magjinë. E kjo përfaktin se "një këngë e tillë ishte kënga e vjetër e dorëzimit, ninulla e qillit me të cilën përkundet populli në djep", siç e përcakton Hajne. Ja, një ton të tillë që të na këpusë magjinë e èndrrave të parealizueshme, të premtimeve boshe e fjalëve të papërmabujtrara do të donim të dëgjonim përgjatë zhvililimit të çdo fushatë elektorale. Tëk e fundit, është kjo risia që i kërkohet sot politikës: ta reshtë zakonin e premtimeve që aq shumë të zmadhuara e propaganduara ngjajnë me èndrra e fluska iluzionesh; t'i këpusë krahët èndrrave që nuk kanë një raport të caktuar me faktet dhe realitetin. I kërkohet të èndrrojë me seriozitet, le ta zëmë sipas mënyrës së Martin Luter Kingut: përfaktë parathënë një botë që sështë akoma, por që diktohet, dhe jo botën që do t'i shërbente si fron a si një instrument përfakt. Ja, një ndarje e prerë e këtyre dy èndrrave kërkohet nga politikani, e jo pse epoka janë është bërë cinike dhe i përbuz èndrrat, por ndoshta pse ajo tashmë është më e dëshirueshme përvërtetësinë.

Ajo është e hapur përfakt, vëtëm nëse ato arrijnë ta përmirësojnë realitetin, duke i zhvilluar mos-koherencat e duke e prapësuar nëse vëtë realiteti është krejtësisht i shuar nga èndrrat. E kjo, sepse ekzistojnë dy mënyra të èndrruari, ashtu siç ekzistojnë dy utopi të ndryshme. Ekziston èndrra që i arratiset realitetin, duke e shqetësuar shumë pak përfakt, shtrëngesa të tilla si koha, kostot apo hapësira. E në krahun tjetër ekziston èndrra

profetike, që e vëzhgon realitetin me një imprentësi të pamëshirshme, përfaktë parë akoma dhe më qartë pas dukjes apo pamjes së tij. Kjo mënyrë e dytë èndrrimi nuk e injoror realitetin, por e zhvillon duke denonuar gabimet dhe shtrembërimet.

Kohët dhe fushatë elektorale që kemi lënë pas krahëve, kanë qenë të mbushura plot me èndrrat e para, e goxha të varfara nga të dytë. Kanë qenë të mbushura me èndrra që në realitet provuan të janë masakra shpresash, fluska iluzionesh, vetë-zhgënjime të thekshme. Fluskat e èndrrimit krijuhen kur vëprimi i një njeriu, i një banke apo një kombi mbështetet mbi iluzionet në vend të realitetit. Por, ajo çka është më e keqja, është se fluska e èndrrimit të jep përshtypjen e një fuqie që në të vërtetë nuke e ke, të kursem nga të thënët të vërtetën, të bën të mendosh në mënyrë pozitive, kur përreth nuk ke asgjë pozitive. Kështu, kush jeton në botën e këtyre fluskave, nuk përkujdeset përfakt, konkuencat, deri kur realiteti të arrjë të hakmerret. Kush iron në këtë botë është si i magjepsur. Ja, pse në këtë moment, na nevojitet ai ton magjithyes i Hajnes ndaj këngës së bukur të vajzës èndrrimit. Sepse çdo lloj zhgënjimi prej këtyre èndrrave hap greminë para nesh. Ashtu si të që bërrë prej sapuni, fluska e èndrrës të mbështjell në një membranë transparente, që të shkëput nga realiteti. Sa më të stërmëdha iluzioni, aq më e zgjatshme është kjo fluske që aq më i frikshëm shpërthimi i saj. Èndrra të këtij lloji fillojnë me brohoritje e mbarojnë duke shkaktuar në fillim pakënaqësi, pastaj zhgënjim, e në fund cinizëm. Po e njëjtë gjë ndodhi edhe me utopitë e shekulit të shkuar: prej èndrrave nuk mbeti asgjë veçse një pushtet i bazuar tek frika.

Cinizmi nuk e kapercën këtë tip èndrr, por është shtrembërimi i saj. "Bëna të èndrrojmë!": -thotë ciniku post-utopik, duke fantazuar përfaktë fitimin e një posti drejtues a një pozicioni fitimprurës, duke haruar në fakt, në vijimësi, se politika ka detyra të caktuar, të përpikta, kur propozon një èndrr: duhet të mbajë fjalën, duhet të ketë kurajon të shpërheqë çmimin e gjëratëve, duhet të mendojë të mirën e përbashkët dhe jo të mireni, e një grupi apo një klase (ose segmente të kryqëzuara klasash të caktuar). Politika duhet të çlirohet nga gjumi

dogmatik që konsiston në një veprim pa raport me eksperiencën. Duhet të preokupohet në zgjidhjen e problemeve, që nënkopon kapacitetin përfaktë paguar borxhet që ka me publikun.

Mirëpo politika nuk është vetëm e tillë; politika është edhe propozim èndrrash që vlejnë, që zgjasin, që nuk cakëzohen të fotografojnë realitetin e çastit ose realitetin e djeshëm. Të ndërfutësh parinur e realitetit aty ku mbretëron veçse iluzioni është mënyra përfaktë shpëtuar imaginatin e pazënë në kurth nga marrëzia, e kësijo, pikërisht ai horizont që kemi nevojë. Eksperiencia tregon se skepticizmi dhe carpe diem nuk janë të vetmet zgjidhje, pasi edhe ato lipset të gjykohen me dyshim kur kalohet nga privatja në politikë. E kjo, sepse skepticizmu i zhgënjyer e ka të vështirë të shndërrohet në një èndrrimtar të vërtetë, d.m.th. të zotërojë një èndrr profetik që shpjegon të këqijat dhe propozon ilaqet përfaktë t'i mjequar. E ka të vështirë të njohë kapacitetin që herë pas here e zotëron vetëm èndrrimtarë dhe që rrallë është shenjë dalluese e të ashtuquajtur pragmatist: aftësinë përfaktë shkuan larg, përfaktë menduar përfaktë gjeneratën e vet, por edhe përfaktë gjeneratët e tjera; para së gjithash, përfaktë parë falsitetin dhe iluzionin që mund të veshë vëtë petkun e realitetit.

Ja, një politikë e tillë me një aftësi të tillë èndrrimtarë i nevojitet fushatave të së ardhmes. Aq më tepër që fshehja e realitetit është njëra nga tundimet më të shpeshta në demokracitë e sotme. E përfaktë shpjeguar sa më mirë, do të që me vend të citonim këtu një mendim të shkëlqyer të Paskalit në librin e tij "Mendirë", në lidhje me vrapimin tonë të ethshëm drejt humnerave. "Nuk kemi të bëjmë me një vrapim inert, fatalist, individualist, pasi inercia zotëron edhe një trishtim fisnik. Është një përshtypje i mbushur gjithë aktivizim, gjithë zhurmë. Ne vrapojmë pa u shqetësuar aspak përfaktë gremin, pasi kemi vënë diçka përpëra nesh përfaktë na penguar ta shohim", -thotë autorë. Në mënyrë të përpikët kjo është ajo që ndodh me një èndrrim sy-hapur, e përpikmërisht kjo duhet t'i shmanget edhe çdo èndrrë të propozuar politike. Sepse janë të shumta gjërat që të ethshëm përfaktë prentuan përfaktë propaganduar mund t'i vërnë si fashë përpëra syve përfaktë mos parë realitetin.

Dhe është përsëri Paskali, ai që flet përfaktë atë "që besojnë të shohin atë që nuk e shohin aspak", apo përfaktë "imagjinatën e shfrenuar si mjeshtren e gabimit". Imagjinata pa kurrfarë raporti me realitetin nuk është më pak kanosë nga frika; e ashtu siç ekziston një politikë shpresë-njallëse, po ashtu ekziston edhe një politikë e imagjinatës false, që gërenj e miklon. Ja, pse nuk lipset të shkojmë syfashuar drejt greminës. Përkundrazi, jemi gjithmonë në kohë ta heqim fashën e gënjeshtës dhe përkundjen me premtimet false. Është më e lehtë sigurisht të bësh premtimet e sloganëve shpresëmëdha, llogarinë e të cilave do ta paguajnë gjeneratët e ardhshme. Ndoshta, edhe mund të fitosh zgjedhjet. Mirëpo, gremina përpëra së cilës e çon elektoratin, nuk ndryshon vend, është po aty. Është në natyrën e saj të mbetet po aty! Ja, pse nuk na duhet një èndrr që të propozoj një realitet të gënjeshtët, një iluzion e një marrëzi ciqizmi. Por, një èndrr profetik, një èndrr realiste që ndoshta është edhe utopia unike që ka një raport me realitetin, pikërisht përfaktë që lind jo nga një arrati, por nga një prirje përfaktë zbulimin e këtij realiteti. Ashtu si përgatitja e një të ardhmeje më të mire përfaktë fëmijët e nipërit tanë është e vëtmja utopi realiste, po ashtu edhe braktisja e këtyre lloj èndrrave nënkopon zhgënjimin, ciqizmin e vërtetë, ose e thënë ndryshtë, burgosinë iluzionet e së djeshmes. Ja, pse do të që një kthesë historike organizimi i një politike jo të determinuar nga premtimet, por të themeluar mbi zhgënjimet.

Në shiritin e kohës

# TRIMI SHQIPTAR SYLË TETOVA

Sipas rrëfimit të Ashik Kenziut, Syla ka marrë pjesë edhe në betejat e Abdurrahman Pashait në viset tjera të shtetit Osman. Duke folur për trimërinë e Sylës, Ashik Kenziu e përmend se ai ka marrë pjesë edhe në luftë kundër rusëve dhe aty ka treguar trimëri të rrallë

## Metin IZETI

Poeti nga Qiproja Ashik Kenziu gjatë vizitës së tij që ia kishte bërë Tetovës në fillim të shekullit të XIX, është frymëzuar nga shumë ngjarje të veçanta të populsisë shqiptare dhe ambientit në qytetin e Tetovës, që asokohe udhëhiqej nga Abdurrahman Pashai. Ndër poezitë e tij të shkruara për Tetovën dhe shqiptarët e kësaj ane, është edhe një poemë që ia kushton njërin nga eprorët ushtarët të Abdurrahman Pashës, i cili quhet Sylejman, por siç thotë edhe autorë, shqiptarët atë e quanin Sylë dhe me këtë emër ishte i njohur në shumë vende përreth.

*Një trim e takova brenda në Tetovë  
Ishte pehlivan e guximtarë i rrallë  
Ishte këngëtar, por edhe trim pa frikë  
Trimëria i dëgjohej anembanë*

*Abdurrahman Pasha i do trimat pa masë  
Guximin ia vërejti e nxori në ballë  
Në përlleshjet e Prizrenit u tregua i shkathëtë  
Që atëherë e njohën për trim të rrallë*

Për shkak se kjo periudhë e sundimit të shtetit Osman është përplot me mosmarëveshje dhe kryengritje, veçanërisht në trojet që janë udhëhequr nga pashallarë shqiptarë, gjithsesi se ka pasur edhe përleshje ndërmjet mbështetësve të reformave të bëra nga Sultan Mahmudi II dhe atyre që nuk pajtoheshin me këto reforma. Veçanërisht shpërbërja e rendit ushtarët këtë jeniçerëve që përbëheshin kryesisht nga shqiptarët ka ndikuar në rebelimin e një numri të madh të ushtarëve të vjetër kundër reformave të Sulttan Mahmudit II. Si rrjedhojë, në këto kohë me trazira, gjithsesi se është nevojitur rruajta e rendit dhe qetësisë në qytetet shqiptare dhe komandanti ushtarët i Abdurrahman Pashait, Syla, ka qenë një ndër personat kyç në vendosjen e rendit në sanxhakun e Prizrenit, ku bënë pjesë edhe Tetova dhe Gostivari. Ashik Kenziu, gjithashtu, theksion se Syla ka marrë pjesë edhe në shumë luftërat bashkë me Pashain dhe nga të gjitha është kthyer si fitimtar.

*Shumë vende ai ka çliruar  
Me nëntëdhjetë armiq përnjëherë ka luftuar  
Gjaku rrëke i rrëdhte, shumë është plagosur  
Në rrugë të Pashait, Syla, është gjakosur*

*Nuk u zbraps edhe kur është plagosur  
Zjarri nuk iu shua armikun pa e sosur*

*Të gjithë guximin ia kanë lavdëruar  
Gishtat i kafshuan njerëzit, Sylën duke uruar.*

*Ushtar i Abdurrahman Pashait, ai shpirt ishte  
Nuk kishte të barabartë me të në peshore  
Sylejman ishte emri i tij në tyrcë  
Namin, Sylë, e kishte ky trim në arnautce.*

Në vazhdim të poemës, Ashik Kenziu, flet për virtytet e Sylës, por njëkohësisht edhe të ushtarëve dhe trimave shqiptarë në periudhën osmane. Ai e theksion se prej shqiptarëve dalin shumë trima të cilët njëkohësisht janë edhe të singertë dhe besnikë.

*Nga shqiptarët dalin trima me famë  
Nuk ju dhimbsetjeta, janë guximtarë  
Por, si Syla, del një në njëmijë  
Statujë e guximit është Syla në këtë anë.*

*Besnik është, nga ta thirrësh vjen menjëherë  
I drejtë është, mos mendo se del tradhтарë  
Në rrugë të zotnisë shpirtin flion, hë, pa thënë  
Një trim i tillë është Syla i mbarë.*

Sipas rrëfimit të Ashik Kenziut, Syla ka marrë pjesë edhe në betejat e Abdurrahman Pashait në viset tjera të shtetit Osman. Duke folur për trimërinë e Sylës, Ashik Kenziu e përmend se ai ka marrë pjesë edhe në luftë kundër rusëve dhe aty ka treguar trimëri të rrallë.

*Në luftë vajti, pasi zotnia e urdhëroi  
Trim të shohin, kaurët e Moskës, përparrë u doli  
Ishte komandant i mijë ushtarëve, beteja udhëhoqi  
Zotni me famë është Sylë shqiptari.*


Ishë traditë e hershme në trojet shqiptare të këndohet këngë për trimat, si rrjedhojë, rrëfen Ashik Kenziu, edhe për Sylën janë kënduar këngë trimërie dhe heroike në këto anë.

*Trimëria e tij të le pa fjalë  
Në shqip i është kënduar këngë  
Le të jetë një kujtim nga Kenziu kjo poemë  
Që të mbahet në mend emri Sylë*

Në shiritin e kohës

# DEMOKRATI I ANATEMUAR

Në Plenumin e Beratit tetor 1944, Sejfullai e kritikoi ashpër Enver Hoxhën për lëkundje të vijës së partisë midis dy ekstremeve, oportunizmit dhe sektarizmit. Vrasjet e kundërshtarëve politikë nga njësitet guerile a nga atentatorët, në rrugë e nëpër lokale, të kryera me urdhër të Partisë, ai i cilësoi akte terroriste



Naum PRIFTI

Sejfulla Malëshovën nuk pata rast ta takojë asnjëherë, por qëkur lexova poezinë "Si e dua Shqipërinë," në antologjinë e

klasës I të shkollës unike, kisha simpati të madhe për të. Poëzinë e mësova përmendësh, pa na e dhënë detyrë mësuesi. Më vonë, nga mesi i viteve '50, dëgjova se Sejfulla Malëshova ndodhej

në Patos dhe punonte si magazinier te një nga depot e ndërmarrjes së naftës. Këtë ma tha kunati im, Dhori Çauši, i emëruar ndihmësmejk-dentist në Patos. Në fakt Sejfullain e kishin internuar në Patos dhe sipas rregullit duhet të flinte në dhormë më vete, po për ngshticë strehimi, e rrësën tok me 5-6 djem të rinx beqarë. Kjo ishte një tjetër shpërfillje për të. Flinin si në konvikt, me shtrëtë druri ala-marinarçe, një poshtë, tjetri sipër. Dhori më tregonte se në stinën e ftohtë të dimrit, profesori mbështillej me batanie dhe kërrusur mbi shrat lexonte ose shkruante. Në periudhat e shkurtra të zbutjes së luftës së klasave, Sejfullai erdhë disa herë në Tiranë për punë personale, sigurisht duke marrë lejë nga Dega e Brendshme e Fierit. Zbutjet ishin si pranvera të hershme, të cilat pasoheshin gjithmonë nga acare dimri më të hidhura. Një ditë, ndërsa ndodhesha përparrë Liceut Artistik duke biseduar me Prof. Skënder Luarasin, pashë të kalonte te ana tjetër e trotuarit një burrë i moshuar, me

ecje të qetë, paksa i ngadalshëm, i përqendruar, pa shikuar as majtas as djaththas.

- E njeh atë burrë? - më pyeti profesor Luarasi.

- Më duket se jo, - i thashë. - Profesor Sejfulla Malëshova. - më tha ai.

E thërriti me emër dhe Sejfullai ktheu kokën e përshëndeti me dorë, buzëqeshi hijshëm me mirësjellje dhe vazhdoi rrugën e vet.

- Në Tiranë ai u mënjanohet takimeve se dyshon që e gjurmojnë. Tregohet i kujdesshëm, për të mos vënë asnjeri në pozitë të keqe, - më tha ai.

Lexuesi i vërmendshëm, që ka ndjekur rrjedhat e poezi të sonë bashkëkohore, qysh në poezinë e parë të këtij vëllimi vëren se ka të bëjë me një autore që nuk ndikohet nga kaosi i zërave të kohës, por këmbëngul në artikulimin e botës së vet emotive përmes një shprehësie që dallohet me tendencën e ekonomizimit të gjuhës e që shkon drejt një stil lakonik; tendencën e shmangjës nga figurat e klishtetizuara, krijimin e figurave befasues, funksionalizimin e tyre brenda poezi të dhë thjeshtësinë e ligjërimit që përmes forcës depërtuese të mendimit rezulton me krijimin e emocionit të fuqishëm. Me këto veçori, mënyra shprehëse e krijueses Nafije Zogaj shfaqet si vazhdimësi e propozitës estetik që për herë të parë në letërsinë shqipe e sjell poeti Xhevdet Bajraj, poezi e të cilët, deshëm ta pranojmë ose jo, e ka lëvizur rendin e hierarkisë së vlerave në krijim-

Nafije Zogaj

## HËNA VEZULLONTE NË TË VERDHË TË VDEKJES



FAIK KONICA

tarinë letrare shqipe. Nga ky këndvështrim, vëllimi poetik i Zogajt duket se po hap shteg të ri në formimin e një shkolle poetike. Ndikimet e tilla dhe formësimet e shkollave të veçanta që nisin si propozitë estetik i një autori, për të vazduar më pas me shumë të tjerë, në letërsitë e popujve që kanë traditë më të gjatë dhe më të pasur të zhvillimit, janë jetet të rëndomtë. Por, se a do të ndiqet kjo rrugë në të ardhmen edhe nga krijues të tjerë të rinx mabetet të shihet gjatë viteve në vijim.

Nëse si pikërisje për vlerësimin e poeziës marrim mendimin e Aristotelit se: "Dhunita për të përdorur metafora është ajo që e dallon poetin nga ne të tjerë" - atëherë mund të themi se Nafije Zogaj e përbush plotësisht këtë parakusht, ngase në poezitë e saj, metafora jo vetëm që shfaqet si figurë mbizotëruese, por edhe përdoret me mjeshtëri. Për më tepër, metaforat funksionalizohen plotësisht brenda poeziës duke arritur të krijojnë emocionin e fuqishëm, si një tjetër komponent që Thomas Hardy e konsideron esencial për një poezi të realizuar ("Poezia është emocion i vënë në varg"). Kështu, në poezinë e Zogajt na shfaqen qiej të varur në gishtërinj, zogj që bien në thellësi të syve, dritare mbi kodër, dhimbje që rrjedhin përmes lëkurës, apo që kullojnë në qell, fëmijë që mbahen për re, ëndrra që mbahen në grushë e shumë metafora të tjerë, të cilat shpeshherë krijojnë imazhe surreale që përkonjë me të vështruarit dhe kuptuarit specifik të botës nga perspektiva e fëmijës.

Marrë në tërësi, poezitë e vëllimit "Hëna vezullonte në të verdhë të vdekjes", trajtonë një shumësni të shumësni të motivesh që vijnë si reagim ndaj përfjetimeve që

kanë trandur botën shpirtërore të autoreve, apo si reflektime ndaj observimeve të realitetit të ashpër, të cilat janë ndarë në pesë cikle: "Quell i varur në gishtërinj", "Me diell në fyt", "Njeriu me flokë ngjyrë akulli", "Diçka si vetëtimë" dhe "E verdhë mbi të zezë". Meqë secili cikël meriton vërmendje të veçantë, kësaj radhe do të ndalemi vetëm në poezitë e ciklit të parë, që paraqesin një kthim në të kaluarën, gjegjësisht një rrugëtim retrospektiv që nxjerr nëpërmjet mediumit të jashtëm të hapësirës". Rizbulimi i përfjetimeve, ndjesive, përvjave e perceptimeve të 'harruara' që kanë vënë themelët e unit të subjektit lirik, bëhet duke u nisur nga shtëpia që: ishte e ndërtuar me gurë të zhveshur nga myshqet / drurë të harruar, qerpicë e djersë të njoma / me një arkitekturë të tillë / që dielli i binte nga të gjitha anët. (Shtëpia e dallëndysheve) Këmi pra shtëpinë e fëmijërisë, si simbol hapësinor të së kaluarës së largët, që shpreh gjëzenë e identitetit subjektiv dhe në të njëjtën kohë krijon distancën, por edhe ndryshimin, mes të kaluarës dhe të tashrimes. Shtëpia, së cilës dikur i binte dielli nga të gjitha anët, është po ajo shtëpi që tani: hija i bie / gjithnjë në të njëjtën anë. Këto dy perspektiva mbi të njëtin objekt, shfaqin kujtesën si një proces aktiv, brenda të cilët imazhet transformohen, rindërtohen dhe marrin kuptime të reja poetike.

Nëse jeta gjatë fëmijërisë ndriçohet nga të gjitha anët, në një moshë të mëvonshme, situatë e saj që shkaktojnë dhimbje mbeten të mbuluara nga hija, që nuk është asgjë tjetër veçse amnezi

infantile, gjegjësisht shtypje e ndërdjishme. Në këtë kuptim, gjurmimi i vetes që fillon nga fëmijëria, aty ku nis njohja me jetën, ndalet në disa dukuri e situate që, nëse jo për riparim, së paku, kanë nevojë për rishqyrtim. E tillë është edhe përballja me vdekjen. Madje, është pikërisht pamundësia e konceptimit të vdekjes nga mendja e fëmijës, ajo që bëhet barri-erë për rikrijimin e peizazhit të plotë të parajsës së humbur. Kujtesa e subjektit lirik, që shfaqet si domosdoshmëri për të depërtuar në të gjitha humnerat e ndërdjies, ndalet në ato momente që nuk kanë arritur të marrin shpjegimine të pranueshëm, apo edhe që kanë lënë vragë në imagjinatën infantile si dilema të pazgjidhshme: Me siguri ishe në shtëpi / Nuk ishe në shtëpi apo: për çudi / mu më kërkoni / më vinin pas / ty jo (Teksa fluturoje me krahë èndrrash).

Pamundësia e dikurshme e zotërimit të situatave vështirëson edhe përpjekjen për ta sjellë të plotë imazhin e fëmijërisë; gjë që krijon përshtypjen e një tabloje që vende-vende duket se është dëmtuar. Prej këtu lind edhe mohimi i përpjekjes për t'u rikthyer: "nuk dua të kthehem në të kaluarën / unë isha atje / dhe nuk munda ta shpëtoj fëmijën që më rrëshqiste nga krahët / e mbytej në një pellg / të turbull / të errët / të thellë". (Unë isha atje) Mirëpo, përkundër mohimit të vendosur, kthimi bëhet, dhe ky kthim në një varg poezish shfaqet në imazhet ku dukuritë, objektet, njëzitë dhe relacionet me ta zhvishen nga kompleksiteti, për t'u parë në një dritë tjetër, nën dritën e pafajësisë, që në këtë rast realizohet plotësisht, sado që qasja e subjektit lirik është retrospektive. Në figurën e nënës, personazhit strumbullar përmes të cilët krijohen më tej ndërveprimet me botën përreth, gërshtetohet në njëren anë forca, sepse me duart e saj: ka përshtkuar anë e përtjej / diellin akull / shiu zjarr, ndërsa në anën tjetër butësia, ngase ajo qante: vetëm kur ndonjë dallëndyshe e vocërr / duke pritur gojëhapur ushqimin / binte nga pragu i folesë / dhe nuk arrinte ta shpëton / nga goja e maces. (Nuk di shumë për jetën) Dualizmi që përvjon portretin e nënës, paraqet një formë të pastër infantile të njohjes emocionale; prandaj jo rastësish nënës i përshtkuhen dy cilesi, që sado antagoniste në dukje, janë të domosdoshme për të siguruar baraspeshën dhe stabilitetin e fëmijës përgjatë trajektorës jetësore.

Megjithatë, vëllimi poetik "Hëna vezullonte në të verdhë të vdekjes" përveç qasjes së mësipërme, ofron edhe shumë mundësi të tjera në rrafshin analistik, që padyshim do të përfshihen në një punim të ardhshëm. Poezitë e Nafije Zogajt japid një shembull të veçantë se aftësia për të parë thelbin e gjérave, e ndërthurur me aftësinë për t'i rrëfyer ato me emocion, janë parakushte për një poezi të realizuar. Zogaj nuk ngarend pas temave të 'mëdha', nuk përpigjet të fshihet pas petkut të hermetizimit, nuk përdor dialektizma e lokalizma për të arritur efektin emocional, ajo thjesht eksploroni kujtesën e saj, rrugëton në universin brenda vetes, përpigjet t'u jep emër ndjesive dhe dukurive që nuk ka arritur t'i emrëtojë dikur. Dhe është pikërisht kjo qasje e natyrshme ndaj krijimit dërgjegjësia ndaj fjalës, që e rendisin veprën e Nafije Zogajt në mesin e veprave më të suksesshme të botuara vitet e fundit në letërsinë shqipe.

# BISHTI

(Pamje)



## Shpresë QERIQI

Jashtë bie shi i shpeshtë me erë; rrëmbyeshëm piklat e tij përplasen nëpër dritare. Burri e dëgjon me vërmendje (i bëhet se e dëgjon tek kallon vajtueshëm mbi pullaz) prandaj i duket sikur shi bie edhe nga tavani. Mbrapa ka lënë një korridor të ngushtë por ai tash qëndron përparrë derës. Shtrin duart në të njëjtën lartësi me barkun derisa ndjen se ka prekur dërrasën, pastaj rrëshqet gishtërinjtë që të gjiej doren. Kthehet nga ana tjeter për ta kuptuar nëse e ka gabuar drejtimin. E hap derën dhe e mybill pas vetes. Vajza qan por zëri i saj dëgjohet më pak. Burri nis një hap të shkurtër, bën dy-tre hapa, ndalet sa një frysëmarrje dhe niset prapë. Një dhimbje e fortë dhe e gjatë njësoj si shpimi nga një gozhëdë ia ndal hapin. Eshtë cepi i tavolinës. Katër cepat e saj janë me teh. Ndalet një grimë nga dhimbja, përpitet, por nuk kujton përsë ajo ndodhet aty e jo pranë dritares. Shan më të vogël dhe fërkon gjurin me shuplakë të dorës.

Burri merr drejtim të ri. Shtrati eshtë dy hapa larg. Nga e majta e tij eshtë kutia prej kartoni, afro një metër e lartë por përgjysmë e gjerë. Kutia eshtë e hapur ndaj veç kërruset dhe fut të dyja duart brenda. Ndjen se ka prekur diçka dhe tekxa e nxjerr dhe e shtrëngon me shuplaka, me njëren dorë përpitet t'ia zbulojë formën. Eshtë e butë, e fryrë si një top. Diçka e gjatë dhe e hollë i varet. I ngjan si një bisht. E kupton nuk eshtë një bisht por një hundë elefanti. E hedh tutje. Burri merr të rrëmojë përsëri, në duar ka diçka rrumbullake, në njëren anë heton dy këmbë të vogla, mes tyre një qafë të gjatë. Mendon se eshtë një breshkë, sepse ai kishte prekur breshkë kur ishte fëmijë, madje e kishte qëlluar disa herë me gisht

në zhguall. E qëllon disa herë dhe e afro teveshi i djathëtë por nuk dëgjon asnjë tingull. Vajza qan tërë kohën; burri e dëgjon bashkë me shiun që përplaset xhamave; në vesh herë i vjen një me të, e herë ia del t'i dëgjojë ndaras. Tash me gishta kap një gjë të butë- ai me zor i dallon- në kuti ka më shumë gjëra të fortë. Nuk përpitet të kuptojë cilë kafshë mund të jetë, arushë nuk eshtë, sepse ka dy këmbë të gjata. Që të mos i bjerë prapë në dorë ulet ngadalë dhe e lë në dysheme. Tani ka përveshur mëngët. Nervozizmi i kalon nëpër gishtërinj. Një gjë të fortë e kalon nëpër gishta, me një bark të fryrë dhe këmbë të vogla. "Eshtë një sqep", e buzëve të zbehta i ndrit një gaz. Nëpër mend kalon fëmijërinë e tij, lodrat atëherë ishin të gjalla, pula, zogj, qen dhe mace. Kujton më shumë pulat me zogj dhe scepin e njërs që ia çokiste gishtat e këmbës kur ishte fare pranë zogjive të saj. Burri ndjen diçka me këmbë (realistë ai e ndjen me gishtat e këmbës së djathëtë) ndaj përkulet dhe e kap. Inatshëm tash po e shtyp dhe po e ndrydh në njërin grusht feçkën e elefantit që minuta më parë e kishte hedhur në dysheme. "Elefant i mutit"- mërmërit, dhe e hedh me nervozizëm. Ndjen se po humb durimin, megjithatë nuk ia mban të kthehet me një elefant. I vjen në vesh prapë zëri i saj. Fut kokën mes duarve pastaj me shuplaka mbulon veshët që të mos e dëgjojë. Tash duart e tij janë përbrenda kutisë prej kartoni, brenda kanë mbetur gjëra të fortë, gjysmë të buta ose gjysmë të fortë. I nxjerr të gjitha jashtë saj me nervozizëm. Drejton trupin dhe i lë të lira duart. Nuk kujton dot ku tjeter mund të ketë lodra. Shiu nuk përplaset më xhamave (as nuk i bëhet më se e dëgjon tek kallon vajtueshëm) por vajza qan njësoj. Ashtu qëndron disa sekonda, dyshemeja tanë eshtë përplot lodra, i shtyn ngadalë me këmbë që të mos

pengohet, pastaj ec në drejtim të shtratit dhe ndalet atëherë kur nën gju ndjen dërrasën e poshtme të tij. Sot në mëngjes nuk ia ka rregulluar shtratin së bijës, çarçaf që i lidhet duarve e nervozon edhe më shumë. Gjen jastëkun dhe e hedh kur në cep të shtratit heton diçka. Merr gjënë e butë në duar, eshtë e madhe por ia del ta shtrëngojë me shuplaka. Dy vesh të vegjël, mes tyre dy pulla, mes pullave një feçkë. Mbrapa nuk ka bisht. E mbërthen një emocion i lehtë dhe ofshanë i çliruar. Arushën (lexo: nëse me të vërtetë ishte e tillë) e mban me njëren dorë, me tjetrën gjunjazi kërkon jastëkun. Ngrihet në këmbë, arushën lë në shtrat, bie gjunjazi prapë dhe kërkon jastëkun. Nuk kujton dot nga cilë anë e shtrat e ka hedhur, ngrihet, drejton trupin dhe pushon. Tash merr frysë i qetë, arushën mban në dorë, në mendje i vjen zëri i bashkëshortes, por nuk e kupton më çfarë e shqetëson më shumë. Ajo që do t'i flasë njësoj sikur atëherë kur ishte ngatëruar keq me kutinë e qumëshit dhe i kishte dhënë fëmijës tre muajsh lëng portokalli, apo se ai lehtësish mund t'i kishte marrë erë (lexo: sikur t'i kujtohej) dhe ajo nuk do të kishte përsë t'i bënte të gjitha vetëm, madje nuk do të përpitet kaq shumë, edhe nëse vetëm për të fshehur nervozizmin në zërin e saj. Në mendje i vijnë gjithfarë fjalësh, të shajë, të shfryhet e të bërtasë me sa ka zë. Një arushë, nëse me të vërtetë ishte e tillë, e kishte sjellë deri në atë pikë sa për dreq sa keq që nuk i lejohej t'ia këpuste ato dy pulla dhe ta linte vetëm me një feçkë. Arushën fut nën imjekër, s'ka kohë të rregullojë shtratin por me të dy duart përpitet të zhvendosë tavolinën. Diçka e pengon; përkulet ta largojë.

Nuk arrin të bëjë as më të voglin dallim, kanë një madhësi, dy vesh të vegjël, dy pulla dhe një feçkë. Një drithërim i përsh-

kon trupin. Ka gjetur një tjeter arushë. "Dua arushën e kuqe". Në mendje i vjen zëri i saj i hollë, njashtu hollë e godet supeve; nuk e dëgjon më tek qan, por plogështohet (lexo: Shpirti iu ndrydh pak; fryma i harxhohet në gushë; ose shiu që përplasej xhamave tash sikur e godet trupit, dhe vajtueshëm kullohet mbi të). Me gishtat e njërsës dorë shtrëngon tëmthat, derisa ndjen si i rreh damari. Pastaj i zhgënjet e pronan se nuk ka si dreqin ta dijë se cila eshtë e kuqja! Tani po mendon një numër; gjashtë ende beson në fat. Në mendje nuk i vjen asnjë i veçantë. Numrin tetë as nuk guxon ta veçojë. Ai kishte mbetur si numrat e tjerë pavarësisht që në një ditë krejt të zakonshme si kjo, një tetë, një datë që mbante përparrë një tetë, ishte ditëlinjë e tij. Nuk ka kohë të mendohet, numrat janë thjeshtë numra, datat gjithashtu, fundja ç'rendësi mund t'i jepte sot ditëlinjës së tij. Ashtu në ankth u nis me të dyja dhe gjen derën me lehtësi. Mybill derën pas vetes dhe drejton trupin. Përparrë ka korridorin e ngushtë. Niset dhe ec përgjatë murit. Numreron hapat. Në hapin e nëntë ndalet, përkulet dhe lë poshtë njëren arushë. Burri bën një gjest me krahët. Duket sikur i shkund. Me njëren dorë prek kornizën e derës, ndalet një copë herë përparrë saj, ndjen gjoksin si i fryhet e i shfryhet papushim, pastaj mbledh veten dhe e hap. E thërrret në emër dhe zëshëm e mybill derën por askush nuk i përgjigjet. Tash burri eshtë pranë divanit, ulet dhe zgjat dorën, dallon këmbën e vogël, pastaj këmbën tjeter dhe barkun. Jashtë po bie një shi i lehtë pa erë që nuk dëgjohet fare dhe vajza tash po fle.

U lëshua i lodhur në kolltuk. Tash përballë saj rri e qetësohet. Fshin djersën prej ballit me shuplakë të dorës. Ndjen si i pushojnë krahët dhe djersën si ia lëmon gishtërinjtë.

# FUQIA SHPIRTËRORE KËPUT EDHE PRANGAT

(Avdush Canaj, "Edhe èndrrat në pranga", "Armagedoni", 2022)


**Adem GASHI**

Përherë kam menduar se pikërisht në èndrra projektohet liria absolute. Më vonë më është rritur dyshimi deri në vetëqortim. Këtij akti i ka ndihmuar Pallati i èndrrave i Kadaresë dhe tashti dorëshkrimi i Avdushit pér Èndrrat në pranga. E çuditshme! Èndrrat që nuk kontrollohen as nga vetë ndërgjegjja autoriale u survejuakan nga një dikush veshur me aureolen e pushtetit, të tiranisë, të diktaturës! Èndërrimi, ndërkaq, èndërrimi i figurshëm rezulton tjetër. E pra, liria absolute i mbeti mendjes, asaj të pakontrollueshmes e të pandalshmes. Kjo liri mendjeje i dha dorë autorit që edhe me tagrin e sakrificës, brenda burgut, të hedh nëpër fije të letrës së cigareve botën e fiktive, pothuajse si motërzim autentik të botës reale. Ah, ja ku na doli letërsia e burgut që kap dy krahë interpretimi: E shkruar në burg dhe që trajton tematikisht burgun. Kjo, siç nuk është e panjohur në letërsinë botërore, nuk është e panjohur as në letërsinë shqipe. S'do mend që na sillet në kujtesë Burgu i Haki Stërmillit.

Në fundin e shekullit XX na shfaqet me një farfuri mahnitëse Visar Zhiti. Lirikat e tij nga burgu nisin me mbamendje dhe zbardhen shumë më vonë në agun e demokracisë. Këtu morën shkas kritikët dhe studiuesit e letërsisë pér emërtimin, si të thuash, të një formacioni stilistiko-letrar, Bur-gologjia. Pa dyshim që edhe Canaj, me librin më të ri, i përket këtij formacioni. Po, a është ky libër i ri?

Avdushin e njoha në Radiotele-visionin e Prishtinës kur që të dy zumë punë aty, më 1977. Një djalë i ri që vinte me kaçurrela të argjend-ta, ngashëm me Jeseninin, me kulturë, dije e talent pér letërsi. Shënimet autoriale të tij tashmë janë të njobura: shkollimi, vrasja misterioze e të vëllait Alushit nga UDB-ja, burgu e të tjera, por kishte edhe diçka të panjohur që vjen tashti në ditën pér diell, pas dyzë viteve. Është ky libri Edhe èndrrat në pranga. Ai tashmë ka publikuar dybëdhjetë përbledhje me poezi, një me tregime dhe një Tregim-roman, kryesisht pér fëmijë. Tri prej veprave të tij janë nderuar me çmimet më të larta në Kosovë. Unë kurrë nuk e kam marrë të mirëqenë këtë përcaktorin Letërsi pér fëmijë. Poezinë e Canajt, sikundër edhe të mikut të tij të ndjerë, Gani Xhafollit i kam lexuar dhe më kanë shkundur e tunduar estetikisht asgjëmangut me poezinë më moderne pér të rritur.

Duke lexuar librin më të ri nuk ka sesi të mos ndalësh dhe të mendosh: si është e mundur që ky vëllim poetik pér të rritur qenka shkruar në burg me të hyrë të viteve të tetëdhjeta? Si është e mundur të ketë këtë nivel este-



tiko-letrar që mban me kaq dinjitet modernitetin e poesisit deri në ditët tona? S'ka si të jetë ndryshe pos faktit të talentit të rrallë, dijes, kulturës e përkushtimit; përjetimit të thellë dhe të mëvetësishëm; aftësisë vrojtuese dhe depërtuese deri në skutat më të thella të shpirtit njerëzor.

Libri ka një strukturë kompakte. Ndahet në katër njësi: Syri i ferrit, Kur e përplasin derën e qelisë. Do të vij me diellin në duar dhe Kur dola nga ferri. Një vëllim me jo më shumë se 65 poezi. Atmosfera e vargjeve të Avdushit pashmangshëm të nxit shoqërimë idesh me atmosferën e Ferrit të Dantes. Zaten ferri e burgu janë aty-aty me cerberë, ujq e qen-ujqër; me gjarpérinj e hiena. Derisa në librat e tjerë autori na sjell plot drithë e dielle lule e ngjyra, valle tropesh, figurash e metaforash, këtu loja e drithëhjeve është e mezi dukshme në labirintet e qelize. Sepse këtu ka një fajs, një të pandehur pér fajësi se dashka Nënën, Nanëloken, që i bie tagri i atdhedashurisë dhe i lirisë kombëtare. Po a nuk na e tha që në krye të herës autori, në fjalën moto: Në një fije letre duhani, në qeli, shkruaj vjershën pér Atdheun?

Këtu gjithçka nis me arrestimin.

Të tjerat janë butafori bajate të shfaqjes groteske të teatrit nacionalist serb. Dhe arsenali e mjeteve është po ai i inkuizionit mesjetar: dhuna, tortura fizike dhe psikike. Vargjet vijnë të shkurtra, të ngjeshura, por shpesh me një surprizë ironie që të habit. Kështu bëjnë vetëm njerëzit me shpirt të madh: Na i lëshojnë edhe gjarpérinjtë/ Ata bien të ngordhur nga gjaku ynë/ Gjak lirie. Kjo përballje me helmin dhe helmimin gjen serumin pikërisht në gjakun e liridashësve, në gjakun e lirisë. E ç'të thuhet më tepër? Autori jo se është kurnac fjalësh e frazash, jo se bën pozë modestie e snobizmi, por se natyrshëm e dend mendimin dhe ndjenjën. Është kjoarma më e fuqishme e tij përballë njeriut-makinë dhune, përballë gardianit avdall që kundërmon erë rakie e kërmë. Dhe sado që bishat përpigenta terratisin qielin, poeti ka këndin e tij të vrojtimit:

*Dielli megjithatë përbirohet  
kur s'është roja  
dhe na i ngroh  
duart e akullta.*

Një seri poezish vërtet prekin majat si realizime artistike. Të tilla i

shoh varjet në lirikat: Me tela, Pas shpinës së një reje, Qeni, Lapsit ia nxorën zemrën, Vjershat i shkruajtinës, Qelia, Ndoshata e të tjera.

Kush nuk do të tronditej kur të lexonte:

*Hëna s'do t'i shohë  
duart tonë skelet të gjallë.  
S'i shtrëngojnë më as prangat  
ndaj na i lidhin me tela.*

Ose:

*... edhe hëna e pa  
barbarinë e barbarit mbi ne,  
ndaj u fsheh  
pas shpinës së një reje  
për ta fshirë lotin.*

A nuk na i kujtojnë këto varge Poemat e Makronizit të grekut Janis Ricos, kur në formë klithme shqiptonte: Nuk e besonim të jenë kaq të tmerrshëm njerëzit?

Vetëm një poet kalibri, këtu në pozicionin e subjektit lirik, mund të shkruajë kaq durueshëm e me një vetëdisiplinë mahnitëse pér tragjizmin epik:

*Dje Fuadit  
ia thyen krahun e djathë,  
Skendës  
ia këputën gishtin e unazës.  
Sonte  
ndoshta e ka radhën  
njëra këmbë imja!*

E megjithatë, në gjithë librin nuk gjen asnjë çast molepsjeje e dorëzimi, asnjë çast rezignate, disfatizmi e nënshtimi. Duket sikur ky soj krijuesh janë ngjizur me legura të paasgjësueshme. Ndaj i jep zë shpresës dhe besimit: Do të kthehem me diell në duar.

...dhe do të vijë çasti të dalë që andej. Po autori ka një peng dhe i duhet ta thotë:

*Te dera më priste pëllumbi,  
që e ndaja bukën me të përditë,  
nën flatra kishte fshehur varjet,  
poezitë.*

Ndoshata më e saktë do të ishte shprehja: poeti thotë edhe të pathënët. Në gjithë librin nuk kam gjetur shfryrje të pakontrolluar të ndjenjave, sikundër as cerebralitet e përsiatje shterpe pér të krijuar iluzione filozofemash. Është këtu jeta e tëra, e zhveshur nga kostume solemne, por e veshur me atllas mëndafshi të zi, me shpirt e fisnikëri atdhetare e njerëzore.

Avdushi, i ndërgjegjshëm se mjeti artistik i ndërtimit letrar është fjala dhe vetëm fjala, ka déshmuar një kulturë gjuhe që rrallë e shohim te sivëllezërit e tij shkrimitarë.

Unë nuk e di se ç'fshehtësi mban laboratori krijues i Avdush Canës, se ç'sjell e nesërmja e tij pas këtij libri, po e di se këtu na i dha shenjat e një horizonti para agimit të ri.

# DËSHMI E PËRKUSHTIMIT TË POETIT NDAJ POEZISË

**Lasgushi përdor shumë shprehje poetike në ditarët dhe letrat. Gjuha e tij është shumë e pastër, përdor një fjalor të zjarrtë të dashurisë, me muzikalitet dhe ngjyrime poetike**



Sulejman MEHAZI

Çdo kush dhe secili mund të luajë me akrepat e orës, t'i lëvizë ato para ose prapa, por kurrë nuk do të mund t'i kthejë mbrapa akrepat e kohës së vet, mirëpo poeti ynë me një vetëdije dhe mendje gjenni e kuptonte se gjëja më e çmuar në botë është koha dhe nuk e nënverosoi dhe nënçmoi duke shkruar ditarët e tij, pikërisht e kuptoi se koha është pjesë e jetës së tij dhe kjo kohë e bëri poetin të pavdekshëm dhe të përjetshëm. Ditarët janë lloji i letërsisë autobiografike „tregim retrospektiv” në prozë, që një person real e krijon nga ekzistencë e vet personale, kur vë theksin mbi jetën e vet individuale, posaçërisht mbi historinë e personalitetit të vet...“.

Ditarët dhe letrat e Lasgush Poradecit do t'indajmë në dy lloje:

1. Ditarët dhe letrat konspiruese të dashurisë; 2. Korrespondenca, trajtesa dhe letrat të hapura për poezinë.

Ditarët dhe letrat konspiruese apo të fshehta të dashurisë janë: Shqipja, ditar korrespondencë, për këtë botim të librit u falënderohemi vajzave të Lasgushit, Konstandina Gusho dhe Marie Gusho, të cilat e panë të arsyeshme që me rastin e 100-vjetorit të Lindjes së Lasgushit, nga dosja e fshehtë e tij, të botojnë dhe të publikojnë këtë ditar intim të dashurisë së poetit me gruan e tij të ardhshme Nafije Mema. Ditarët janë të viteve 1939 - 1940. Ditarët është i ruajtur me xhelozë të madhe nga poeti, më vonë nga vajzat e tij. Ky ditar nuk është klasik, por është i shkruar në formë letash të dashurisë, frymuar me lirizëm poetik dhe lyer me prozë tregimtare; më shumë anon nga poezia se sa nga proza. Këto letërkëmbimet në këtë ditar janë jo proza poetike, por poezi prozaikë. Vet titulli i këtij ditari është metaforë më vete: „Shqipja, ditar, korrespondecë”, këtë titull me këtë metaforë Shqipja e kanë vënë më aq rrjeshtri bijat e Lasgushit, Konstandina dhe Marie Gusho, sipas letrës që ia dërgon Lasgushi Nafijes, më datë 16 nëntor të vitit 1939, kjo

figurë i jep forcë dhe vlerë shprehëse, ditarit.

E dimë se metafora si figurë mbretëreshë është shpirti i poezisë. Kjo e detyron poetin që të bëhet mbret i kësaj figure më të bukur poetike; kjo figurë mbretëreshë nuk e do falsitetin, këtë e thotë edhe vetë Lasgush Poradeci në ditarin e Meri Lalaj, „Lasgushi në Pogradec”, të datës 30.5.1981, „... se poeti është poet, ai nuk mendon për veten e tij po përlartësirat poetike, poetit nuk i duhet kolktiku, se pastaj nuk do të bëhet poet, por kolktukofag”. Shpesh Lasgushi thotë përveten e vet: „Unë jam anëtar i poezisë”. Kjo na bind se poeti pasi është anëtar i poezisë, ky anëtarësim e ka detyruar që edhe jetën bashkëshortore ta bëjë pjesë të figurës poetike. Pse e themi këtë? E themi, se pikërisht figura e metaforës u bë shkaktare që poeti të njihet me të dashurën e jetës Nafije Mema - Shqipja.

Në vitin 1937, me rastin e kremit të 25 vjetorit të Pavarësisë, në Tiranë, në shkollën e vizatimit, mbahej një ekspositë e skulpturës dhe e dokumenteve të heronjve, intelektualëve dhe patriotëve të Rilindjes Kombëtare. Në këtë shkollë ishin prezant edhe vajzat e „Institutit ‘Nënë Mbretëreshë’” të Tiranës. Profesor Jonus Blakçori kishte sjellë një ekspositë klasën e VII dhe të VIII të nxënësive të Institutit, me gjithë kujdestaren Ella Dishnicën...“. Nxënësë e klasës së tetë në këtë shkollë ishite edhe Nafije Mema e cila ishte poete, ”ajo do të binte në sy të poetit në mes shoqeve jo vetëm për nga bukuria fizike, por edhe përsjelljen fisnikë, urtësinë, veshjen e saj elegante, aq sa shume shoqe të saj do të thonë se „Ajo është speciale”, që më vonë do të bëhet grua e ardhshme e poetit më në zë të kohës, Lasgush Poradeci...”, metaforë e jetës bashkëshortore. Ku është simbolika e këtij ditarit?

Simbolika e këtij ditari është se ka të bëjë me dashurinë e poetit. Kjo dashuri nuk është e rëndomtë, është metaforë, sepse ashtu kanë vendosur të dashuruarit, „është fjalë e dhënë shqiptare. Fjala e dhënë shqiptare quhet besë shqiptare...Kjo? E Shqipes!

Jo?? E Shpirtit t'rim!! Ty të merr nér kraha dhe të puth me zjarr Lasgushi yt,” pastaj letërkëmbimet e të dashuruarve do të mbeten si shembull letash të dashurisë.

Lasgush Poradeci ishte në moshën 38-vjeçare, kurse Nafije Mema ishte në prag të mbarimit të klasës së VIII; Lasgush Poradeci kishte lindur më 1899, kurse Nafije Mema më 1920.

Rëndësia tjeterë është se Lasgush Poradeci ishte ortodoksi, kurse Nafije Mema myslimanë, si tolerancë fetare. Por, mos të harrojmë se kjo martesë ndodhi kur kishte inate dhe ndarje fetare të mëdha në kohën e para Luftës së Dytë Botërore. Sikur të kishte ndodhur gjatë kohës së sistemit monistik nuk do ishte interesante kjo martesë.

Simbolika apo metafora tjeterë është se bashkoheshin dy dialektet kryesore të gjuhës shqipe tokësë- Lasgushi dhe gegë-Nafija, që do të thotë bashkimin e shqiptarëve në një shtet dhe dashurinë ndaj kombit. Kjo argumentohet me rikthimin e Nafijes në Shqipë. Çkuptojmë me këtë metaforë të rikthimit të Nafijes në Shqipë? Kuptojmë se dashuria nuk është para së gjithash qëndrimit ndaj një personi konkret, por është një drejtim i Lasgushit që përcaktion marrëdhëniet me popullin e vet në tërësi dhe jo vetëm ndaj Nafijes-Shqipes. Ai nuk do të dashurojë rëndomë si të tjerët dhe nuk do të bëhet indiferent ndaj popullit dhe Shqipërisë së vet. Po se që dashurojë vërtet një njeri, atëherë patjetër duhet t' i duam të gjithë njerëzit, ta duam gjithë botën dhe jetën. Poeti thotë: „...Ky është emri yt i vërtetë tashi i paskëtaj, do ta mbash me rrall dhe me durim, është simboli i pavdekur i atdhedashurisë s' onë, bashkimi me një i shpirtrave t'ona kështu të përveluara... Pra, Lasgush Poradeci në personin e Nafijes-Shqipes i donte të gjithë, popullin e vet, e donte atë dhe veten. Poeti nuk ishte vetëm fenomen artistik, por fenomen familial dhe shqoëror.

Simbolika tjeterë është se Lasgushi përdor shumë shprehje poetike në ditarët dhe letrat e tij. Gjuha e tij është shumë e pastër, përdor një fjalor të zjarrtë të dashurisë, me muzikalitet dhe ngjyrime poetike siç thotë edhe profesori shkencëtar, poeti, kritiku, eseisti dhe historiani i pikaturit i letërsisë shqipe Agim Vinca në librin („Po” etika e fjalës” se Lasgushi është poet edhe në letrat e tij...”. Po ashtu vlen të përmendim edhe letrat e Nafijes në të folmen e gegërishtes, letra të cilat na çojnë të mendojmë se cilë shkruan dhe shprehët më bukur: Lasgushi me atë muzikalitetin, èrbëlsinë dhe shpratin e toskërishtes, apo Nafija- Shqipja me atë energjinë apo fuqinë shprehëse të gegërishtes. Më poshtë po japojmë plota dy letra, njëren të Lasgush Poradecit dërguar Nafije Memës, tjetra të Nafije Memës dërguar Lasgush Poradecit, për të argumentuar atë që thamë më lartë.

Zonjës Shqipe Lasgush Poradeci, Durrës-Tiranë, më 16 Nëntor 1939, ora 10.5 natën Shqipja irne e dashur,

Jam i lumtur që po të shkruaj letrën e parë me emrin Shqipe, të déshëruar prej meje dhe të pranuar me aq gjëzim dhe kryelartësi prej teje vetë. Më je lutur kaq herë të të shkruaj me këtë emër, nuk të shkrojtë gjer më sot sepse nuk e dinja mirë në e pranon nga gjithë fuqia e shpirtit t'ënd. Lutjet e tua të përsëritura më dhanë arsyë të ta përbush dëshirën më në fund sot. Ky është emri yt i vërtetë tashi e paskëtaj, do t'a mbush me rrall dhe me durim është simboli i pavdekur i atdhedashurisë s' onë,

bashkim më një i shpirtrave t' onë kështu të përveluara.

Shqip! T` a dish sa gjëzim, sa ngushëllim më fal ky emri yt i ri! Si më ra mua ndërmend? Pse e prite ti me aq dashuri? Desha të çmoll një mallin t' im t' brëndëshëm, t'a kem Shqipërinë gjithnjë t' gjallë dhe t' bukur dhe si nuse e re që është, t'a kem përparrë syve të gjallë në veten t' ënde, prandaj më ra nërmënt ashtu. Ti e prite se mendove si mua, je gjith vëtëm Shqipëri, trup i pastër prej vashe shqiptare dhe shpirt fisnik shqiptar, je kështu drita jonë e t' dyve në dashurinë e t' shentit Atdhe.

Mba-e tashi këtë kurorë me mburjen t'ënde të dashur, është thermeli i bashkimit tonë kombëtarë, kulmi më i lartë i dhembjes dhe i gazit dhe i èndrës s' onë së përzemërt atdhesore. Kështu t' bësh, kështu t' bësh t' Shqipja irne e dashur. Nuk t' a them unë, ç' t' a them unë atë që ti e di vëtë. Unë kam bindje të madhe në idenë t'ënde shqiptare, bëhem gjithnjë më i bindur se ti do të bësh t'ëndë shqiptare. Për t' kulluar dhe përtë fisnikëruar sa vjen më shumë, me punë, me vepra, me prova të gjallë. Jo me fjalë, shqiptarësinë t'ënde edhe me kaq gjera më sot mjaft të dashur përmua.

Kështu t' Shqipja imë e èmbël? E kupton ti pse tashi heshtja unë gjithnjë kur më pyetnjë, dhe më kujtonjë dhe më lutesh dhe më qaheshe përmirësim t'ënd t'ë ri? Që pse s' t'ë kam shkruar, pse s' t'ë shkruaj, pse s' t'ë dërgoj një letër me emrin Shqipë? Kur më telefonove prej Durrësi dhe më të „Shqipja”, dhe kur më the se të ardhur turp kur vajte në postë dhe pyete në ke letër me emrin „Shqipë” dhe postjeri t'ënd t'ë tha se jo, mua më ardhë keq për ty, po më ardhë dhe shumë mirë. Më ardhë keq dhe mirë, prandaj vendosa më në fund t'ë shkruaj ashtu. Dhi ti e di, vendimi im nuk kthehet. Vendimi im, është fjalë e dhënë shqiptare. Fjala e dhënë shqiptare quhet besë shqiptare.

...Kjo? E Shqipes! Jo?? E Shpirtit t' im!!  
Ty t'ë merr nér kraha dhe t' puth me zjarr Lasgushi yt!

Durrës, 18.XI.1939

Shumë dashur Lasgush.

Rrijë në shtëpi si e mpitë...Shtëpija që më parë ish përmira vëndi më i dashur, tashi s'më duket ashtu. Shkakun dij t'a gjej vëtë. Ishin njerëzit e kësaj shtëpije ma t'ë dashur që ma banin shtëpinë t'ë dashur, po tashti me qenë që njeriu ma i dashur i jetës s'ime asht larg, më ngjan kjo.

Lasgush, shpirti em! Sa më gjëzove me kartolinën. Me ndërrimin e emrit në „Shqipë” më duket se kam le dhe nji herë. Ndjehem më e lartë, më fisnikë. Më duket se tashti do më duash më fort se më parë. Një ndjenjë e mbërëndëshme më siguron se Shqipja asht pëllumbeshe e shpirtit t'ënd t'ë lartë, që t'ë dhuron atë që ti e kërkoi vite me rradhë: Zemrën e pastër të një femme kush-tuar ty dhe artit t'ënd. E frymëzuar prej dashurisë t'ënde filloj ta ndryshoj jetën t'ime të zakonshme. Jam tuj u përmirsu e tuj u ngrit lart shpirtërisht përditësa me shum. Reth meje tashti që t'ë kam ty asht: Dritë. Kthjellësi e Shkëlqim! Ngadal jam tuj e njoftun mirë jetën. Sa e mirë dhe sa e keqë asht, e them me bindje se jam e fortë me përballue valët e sajë. Ç' prej martesës s' onë ftyna ime shpreh vëtëm Lumturi t'ë plotë. Ato ditë nuk fitova vëtëm një burrë, por edhe një mësonjës e edukues.

Shumë dashur e jotja Shqipe!

# MELANKOLIA E TRISHTË NJERËZORE

**Historia, poezia, u morën vetëm me shkëlqimin e maratonës, e askush nuk foli, as edhe për pak, për blozën mbi të cilën është ngritur ky shkëlqim; një masakër, lum gjaku dhe lotësh, humbje më tepër se fitore**



(Hamdi) Erjon MUÇA

Këtë cikël interpretimesh, vëzhgimesh e hapa me Montale-n; me bisturinë më të mprehtë të shekullit të XX. Ndërsa tanido të shkruaj për Salvatore Quasimodo-n, melankolikun e hermetikëve. Vetëm se melankolia e tij, nuk është e tij. Siç shkrante Migjeni ynë: Flamujt e një melankolie të trishtë.

Quasimodo shkruan për melankolinë e trishtë njerëzore. Një lloj John Keats, por më i pjekur, dhe mbi të gjitha i ardhur në botë në një shekull tjetër; shumë larg romantikës, ai nuk thotë: por sikur kjo të qe një endërr?! Por: Ky është një makth pa fund! Nuk bën hipoteza. Shpalos të vërteta.

Ashtu si nga Montale, edhe nga Quasimodo kam marrë një krijesë të vogël për ta interpretuar, e pikërisht tek këto vogëlsi sintetizohet madhështia e poetëve. Pak a shurmë si në natyrë: për të nxjerrë një grimcë diamanti, natyrës i duhet një copëz qymyri njëqindfish më e madhe, dhe pasi e shtyp deri në shterim, e djeg me temperaturat e larta, arrin ta kthejë në materialin më të fortë që ne njohim; metaforë rrëqethëse; një rëndomtësi e zezë e kthyer në një grimcë xixëlluese.

Vetëm se kjo është tepër e thjeshtë, dhe poetët, rëndomtë këtë bëjnë; kanë bërë dhe do të vijojnë ta bëjnë; ose më saktë-

sisht, mundohen. Ndërsa hermetikët, përsosën atë që nisën romantikët; kthimin mbaprash; morën një grimcë diamanti çfarëdo, nga apoteoza e diamanteve të historisë njerëzore për të na treguar qymyrin që ndryhej nën të.

Maratona, është një vend, por edhe një pikë historike. është një nga ata diamantë, që njeriu krioi dhe me të cilat vijon të ndërtojë bizhuteritë e veta; diamant efimer i qymyrit njerëzor.

Ankimi i mëmave në maratonë, - britma e zorrëve popullore - nuk u dëgjuat prej askujt.

Historia, poezia, u morën vetëm me shkëlqimin e maratonës, e askush nuk foli, as edhe për pak, për blozën mbi të cilën është ngritur ky shkëlqim; një masakër, lum gjaku dhe lotësh, humbje më tepër se fitore. Vetëm se askush nuk deshi t'i dëgjonte, t'i shikonte këto humbje, ankime, lot dhe gjak. Njeriu i duhet, i duhet, ngadhënjimi. Nuk i duhen fraza; mjerë unë për ty që shkove për të mos u kthyer, por lavdi dëshmorëve. Njeriu, ngre katedrale hyjnore, me baltë e gjak duke i mbushur mendjen vetes, falë poetëve, se këto janë billoqe graniti. Me tragjeditë e tyre, bymyer me megalomani, tragjikët, e humbën ndjesinë e tragjikes. A nuk thoshte Nietzsche pak a shumë kështu!

Greqia - ishte e lirë. është e lirë Greqia. Vargun e tretë, Quasimodo e mbylli me

një "Enjamberment". është një figurë retorike që poetët, përmë tepër hermetikët, e përdornin jo rrallë dhe që tek Quasimodo vërehet më qartë. Pra Greqia ishte e lirë. Mirëpo çfarë është në thelb Greqia, një nacion gjeografik apo një koncept filozofik?! Si nacion gjeografik asnjëherë nuk mund të fitet për liri totale. Ndërsa si koncept filozofik asnjëherë nuk mund të fitet për një mungesë lirie. Po Quasimodo e përforcon figurën retorike duke vijuar: "është e lirë Greqia". Pra, ky efimeritet njerëzor ishte dhe vijon të jetë i lirë, me edhe pa Maratonën, ose vion të jetë i pushtuar, me ose pa Maratonën. Duket sikur me këto vargje Quasimodo i bën jehonë asaj çaka shkrante Nietzsche: "Aty ku ju vështroni gjëra ideale, unë shoh- gjëra njerëzore, ah, tepër njerëzore." Në fakt, dukuria Nietzsche, pati një përplasje të fuqishme në mendësinë intelektuale, artistike, të shekullit të shkuar. Rrëzimi i idealeve do ta bëjë njeriun të çlirohet, pasi nuk është në rrezik pushtimi as nacioni gjeografik dhe as koncepti filozofik, por thelbji psikologjik njerëzor.

"Maratona është një vend ushtarësh - jo yshqesh, këtu nuk rritet tempulli - dhe as altari. Pirgu i sajë është i plotë, nga lart

shikohet Eubea. Krimbi i historisë gjithçka dokortësohet mbi tokë, këtu lapidari dhe në tokë përkrenare dhe shpatë;

ndonëse Maratona më shumë Maratonon,

burri i fushës së Argos jeton mes muresh si kolibe vendroje.

adhuronte qetësish, ato e veshin ushtar nén urdhrat e një komandanti çfarëdo. Bota nuk është një vend meditim, jetese, por përlleshje.

"Pirgu i sajë është i plotë, nga lart - shikohet Eubea. Krimbi i historisë gjithçka dokortësohet mbi tokë, - këtu lapidari dhe në tokë përkernare dhe shpatë;"

Vëreni me çfarë vizoni e nis vargun: Pirgu. Dheu i hedhur përsipër një varzeze masive, që ndonëse kanë kaluar mijëvjeçarë, akoma është i plotë a thua se trupat e mbuluar me të, të mos jenë dekompozuar, kthyer vetëm në kocka, por të sapombuluar. Maratona është një përvijimshëmri varrezash të përbashkëta, një mbulesë e lëvizshme masakrash, dhe nga mbi të bota vijon të duket po njëlljo. Krimbi i historisë: si larvat e trarëve që gjerryjnë e gjerryjnë, vijon të gjerryej kujtesën e manipular të njerëzve, vetëm se mbi tokë njerëzit përvijojnë të nënshtrohen, jo ndaj një armiku fizik, por ndaj koncepteve filozofike, ndaj kontrollit psikologjik; lapidarët na shfaqin ngadhënjimin, përtë na fshehur masakrën, vrasjen, vdekjen. Ky krimbi na gjerryen që ne të vijojmë me lapidarë të riq, përtë mbuluar vrasje të reja. Një gjenjeshtër të re, të ngashme me gjenjeshtën e vjetër, përtë mbuluar të vërtetët e vëtme, të pazbuluar kurrë.

"Ndonëse Maratona më shumë Maratonon, - burri i fushës së Argos jeton mes muresh si kolibe vendroje."

Ndonëse kanë kaluar shekuj e shekuj evoluimi, njeriu nuk ka ndryshuar aspak. Quasimodo në këtë varg përdor një lojë fjalësh. Shqip mua mu desh që emrin Maratonë, ta kthej në foljen maratonon, ndërsa në italisht nuk është e nevojshme, ngaqë në të njëjtën formë, është edhe emër edhe folje.

Pra megjithë këtë glorifikim, tragjizëm, mitizim, të efimeres, ideales, njeriu po i njëjtë mbetet. Po ajo kafsha ca frikacake e ca agresive thaujse e evoluar. Hermetikët, ishin shpura e dishepujve të Zarathustrës të Nietzsche-s. Në të gjithë krijimtarinë e tyre duket sikur lexohet maksima e tij: "Nuk do të ngre idhuj të ri; të vjetrit mund të nisin dhe të mësojnë çfarë ndodh t'i kesh këmbët prej argjile. Të përbysësh idhujt (termi im për "idelet") - është kjo, përmë tepër, që i bashkëngjitet zejes time. Realiteti është zhveshur nga vlera e vet, nga ndjesia e vet, nga vërtetësia e vet, në atë masë sa është krijuar një botë ideale. "Bota reale" dhe "bota e dukshme". Mashtrimi i idealit ka qenë deri më tanë mallkimi i lëshuar kundrejt realitetit, njerëzimi vetë është bërë, nëpërmjet sajë, gjenieshtar dhe i këllpët, thellë në instinktet e veta më të fshehta - deri në kultin e vlerave të kapërthyer kundrejt atyre nëpërmjet të cilave do të mund t'i garantohej rritja, e ardhmja, e drejta solemne e ardhmërisë.

## MARATONA

Ankimi i mëmave në maratonë, britma e zorrëve popullore nuk u dëgjuat prej askujt. Greqia ishte e lirë. Është e lirë Greqia.

Maratona është një vend ushtarësh jo yshqesh, këtu nuk rritet tempulli dhe as altari. Pirgu i sajë është i plotë, nga lart

shikohet Eubea. Krimbi i historisë gjithçka dokortësohet mbi tokë, këtu lapidari dhe në tokë përkrenare dhe shpatë;

ndonëse Maratona më shumë Maratonon,

# BETEJA E IDEVE NË LIBËR

Dashuria është shumë, shumë e rëndësishme. Shpesh kam folur dhe kam shkruar se ekzistojnë dy gjëra që vënë në lëvizje njerëzit, të cilave ata nuk mund t'u kundërvihen e që janë forcat kryesore lëvizëse: dashuria dhe politika



Nadin GORDIMER

Unë mendoj se të gjithë artistët e krijojnë botën, sepse ekziston realiteti dhe zhvendosja. Është më se e saktë se të gjithë artistët krijojnë plotësisht botën e re. Unë jam krijuese e fjalëve dhe jam plot me fjalë. Kjo është mënyra ime e të kuptuarit. Këtë gjë e kam arritur, sepse kjo ështëjeta. Në shoqërinë që jetoj, jam plotësisht e angazhuar, prandaj mund t'ë përzjegj këto dy gjëra: idetë e mia, përshtypjet, atë që mendojnë njerëzit dhe që unë shoh midis tyre. Këtu nuk bëhet fjalë përgjithshëm, çështja është tek e vërteta dhe ajo, në fakt, përmban edhe moralin. Në librin tim gjendet ajo që unë kam përfjetuar dhe në ç'përfundim kam arritur duke parë të tjerë. Nuk është njëlljo si në veprat e mia të trilluarit nga fantazia, sepse këtu hyn në fuqi procesi që vjen pas ngjarjeve. Disa muaj ose disa vjet duhet vrarë mendja përtë gjetur edhe kokrrizën më të vogël të së vërtetës, e cila është pjesë përbërëse e asoj ngjarjeje, që nuk paraqet rëndësi vetëm nga jashtë. Pra, kjo gjë duhet të implementohet në vepër, në mënyrë që të zbulohet karakteri i vërtetë i parashtrimit të idesë. Kështu përfshihesh në angazhim, kurse vetë përdorimi i fjalëve është një mënyrë angazhimi.

\*\*\*

Jam e mendimit se dyshimi është një nga shfaqjet esenciale, prej të cilit ne hetojmë gjërat që të gjemjë pakëz të vërtete. Bota është shumë e ndërlikutur: duhen mësuar gratë, njerëzit, fëmijët; duhet studiuar ajo që kanë thënë, madje, edhe kuptimi i lëvizjeve dhe i gjesteve të tyre. Ai më nxit për hulumtime, sepse për shkak të angazhimit, është e rrezikshme të jesh shumë i sigurt dhe të mendosh se e vërteta është plotësisht në anën tonë. Gjithmonë duhet pasur dyshim nga pak, duhen bërë pyetje, madje, edhe të kundërtta me ato që përfjetojmë. Kjo është një

mister, sepse unë kam parë shumë njerëz të guximshëm. Për mua është një enigmë, sepse disa njerëz nga koha në kohë janë tepër kurajoz në jetën politike, por që nuk janë të tillë edhe në raportet vetjake. Kjo ndodh sepse geniet njerëzore janë plot mangësi, kurse shenjtoret nuk ekzistojnë. Dashuria është shumë, shumë e rëndësishme. Shpesh kam folur dhe kam shkruar se ekzistojnë dy gjëra që vënë në lëvizje njerëzit, të cilave ata nuk mund t'u kundërvihen e që janë forcat kryesore lëvizëse: dashuria dhe politika. Këto janë dy forca të fuqishme. Dashuria gjithmonë është e rëndësishme, ajo është një dukuri joshëse, misterioze. Kur njeriu kalon moshën, mund të shfaqet një aspekt tjeter i dashurisë që nuk është as tërësisht miqësi, por as tamam dashuri. Kjo është diçka e ndërmjetme. Një miqësi e tillë mund të ekzistojë midis burrit dhe gruas, por që nuk është seksuale, sepse jeta seksuale përtë dy vazhdon në jetën private, kurse miqësia e tyre është diçka e veçantë. Jam e bindur se midis genieve njerëzore kemi një fytyrë tjetër të dashurisë, të cilën në ende nuk e kemi zbuluar dhe kjo temë më tërheq shumë. Kjo është edhe tema e librit tim të ri... Në çfarëdolloj mos nje burri dhe një grua mund të dashurohen, por kjo dashuri mund të mos mbështetet në marrëdhënien seksuale. Miqët janë shumë të rëndësishëm përmes nuk janë të lidhur shumë me familjen. Kjo do të thotë se, krasa fëmijëve të më dhe burrit, famili ja ime përbëhet edhe nga miq, të cilët i dua shumë. Ne kemi të njëjtat ide politike. Bashkërisht kemi luftuar dhe kjo ka shumë rëndësi, sepse këto janë lidhje solide. Nuk mund të mbash miqësi me dikë që është racist, sepse është jashtë arsys. Kam konstatuar se në një familje vëllezërit dhe motrat janë bërë armiq midis tyre për shkak të politikës. Kjo ndodh gjithandej. Nuk mund të durohet një racist, nëse ju nuk jeni i tillë, gjë që është e kuptueshme.

\*\*\*

Më vështirë e kam ndier veten në periu-dhën e rinisë, sepse, kur jemi të rinj dhe na ndodh diçka, na duket si fundi i botës. Prandaj nuk flemë dot, vrasim mendjen, por koha kalon, ne sikur fitojmë pakëz kurajë e qartësi dhe e kuptojmë se nuk është fundi i botës. Midis moshës njëzetë-pesëvjeçare dhe tridhjetëvjeçare e kam ndier trmerrin: atëherë kërkjmë dikë, fillojnë vuajtjet e dashurisë dhe pikërisht në atë kohë jam divorcuar e më është dashur që fill e vetme të rriss fëmijët. Por, pas gjithë këtyre peripecive, m'u duk vetja më e fortë. Pikërisht në atë kohë u bëra shkrimtare. Çdo gjë mund të ndodhë me ne në jetë, madje, edhe që të flakemi si një lodër fëmijësh që era e hedh tutje, por përmua profesioni i shkrimtares ka qenë gjithmonë parësor. Kur të mos jem në gjendje të shkruaj, atëherë mendoj se ky do të jetë fundi im. Kështu është nëse flet me singeritet. Pa dyshim, ai nuk është i vetmi, mund t'ju numëroj të paktën edhe pesë të tjerë, që kanë po ato cilësi. Natyrish, ata janë më të rinj dhe do ta vazhdojnë atë që ai ka filluar, sepse e kuptojnë mirë realitetin politik të vendit. Mendoj se shkrimtarët nuk ndikojnë shumë në politikë, unë vetë kam marrë pjesë në luftën për çlirim, kam bërë sa kam mundur dhe tashmë jam shumë e lumtur që vendi im është çliruar. Lufta ka zgjatur plot pesëdhjetë vjet, madje edhe në kohën që Mandela ishte në burg, por gjithçka mori vrell tri vitet e fundit, pas lirimit të tij. Probleme e vështirësia, kësaj se ato janë trashëguar nga aparteidi, tërë marrëzitë e tij janë trashëguar, sidomos në arsim dhe në punësim. Por duhet reaguar dhe duhet vazhduar me reforma, sepse në botë nuk ka vend të përsosur. Unë mendoj se e kemi filluar mirë, tashmë ka kaluar vetëm një vit që jemi të bashkuar si komb. Besoj se vështirësitë do të zgjasin edhe katër vjet, sepse duhen të paktën pesë vjet që të shihet progresi i vërtetë.

kujtojmë Gjermaninë, sepse edhe sot plagët e asaj lufte dhembin. Në Afrikën e Jugut aparteidi është i rrënjosur thellë në mentalitetin e njerëzve dhe, derisa ai të zgjasë, shkrimtarët do të janë të nevojshëm që ta shporrin nga nënvetëdija e njerëzve.

\*\*\*

E vërteta është se "problemët" në vendin tim nuk kanë vënë në lëvizje penën time, por hulumtimi dhe zbulimi i tyre nëpërmjet të shkruarit kanë bërë që të çahet korja sipërfaqësore e jetës afrikano-jugore dhe që unë të depërtoj në të, në saje të kësaj veprimtarie. Pra, të shkruarit ka qenë angazhimi im i parë. Këtë gjë pushtetmbajtësit, pa dyshim të bardhë, e kanë ndier menjëherë që në romanin tim të parë. Romani "Bota e të huajve", që doli në vitin 1958, u ndalua menjëherë. Këto vite të tmerrshme kanë zbruzur plumbë mbi zezakët, të cilët janë përpjekur ta kundërshtojnë diskriminimin dhe, përkëtë arsy, janë burgosur liderët e ANC-së (African National Congress). Që nga ajo kohë e në vazhdim, mua m'i kanë ndaluar edhe librat e tjerë dhe m'i kanë censuruar rregullisht. Unë jam angazhuar në këtë lëvizje edhe si qytetare. Që herët jam përfshirë në ANC dhe kam luftuar që t'i jetep fund së kaluarës së tmerrshme ndaj zezakëve, sepse kjo bart në vetyvet peshën e mëkatit të të parëve tanë, të cilët prej shumë kohësh u kanë diktuar zezakëve se çduhet të bëjnë. Nuk kam qenë nga ato liberalët, që kërkonin të përmirësohen vetëm disa gjëra, por kam dashur që gjithçka të ndryshojë. Në libër janë futur si në një betejë, sepse gjithmonë aty zhvillohen betejë e ideve. Por, ndërkohë, kam dashur që ato të kenë ngrëhtësi dhe intimitet, ashtu si në dashuri. I tërë ky sistem ka stimuluar deri-diku shkrimtarët, por me tendencë përtu Marrë frymën deri në atë shkallë, sa vetëm nëpërkëmbja t'u dilte para syve. Por, pavarësisht nga censura dhe ndalimi i librave të mi, nuk zgjodha ekzilin. Sarri është shprehur: "Ekzil do të thotë të humbasësh vendin tënd në botë."

Çlirim na solli gjëzim të papërshkruar. Patjetër që probleme ka, por ekziston edhe vullneti përtu zgjidhur ato dhe unë jam shumë e kënaqur nga kjo. Përsa i takon Mandelës, kam pasur privilegji që ta shoqeroj në Oslo, kur ka marrë çmimin Nobel... Përmua ai është frymëzim: është njeri i jashtëzakonshëm, i vetmi i tillë dhe, sipas mendimit tim, nuk ka vend tjetër në botë që të ketë një të dytë si ai. Është kaq i mençur, kaq trim, me një fjalë, njeri i jashtëzakonshëm. Këtë ua them me singeritet. Pa dyshim, ai nuk është i vetmi, mund t'ju numëroj të paktën edhe pesë të tjerë, që kanë po ato cilësi. Natyrish, ata janë më të rinj dhe do ta vazhdojnë atë që ai ka filluar, sepse e kuptojnë mirë realitetin politik të vendit. Mendoj se shkrimtarët nuk ndikojnë shumë në politikë, unë vetë kam marrë pjesë në luftën për çlirim, kam bërë sa kam mundur dhe tashmë jam shumë e lumtur që vendi im është çliruar. Lufta ka zgjatur plot pesëdhjetë vjet, madje edhe në kohën që Mandela ishte në burg, por gjithçka mori vrell tri vitet e fundit, pas lirimit të tij. Probleme e vështirësia, kësaj se ato janë trashëguar nga aparteidi, tërë marrëzitë e tij janë trashëguar, sidomos në arsim dhe në punësim. Por duhet reaguar dhe duhet vazhduar me reforma, sepse në botë nuk ka vend të përsosur. Unë mendoj se e kemi filluar mirë, tashmë ka kaluar vetëm një vit që jemi të bashkuar si komb. Besoj se vështirësitë do të zgjasin edhe katër vjet, sepse duhen të paktën pesë vjet që të shihet progresi i vërtetë.

# REGJISORI SERB NË TEATRIN “KOSOVA” TË TIRANËS

Në fund të shkurtit të vitit 1945, përderisa njësitë ushtarake shqiptare-jugosllave po bënë masakra mbi popullatën shqiptare në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi, Sanxhak e në Luginën e Preshevës, në Tiranë do të arrijet regjisori serb, Bozha Nikoliq, me qëllim që ta realizojë shfaqjen e parë profesionale teatrale në Shqipërinë komuniste

**Shkëlzen HALIMI**

Idila shqiptaro -jugosllave në prag të përfundimit të Luftë së Dytë Botërore dukshëm u reflekto edhe në bashkëpunimin kulturor. Autoritet e atëherësme komunistet të shtetit shqiptar, duke i respektuar në përpikëri parimet staliniste, kishin vendosur që edhe ndërtimi i kulturës të fillojë nga pika zero, pra të krijojet kultura komuniste, e cila në fakt bëri prerjen më të vrasdhë të kontinuitetit të kulturës shqiptare që kishte zënë fill sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare, për të pasur një zhvillim të hovshëm në periudhën e Mbretit Zog, kur doli në pah një plejadë e intelektualëve me formim të shëndoshë kombëtar, e cila plejadë kishte një vizion të qartë për zhvillimin e gjithanshëm të shtetit shqiptar, përfshiri edhe zhvillimin kulturor që në vitet 30-ta kishte filluar të lulëzojë përmes botimeve të shumta. Përveç këtë plejadë dhe këtë veprimitari të tyre, komunistët shqiptarë do ta emërojnë si kulturë borgjeze e dekadente.

Në fund të shkurtit të vitit 1945, përderisa njësitë ushtarake shqiptare-jugosllave po bënë masakra mbi popullatën shqiptare në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi, Sanxhak e në Luginën e Preshevës, krejt kjo në frymën e bashkim-vëllazërimit dhe eliminimit të atyre që ishin anti-komunistë, me kërkesë të palës shqiptare, ministri i atëherësme i Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe shef i Agjitetit, Milovan Gjillas, në Tiranë do ta dërgojë regjisitorin Bozha Nikoliq, me qëllim që ta realizojë shfaqjen e parë profesionale teatrale në Shqipërinë komuniste, por edhe të ndihmojë në themelimin e Teatrit popullor shqiptar.

Që ironia të jetë edhe më e madhe, politikës së atëherësme komuniste shqiptare, fare nuk i pengoi që Bozha Nikoliq ishte një individ i shkolluar në periudhën e Mbretërisë jugosllave, kohë kjo në të cilën edhe kishte vepruar e punuar, por i cili nga palo serbe nuk ishte cilësuar si përfaqësues i kulturës borgjeze.

Në një deklaratë për gazetën “Bashkim” (25 mars, 1945), me rastin e fillimit të organizimit të Teatrit shqiptar, Nikoliq do të theksoj se “kam ardhur nga Jugoslavia mike që të ndihmoj në realizimin e idesë së udhëheqjes suaj për themelimin e teatrit popullor. Do të bëj përpjekje që t'u ndihmoj me përvojën që kemi pasur, sepse ne që moti i kemi kaluar vështirësitet nëpër të cilat po kaloni tanij. Si kryetar shumëveçar i Shoqatës së aktorëve, kam pasur rastin që të angazhohem në themelimin e shumë teatrove tonë... Udhëheqja juaj e ka kuptuar rëndësinë edukative-kulturore të teatrit dhe e di se zhvillimi i vendit është i lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e teatrit”.


Edhe përkundër problemeve të shumta në procesin e sigurimit të kuadrit të nevojsnshëm, megjithatë, më 4 qershor (1945) fillojnë provat e para për realizimin e shfaqjes DASHNORI (GJIDO), prova të cilat, siç do të tregojë Nikoliq në një raport (25 gusht, 1945) dërguar Ministritës së shqiptare të Kulturës dhe Propagandës, do të zhvillohen me shumë probleme të natyrave të ndryshme. “Organizimi i teatrit mori shumë kohë. Shumë anëtarë të këtij projekti ishin nga vende tjera të Shqipërisë, prandaj humbëm një kohë derisa u tubuan të gjithë. Punët shkonin



zvarrë, kurse unë e kisha bindur veten që të jem i durueshëm. Por, më në fund, më 4 qershor, filloi puna me aktorët”.


Në këtë shfaqje u angazhuan Mihail Popi, Ndoci Deda, Ndoci Meshkalla, Andon Panaj, Ndrekë Shkjezi, Hysni Pelinku, Gjon Karma, Lazar Popa, Matish Shiroka, Mihail Stefa, Besim Levonja, Mustafa Budini, Hasan Reçi, Nikolla Panajoti, Belul Hatibi, Olga Shuraja, Martha Burda, Rica Dino, Efti Marku, Liza Vorfi, Behiqi Çela, Andrea Malo, Prokop Mima, Naim Frashëri, Lazar Filipi, Nesti Spiro, Kostaq Taja, Konstandina Marango, Donika Burda, Ana Kçira, Xhevhat Serezi, Qamil Grezda, Kolë Shala dhe Kadri Roshi.

Premiera e shfaqjes u dha më 26 shtator, 1945, në Teatrin që atëherë mbante emrin KOSOVA, e që më vonë do të quhet Teatri populor dhe në fund Teatri Komëtar. Është po ai objekt që u rrënuat nga Qeveria socialiste, objekt ky i ndërtuar në vitin 1939 me porosi të Mbretërisë Shqiptare. Pavarësisht se në historinë e re të Teatrit shqiptar ky fakt (i bërijës së teatrit komunist) është heshtur ose është përmendur vetëm titulli i shfaqjes, dokumentet rreth angazhimit të regjisitorit serb dhe realizimit të projektit të parë teatral që ruhen (në Arkivin e Beogradit) nën sinjaturën ACKSKJ, IX, 1/III – 36 dhe mbajnë datën 25. III – 15. X. 1945, tregojnë se kësaj shfaqjeje, nga pushiteti i atëherësme popullore shqiptar, iu kushtua një vëmendje e veçantë. Kështu, siç njofton gazeta “Bashkim” (29 shtator, 1945), me rastin e largimit të Bozha Nikoliqit nga Shqipëria, Xhemal Broja, atëherë kryeshef për kulturë, do të thotë se “Zoti Bozha Nikoliq fare nuk e kurseu veten që t'i japë hov teatrit në vendin tonë. Më përvojën e tij të madhe, ai u dha shumë aktorëve tanë, të cilët tanë e qajnë largimin e tij”.



# KUJTESEË PËR SHKRIMTARIN ARIFI GJYLI

Si krijues, në fakt, i takon brezit të shkrimtarëve që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj



Xhahid BUSHATI

1.

Arif Gjyli është lindur në qytetin e Shkodrës në prill të vitit 1913 dhe ka vdekur më 23 shtator 1989 në Tiranë. Në qytetin e lindjes, në korrik të vitit 1933, përfundoi Shkollën Normale përmësues. Para çirimit ka punuar si mësues në Durrës dhe në Mamurras. Ka marrë pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke qenë në poste drejtuese të saj. Ka qenë delegat i Shkodrës në Kongresin e Përmetit, i mbajtur më 24.05.1944. Me çirimin e vendit ka punuar me detyra të ndryshme, si: sekretar politik i Qarkut të Shkodrës nga nëntori 1944, sekretar i ambasadës së Shqipërisë në Beograd në vitin 1945, etj. Është zgjedhur deputet i Shkodrës në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1945, duke qenë edhe sekretar i Kuvendit Popullor. Është arrestuar në shtator të vitit 1947 dhe është dënuar me 20 vjet burg si pjesëtar i grupit të deputetëve. Pas lirimit nga burgu ka punuar në detyra të ndryshme në administratën shtetërore. Vitet më të shumta punoi si mësues i Gjuhës shqipe dhe letërsisë, derisa doli në pension. Nga viti 1962 ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Në fund të viteve 50-të dhe në fillim të viteve 60-të të shekullit XX, ka shkruar dhe botuar këto vepra: - "Historia e dhelpnës plakë", Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1958; - "Trimat e Jutbinës", Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1959; ribotuar nga Sh. B. Rilindja, Prishtinë, 1973; nga Sh. B. "Ngjyrat e kohës", Tiranë, 2012; - "Djathtas-majtas 1, 2, 3", Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1960. Ka shkruar dhe botuar në periorë dikë të ndryshëm të kohës disa studime të ndryshme përmigjenin, Zenel Bastarin etj.

Veprimitaria letrale e tij kryesore është letërsia përmësuese. Në vitet 1959-1963 ka punuar si mësues në shkollën 8-vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, me një grup nxënësish të ardhur nga qytete e shtëpi të ndryshme të fëmijëve të vendit, përmëtë cilët hartoii një program të veçantë mësimor nga klasa e parë deri në të katërtën. Ky program, por dë përkushtimi i tij, bëri të mundur rehabilitimin në shoqëri dhe përfundimin e shkollës filllore të rreth 50

nxënësve, të cilët do të kishin përfunduar në spitalin psikiatrik të Elbasanit, pasi ata kishin probleme psikike. Më pas, Arif Gjyli iu hoq e drejtë e botimit, kështu që tregimet të titulluara: "Professor Tomi" (tregime të fëmijërisë), Botimet "Redona Publishing", Tiranë, 2014; janë pjesë e arkivit të tij të pabotuar më parë, të cilat u gjetën së fundmi nga familjarët. Libri "Profesor Tomi" (tregime të fëmijërisë së autorit) janë përfshirë katër tregime: "Njerëzit me tasa prej hekuri", "Shkolla e Mulls Salasit", "Shkolla" dhe "Profesor Tomi". Kuvendi i Shqipërisë, në kuadrin e festimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë, nderoi 29 figura të shquara, që kanë dhënë një ndihmesë shumë të çmuar në historinë tonë kombëtare; e një ndër to ishte dhe i nderuar Arif Gjyli.

2.

Shkrimtari Arif Gjyli vdiq në një ditë vjeshte të vitit 1989, në moshën 76 vjeçare, në Tiranë. Emri dhe veprimitaria e tij e luftës dhe ajo letrare u kujtuan vetëm nëpërmjet një shkrimit. Më vonë, koha vërtetoi se ky shkrim-kujtimi ishte i fundit, por jo përmendja e emrit, e kontributit të tij si mësues e didakt (nga të parët që, pas një pune të gjatë e të durueshme, u mor gjerësish e me hollësi me problemin e mprehtë të teksteve të leximit dhe të letërsisë përmësuese, si mësues e studiues (ka meritën përvënien në pah përmëtë parën herë të figurës së poetit popullor tiranas, Zenel Bastari dhe të një vlerësimi poetik-analistik të jetës dhe problematikës së veprës të Migjenit).

Si krijues, Arif Gjyli la gjurmën e tij në fushën e letraleve përmësuese të rinj. Konfiguracioni i kësaj gjurmje ka dëmbart në thelbën e saj, modelin e një krijues që përvetësoi disa tipare, si: idealin, përkushtimin dhe natyrën që e kishin rilindësit tanë të shquar e të ditur që, mesë duket, ia mëkuani me dashuri edhe intelektualit Arif Gjyli. Duke përqafuar këtë model, ndoqi atë rrugë të ndritur; u mor dhe dha një ndihmesë në fushën e letërsisë shqipe përmësuese të rinj e më gjérë (pedagogji, psikologji, mësuesi), kuptohet në një kontekst të ri historik, i cili shpërfaqte dita-ditës dukuri të reja në jetën shoqërore e kulturore.

Arif Gjylin nuk e kam takuar qoftë edhe një herë në jetë, ndonëse emri i tij ishte i "shëtitur" në Shkodër. Pra, nuk pata rast ta njoh personalistët dhe të bisedoj me të, ndonëse kam pasur shumë dëshirë... Së paku t'i bëja në mënyrë poetike një portret sa njerëzor aq dë artistik. Pas shumë vitesh, i gjeta si reliktë të çmueshme, disa grimca të portretit të tij në librin "Muhamet Uruçi, babai im". Në pjesën e titulluar: "Në vend të hyrjes" të këtij libri memuaristik, citoj: "Ka një memorie të jashtëzakonshme..., ... ka mbetur si gjithmonë i ndershëm." Gjithashtu citoj: "Më shikoi drejt përsëdrejti dhe unë për herë të parë dallova nën xhamat e tejdukshëm një palë sy plot drithë"; ... "Pas kaq vitesh mund të them se takimi me Arif Gjylin më ka lënë një shije shumë të ëmbël, jo vetëm për kulturën e gjithanshme që rrezatonte, por edhe për saktësinë me të cilën ai kujtonte dhe njihet gjithçka me detaje nga ato vite të vështira."

Edhe pse kanë kaluar disa dekada nga çirimi i Shqipërisë, Arif Gjyli nuk është i shkëputur nga kujtimet e luftës, që përmëtë t'ë thelb, ato, duhet të ishin realizueset e ndërrave të tij të vërteta. Sepse përmëtë ato ndërra, ai la peng jetën. Siç duket përmëtë Arif Gjylin, ata mbeten vetëm ndërra... Dhe si të tilla ata merrnin 'jetë' vetëm kur ai i kujtonte (herë pas here) nëpërmjet bisedës së tij të heshtur me plagët e luftës dhe përmendjes së emrave të shokëve të vërtetë... Ishte një bisedë e dhembshur dhe tragjike. Kujtonte edhe momente si këto: "Më mbanin të lidhur me tela, më kanë mbajtur pa gjumë, më kanë mbajtur përmëtë kohë të gjatë në çimento... Natën më linin pa gjumë dhe gjithë ditën i binin një gramafoni të madh shurdhues sa të mos mundja që të fle asnjë minutë. ... Më morën e më shoqëruan në një pyll aty pranë. Në këtë kohë unë fillova të dyshoja dhe fillova të bërtas... Më bënnë një gropë në formë varri dhe më kërcënuan se do të më vrisnin si buharinist. Pastaj më sollën me automobil këtë tek Tirana e re. Më vonë e pashë se më kishin çuar në një shtëpi në rrugën e Elbasanit. Në këtë shtëpi më mbajtën 43 ditë mes torturave çnjerëzore".

Marrëdhënia e krijuesit Arif Gjyli me letërsinë shqipe përmësuese të rinj janë

objekt i këtij shkrimi. Përmes këtyre rreshtave, artikullshkruesi përpinqet të krijojë një drejtësim-shikim ndryshe, një optikë rivlerësimi veçanërisht në dialog me kohën e pas kohën që jetoi e krijoj ky shkrimtar. Librat e botuar, duke parë vitet përkatëse të botimit, nuk përkojnë me fillimet e vërteta të ndihmesës së Arif Gjyli në fushën e letërsisë shqipe përmësuese të rinj. Pra, vitet e ndajnë dhe e largojnë nga fillimet dhe të vërtetat letrale. Arsyet... sikur mbeten të pakuptueshme, nganjëherë absurdë.

Si krijues, në fakt, i takon brezit të shkrimtarëve që krijuan traditën e re të letërsisë shqipe përmësuese të rinj. Si krijues vetëm emri i përmendët. Në të rrallë edhe disa rreshta. Kur në të vërtetë ai dë brezi i tij: "... zgjeruan shumë diapazonin tematik, që thelluan fondin realist dhe që e ngritet në një nivel më të lartë cilësinë ideoartistike...". Më tej, po përmëtë shkrimtar thuhet: ... "Në këtë kuadër, gjithashtu, duhet parë edhe kontributi i shkrimtarëve më me stazh si M. Kuteli, Arif Gjyli, M. Zaloshnja, që bënë një punë të mirë përmësuese të populizimin e letërsisë së pasur të popullit përmësuese të rinj, ose përmes ritregimit, në formë të përshtatshme, të rapsodive dhe baladave të moçme shqiptare, ose përmes përpunimit të përrallave popullore dhe tregimeve të tjera të kësaj natyre. Në traditën e re hyjnë edhe kriteri i vlerësimit, tek i cili u mbështetën shkrimtarët B. Dedja, M. Gurakuqi, Arif Gjyli, M. Zaloshnja dhe N. Jorgaqi përmëtë mbledhur dhe redaktuar veprat e disa autorëve të shquar të së kaluarës përmësuese të rinj". Dhe përmëtë vijuar mendimin e mësipërm, me atë që një studiu jetët e quan absorbim të folklorit, gjëjnjë nga ai këtë formulim, formulim që gjennë mbështetje në marrëdhëni të ndërsjellët të krijimit letarë dë folklorit: "Një pjesë shumë e konsiderueshme e vjershave me subjekt ose e poemave të De Radës, Darës, Serembës, Sakos, Çacit, Jakovës, Siliqit, Balës, Qafëzezit, Çomorës, Gjylit e më vonë akoma Agollit, Kadaresë, Arapit, Dede, Beqarajt e Gjokutajt, dëshmojnë përmëtë lidhjet e qëndrueshme të poezisë sonë përmësuese të folklorin, përmëtë absorbimin që i kanë bërtë të gjithë këtë poetë folklorit përmëtë nevojën e përhershme që atë kanë ndier përmëtë tu dhënë fëmijëve të brezave të ndryshëm vargje, ku njomështia dëshirat popullor të ndihmen me po atë forcë që i ka edhe populli".

Në më shumë studiuesve, gjykimet dë interpretimet e Prof. Vehbi Balës përmëtë këtë model krijuesi, sikur kanë hyrë më në thellësi të procesit krijues të tij, gjë që kanë sjellë më njohje dë interpretimet të veprës letarë. Mendoj se edhe sot, atë janë aktuale në shkrimit dë zhërbërimin e figurës së Arif Gjyli në këtë lëmë letarë, lëmë që mbart vlera bashkëjetuese e bashkudhëtuese. Kjo është arsyet që studiuesi i mirënjohur i letërsisë përmësuese të rinj Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi në vepren e tij, me të drejtë ndihmesën letarë si parësore të shkrimtarit Arif Gjyli e vendos te kapitulli "Përshtatja dë rikrijimi", ku e pozicionon vlerësueshëm dë meritueshëm, duke e lidhur emrin e tij me lëvrimin e këtyre dy zhaneve (veçanërisht me të parin), qëllimi i të cilës (dhe të tjerëve krijues që u morën me këto dy zhane), është: "... që ta bëjnë të kuptueshme e të këndshme përmëtë lexuesin e vogël një krijim madhor të folklorit ose një vepër të shquar të letërsisë përmëtë rriturit".

# INKURISION HAPËSINOR DHE KOHOR


(Mbi veprën "Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar" të autorit Flamur Doli)

**Dr. Ali MUKA**

Diku në faqet e para të veprës së tij "GJURMË E GJURMIME", akademiku inderuar Prof. Mark Krasniqi pohon se: "Dashuria ndaj popullit nuk mund të jetë e sinqertë nëse nuk çmohet dhe duhet kultura e tij". Gjatë leximit të përshpejtuar të librit të Flamur Dolit, "Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar", ndjeva që në sfond të tij qëndron thënia e mësipërme. Pra, dashuria për arritjet e popullit të vet, është motoja që e ka udhëhequr autorin në tërë punën dinjitoze që ka bërë për realizimin e kësaj monografie. Pa marr përsipër një shqyrtim të gjerë e analistik, do të përpinqem të ndalem në ndonjë aspekt të librit, i bindur se do të mbetem borxhli ndaj autorit, dhe mundit që ai ka derdhur në këtë vepër.

Cilido që është marrë me studimin e arkitekturës popullore shqiptare, konstaton se ndërsa janë relativisht të shumtë artikujt studimore, numri i monografive është relativisht i pakët. Veçanërisht kontributet në këtë aspekt kanë dhënë doktorët e shkencave E. Riza, P. Thomo e akademiku M. Krasniqi. Monografive të botuara deri tani u shtohet edhe monografia për të cilën po flasim. Vështruar gjerë, ajo është një vazhdim e plotësim i tyre, por njëherazi ka karakter të theksuar individual. Ky individualitet qëndron tek treva që vë në qendër të vëmendjes. Një tematikë e tillë e pasqyruar në tërë strukturën e monografisë, e rrokur sipas një kënd vështrimi të vetin, duhet thënë se takohet për herë të parë në këtë gjerësi trajtimi analistik në literaturën tonë të kësaj fushe. Aty spikat përvoja e arkitektit që e sheh krijimtarinë e popullit të vet si një organizëm të gjallë dhe kërkon t'i prekë me përkushtim dhe me profesionalizëm çdo damar të tij.

Përvoja e arkitektit, madje edhe projektuesit restaurator, siç kuptohet më së një herë në libër, nuk do të mjaftonte, po të mos ishte e kombinuar me njohuritë e studiuesit, me njohuritë e historianit të arkitekturës. Në libër ndjen shqetësimin e autorit e njëherazi përkushtimin e tij se në këtë



fushë studimore vështirë të realizosh objektivat që i vë vetes pa gjurmim ngulmues në terren. Është ky gjurmim në terren dhe materiali i mbledhur që e bëjnë veprën të argumentuar e bindëse në tërësinë e saj. Mjaftë të kujtojmë që në 220 faqe libër, autorri sjell mbi 100 skica të natyrave të ndryshme, përveç fotografive. Dhe kjo nuk është veçse "maja e ajsbergut", pasi siç dëshmohet edhe në shumicën e fusnotave të sjella, lexuesit i jepen adresat konkrete edhe të rrith 200 objekteve të tjera në të cilat autorri ka konstatuar dukurinë që shqyrton. Vëmendjen në monografi ta tërheq edhe niveli i lartë me të cilin është paraqitur aparati grafik, i realizuar nga vet dora e autorit. Kjo ka ngritur ndjeshëm cilësinë e monografisë, dhe kjo jo e kuptuar thjeshtë në vështrimin estetik formal, por duke e vlerësuar çdo skicë si dokument me vlera autentike.

Një dukuri tjetër që ia tërheq vëmendjen lexuesit të kësaj monografie, është angazhimi i

autorit për të bërë inkursione jo vetëm hapësinore brenda e jashtë Kosovës dhe Shqipërisë në tërësi, por edhe inkursione kohore, duke kaluar nga ditët tona deri në periudhën ilire, madje edhe në ballafaqim me elemente të arkitekturës klasike greke. Dhe ky angazhim nuk buron thjeshtë nga ndjenja e dashurisë për "të vetën", po e ka bazën në kulturën e gjerë të autorit dhe në bindjen e tij se ballafaqimi me logjikë e objektivitet është shumë më i shëndetshëm se heshtja ose anashkalimi.

Njëherazi autorri nuk e mohon, por përkundrazi e pranon se popujt gjithmonë japid e marrin midis tyre, duke kontribuar kështu secili me mundësitet, trashëgimin dhe potentialin e vet në thesarin e përgjithshëm të kulturës. Ai pohon se pushtimi turk sado i gjatë nuk ka arritur të imposhtë vitalitetin krijues të popullit tonë. Në fokusin e shqyrtimeve të tij, në të dy pjesët e monografisë, autorri nuk vë vetëm banesat

fshatare apo qytetare në trevën e Kosovës, por shtrihet dhe sjellë prova e argumepte edhe nga shembujt konkret të gjinive të tjera të arkitekturës të kësaj treve, nisur nga mendimi logjik se, në fund të fundit, ndërtues i tyre ka qenë mjeshtri shqiptar. Kështu në morinë e shembujve nuk mungojnë ndërtim kulti, apo shoqërore e deri komplekse nga pazaret, por edhe ndërtimë ndihmëse e ekonomike si koshat apo mullinjtë e blojës.

Ndonëse ndalet gjatë tek banesat me çardak të ndërtuara në disa qytete të Kosovës, më duket (dhe autorri të më falë sinqerisht nëse e kam keq kuptuar) se pika "më e dobët" e tij mbetet kulla e Rrafshit të Dukagjinit. Dhe kjo nuk është rastësi. Duke u ndalur te kulla si banesë, autorri thekson vlerat që ajo bart në brendësi, për sa i përket kulturës së banimit. Njëherazi, duke dashur të na kujtojë filozofinë që ajo bart, thekson se ajo gjithmonë e përkëdo mbetet simbol i qëndresës shqiptare dhe pse jo edhe simbol i krenarisë sonë komëtare. Mendimi i autorit se ka fshatra të Kosovës, në të cilën mbizotëron ende si banesë kulla dhe për këtë ato duhet vënë në mbrojtje tërësore, më duket shumë i drejtë. Madje, njërin prej tyre që përmend autorin, kam pasur rastin ta vizitoj shumë shkurt para 16-17 vjetësh. Fjala është për Nivokazin (Gjakovë).

Vepra nuk rrjedhë qetë e qetë, pra, si të thuash, nuk përshkohet thjeshtë nga logjika e ftohtë e studiuesit a specialistit dhe aq. Përkundrazi, mbi logjikën e ftohtë të studiuesit ndjehet diku-diku edhe fuqishëm, zëri i intelektualit patriot, për dëmet fatale e të pakorrigueshme që ka pësuar e po pëson trashëgimia në këtë fushë të trashëgimisë së popullit, si rezultat i qëndrimit antihuman e antikulturorë të serbomëdhenjeve. Dhe zëri i këtij intelektuali në faqet e monografisë nuk është çjerrës e zhurmues, por sa njerëzore i thellë aq edhe i argumentuar e bindës. Ai me dhimbje pohon se perla të arkitekturës janë zhdukur e zhduken në Prizren e Pejë, në Prishtinë, Gjakovë e Mitrovicë etj., pa lënë në harresë fshatin kosovar dhe pasurin e tij në këtë fushë.

Petro Janura, figure e shquar e kulturës shqiptare

# FIRMMËTAR I AKTIT TË NJEHËSIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE

Studimet e larta i kreua në Fakultetin Juridik në Bukuresht ku ishte njëri nga anëtarët më aktiv të klubit letrar të studentëve. Këtu u njoftoh me Asdrenin, Kutelin e Viktor Eftimiun me të cilët zuri miqësi



Nuri PLAKU

Petro Jorgji Janura është një nga personalitetet më të rëndësishëm të kulturës shqiptare në Maqedoninë e Veriut, mbas Luftës së Dytë Botërore. Pedagog, shkrimtar, studjues dhe përkthyes, ai imbetet një nga intelektualët më të rëndësishëm të kësaj periudhe, i cili ka lënë gjurmë të pashlyera në memorjen e kombit shqiptar.

Petrua u lind në Manastir më 03/05/1909 nga prindërit Jorgji e Vasilika Janura. Që në fëmijërinë e tij të hershme, familja u larguan nga vendlindja dhe u vendos në Fier, në lagjen Bejlik. Sipas rregjistrat të gjendjes civile Fier, kjo lëvizje është bërë më pas vitit 1916, pasi në këtë vit po në Manastir ka lindur edhe vëllai i tij, Koço Janura. Në Fier, Petrua mbaroi ciklin e arsimimit fillor, në shkollën Nr. 1 në Bishanakë, ndërsa ciklet e tjera i vazhdoi në Jashi e Dimbravenë të Rumanisë. Studimet e larta i kreua në Fakultetin Juridik në Bukuresht ku ishte njëri nga anëtarët më aktiv të klubit letrar të studentëve. Këtu u njoftoh me Asdrenin, Kutelin e Viktor Eftimiun me të cilët zuri miqësi.

Gjatë kësaj periudhe bashkëpunoi me revistën "Shqipëria e re" të Zoi Xoxes që dilte në Kozenç, duke nënshkuar me pseudonimin Mefistofoles. Nga këto botime, veçojmë punimin me titull: "Mbi frymën mediterrane të Ballkanit", ku trajtohet tema e autoktonisë së shqiptarëve dhe interferencat e tij me popujt e tjerë të Ballkanit.

Më vonë, në fillim të Luftës së Dytë Botërore, Janura shkoi në Piza të Italisë, ku mbrojtë doktoraturën me temë: "Ndikim i zakoneve popullore në të drejtën qytetare". Pas marjes së gradës shkencore, u kthye në Fier, por këtu nuk gjjeti punë dhe në vitin 1942 u detyrua të largohet për në Gostivar, ku u emërua në gjykatën e këtij rajon. Në një vit të vitit 1943 u trasferua në Tetovë dhe në prill të vitit 1944 u arrestua nga Gestapua dhe u internua në kampin famëkeq të Prishtinës. Nga kampi doli më 15 njëntor 1944, kur rojet gjermane u larguan prej tij.

Pas daljes nga kampi, dr. Janura vajti në Shkup, ku do rrinte përgjithmonë, deri në fund të jetës së tij. Përket që këtu zyrtarizohet veprimtaria e tij publicistike, e cila zë fill me hapjen e gazetës së parë në gjuhën shqipe, "Flaka e vëllazërimit", organ i Frontit Popullor të Maqedonisë. Numri i parë i kësaj gazete doli më 4 prill të vitit 1945 dhe dr. Janura u emërua kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i saj. Ndërkohë, ai u aktivizua gjérësisht edhe në Radio Shkupi që u hap paralel me "Flakën".

Krahas gazetarisë, në vitin 1948 filloj edhe karierën arsimimore, duke u emëruar mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Shkollën normale "Nikolla Karev" të Shkupit. Në vitet

1949 deri më 1951 u transferua në Akademinë e Shkencave dhe Arteve në Zagreb, ku punoi si bashkëpunëtor i Akademisë Jugosllave të Shkencave dhe Arteve, për përgatitjen e fjalarit serbokroatish - shqip të Henrik Bariqit. Pas kthimit të tij në vitin 1951, u emërua pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin Filozofik dhe pedagog i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën normale shqipe "Zef Lush Marku" dhe në Institutin e lartë pedagogjik, Kliment Ohridski" të Shkupit. Në punë të madhe këmbëngulëse bëri dr. Janura përfundon e Katedrës së Gjuhës e Letërsisë Shqipe në Fakultet Filologjik të Shkupit, e cila u realizua në vitin 1971. Si themelues i kësaj katedre, dr. Janura u emërua dekan i saj. Ai kontribuoi gjithashtu edhe për themelin e Shoqatës së Shkrirtarëve të Studentëve Shqiptar pranë këtij Universiteti, e cila me propozimin e tij u pagëzua "Migjeni".

Krahas mësimdhënies, në fushën arsimore dr. Janura u dallua edhe si autor i disa teksteve shkollore dhe hartimit të programeve mësimore në rang republike nga niveli fillor e deri tek ai universitar. Sipas shënimve në Leksikonin e Shkrirtarëve Jugosllavë, ai është hartues i dhjetë teksteve shkollore, midis të cilave edhe Leximi letrar për klasën e II të shkollave të mesme.

Në fushën studimore, dr. Janura ka botuar mësue 200 artikuj, të cilët përfshijnë një spektër të gjerë tematik, që nga historia e gjuhës shqipe, dialektologjia dhe gjyha bashkëkohore shqipe, letërsia popullore e deri te historia e letërsisë shqipe. Në disa punime ai merret me zhvillimin historik të leksikografisë shqipe, me fjalëformimin, sufisët normiale, etj. Në vitin 1969, realizoi punimin më të gjerë të kësaj fushe me titull "Historia e alfabetit shqip", në të cilin jep një pasqyrë historike të alfabeteve të ndryshëm që janë përdorur gjatë shekujve ndër shqiptarët.

Gjohësia për dr. Janurën përbënte një problem të rëndësishëm për njehsimin e saj në gjuhë letrare, të unifikuar në Shqipëri dhe gjithë trojet shqiptare joashtë kufijve të shtetit shqiptar. Në vitin 1959 Komisioni përkakfa nacional të LSPMP-së, angazhoi një grup ekspertësh për të hulumtuar çështjen e gjuhës letrare për shqiptarët e RSF të Jugosllavisë i cili përbëhej nga: Dr. Petro Janura, Murteza Peza dhe Krume Jakovski. Në fund të një studimi prej 63 faqesh, grupi doli me propozimin që: "shqiptarët kudo që jetojnë të kenë një gjuhë të vetme letrare, e cila duhet të ishte gjuhë letrare që zbatohej në RP të Shqipërisë".

Në vitin 1972 dr. Janura mori pjesë në Kongresin e Drejtëshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë dhe është firmëtar i aktit të njehsimit të gjuhës letrare shqipe. Në kontribut të rëndësishëm ka dhënë ai veçanërisht në fushën e historisë së letërsisë shqipe ku futen studimet mbi përfaqësuesit e "Nea akademisë" së Voskopojës, studimet mbi opusin e poetit kombëtar Naim Frashërit, Ndre Mjedës, Migjenit, gjurmët e ndikimit të Eminësikut tek Asdreni, një serë artikujsh prezantues të autorëve shqiptar dhe botërorë etj.

Në vitin 1968, në numrat 4 dhe 5 të revistës "Jehona" ai batoi studimin "Sintezë ndërgjegjeje kombëtare nëpër punën dhe fytyra e Gjergj Kastriotit në "Historia e Skënderbeut" e Naim Frashërit, të cilin e kishte punuar në Zagreb gjatë viteve 1949 - '51. Në këtë studim ai pretendonte se "Historia e Skënderbeut" e Naim Frashërit i plotëson të gjitha kushtet për të qenë "epope e dalur nga jeta historike e shqiptarit në shekullin e XV - XVI". Ai e mbështet këtë ide, me faktin shkencor se të gjitha ngjarjet e veprës kanë vetëm një personazh kryesor, Skënderbeun. Naim Frashëri quan "poet madhor i cili ka kaluar që me gjallje në ndërgjegjen estetike të shqip-

tarëve." Ndërsa portretin e Skënderbeut e vlerëson të dhënë, në përpunje të plotë me orientimin filozofik të Aristotelit, "me virtutin e bujarisë e me atë të konsekuençës." Nga kjo pikparje, konklodon ai, Skënderbeu i Nairnit është e do të jet përgjithmonë një figurë bashkëkohore, i paisur me virtute shërbimullore që janë argumente të përhershme për "stoicizmin e shpirtit e të fizikut të shqiptarit, të guximit e të trimërisë, të inteligencës dhe sensibilitetit të kombit tonë, që me fytyrën e Skënderbeut ato u vërtetuan botëni, e sjanë ma mësheftësi të jetës." Në këtë fokus ai e zgjeron analizën e veprës edhe në rrafshin krahasues me dy autorë të tjera të Heroit tonë Kombëtar: Barletin dhe De Radën. Barleti shkroi në latinisht sipas parimeve të humanizmit, por këtë gjuhë nuk e njihuni masat, that ai, ndërsa Naimi e shkroi në gjuhën e masave dhe në vargje. Për veprën "Skënderbeu i pafam" të De Radës, botuar në vitin 1877, ai thotë se autori nuk e ka ngritur heroinë në ato dimensione që të gjera sa tek veprat e Nairnit.

Në jetët punim i rëndësishëm i dr. Janurës, është edhe monografia kushtuar Migjenit. Vepra ka 328 faqe dhe është botuar në vitin 1982 në "Flaka e vëllazërimit". Këtë punë studimore kaq të gjerë për Migjenin, autori e filloi në vitin 1955 dhe e vazhdoi me ndërpërje për 25 vjet, deri në vitin 1975 kur ajo mori formën e saj të plotë. Dr. Janura është ndryshëm studjuesit e tjerë të Migjenit, parapraktikisht të tij, e sjell figurën e poetit në mënyrë të gjithanëshme e shteruese, duke nisur nga hulumtimi në detaje i jetës së tij personale dhe familjare, e deri në analizën e plotë të veprës me gjithë gamën e ideve letrare e filozofike të saj. Interesante është veçanërisht jeta shkollore e poetit në Manastir ku autori e ka pasuruar me intervista nga shokët e Migjenit, të cilët flasin me superlativa për të. Metodi Gogovi, p.sh., profesor në Fakultetin teologjik të Shkupit, shok i një banke me Migjenin, thoshte: "Miloshi ynë dhe poeti juaj bëhej autoritet spontan për të gjithë ne nxënësit. Të gjithë ne shokët e tij jemi të lumenjt, por mjerisht s'ia njohim veprën. I lumtur është njeriu i popullit të tij. Ai është krenar që e ka dhe me shumë të drejtë, çdo njeri i çdo populli do krenohej me Migjenin tuaj, sikurse ne maqedonasit që krenoheri me Koço Racinin tonë. Lum popull që kan poëtë të tillë." Ndërsa Llambe Tasevski, një jetët shok i ngushtë i Migjenit, thoshte: "Miloshi ishte një pasuri për të gjithë, e sidomos për shokët e tij shqiptarë që kishin vështirësi me gjuhën serbokroate."

Në dimensionet tjetër i aktivitetit intelektual të dr. Janurës, është edhe kritika letrare ku ai trajton probleme bashkokore të shkrirtarëve shqiptar në ish Jugosllavi e Shqipëri. Në vitet 1956 - '57 në "Flaka e Vëllazërimit" ai batoi një numër studimesh për veprat e Rexhep Hoxhës, Mark Krasniqit, Anton Çetës, Sinan Hasanit, Latif Berishës etj. Në këtë shkrime, ai ngrinte dy probleme të rëndësishme për kohën: së pari, problemi i originalitetit të një variantë së tilla i tilla i gjithë shqiptarëve, duke shkruar në vazhdën e letërsisë shqipe, duke shkruar në vazhdën e letërsisë shqipe, kishte filluar t'i shumangej autoktonisë dhe së dyti, problemi i sinkronimit të realitetit social me të kaluarën historike të popullit, duke parë këtë unitetin e sinkronisë me diakroninë. Shkrimet kritike të dr. Janurës u bën objekti i polemikave dhe diskutimeve të shumta, çka tregonte se ai kishte trajtuar një çështje vitale e cila në këtë kohë e preokuponte ndieshëm botën shkencore shqiptare.

Në fushën e përkthimeve, dr. Janura ka sjell disa nga autorët e rëndësishëm botërorë si: Hornerin, Lesingun, Turgenievin, Reblinë, Shekspirin, Krillovin, Gëten, Rusonë, Volterin, Dikensin, Leopardin e shumë të tjera. Ndërsa nga autorët maqedonas, për lexuesit shqiptar

ka sjellë: Gjergj Puleskin, Grigor Përljevin, Drimklliskin, Koneskin dhe Kunoskin. Por, vepra e tij më e rëndësishme është përkthimi i romanit "Përmallimi i kurbetçinjve" i Milisav Antonijeviq - Drimkolskit, botuar në Prishtinë në vitin 1958.

Një jetët kontribut të rëndësishëm ka dhënë dr. Janura edhe në fushën e folklorit, ku ka mbledhur një material të bollshëm shkençor veçanërisht për baladat. Me një vështrim të hollë e të mprehtë ai ka mundur të hulumtoj dhe analizojë në mënyrë karashasimtare trashëgiminë etnografike të popujve të Ballkanit e të nxjerrë prej tyre elementë specifike të autoktonisë. Në studimin me titull "Bashkëshortja e shitur për shkaqe ekonomike në letërsinë popullore shqipe dhe maqedonase," botuar në revistën "Jehona" në vitin 1980, ai trajton shtratin ballkanik të kësaj balade, e cila ka rreth 200 variante me elemente interesante që hasen në letërsinë popullore balkanike. Fabula e kësaj balade tregon se burri, kryefamiljari, për të shlyer borxhin që ka ndaj fajdexhiut (çifutit), herë - herë të trashëguar edhe nga iati, shet gjithëçka deri edhe bashkëshorten e tij. Gruaja e shitur në momentin e marrëdhënies me blerësin, njeh se ai është vëllai i saj, i cili e rikthen tek i shoqit dhe ia fal atij lekët për shlyerë e borxhit. Në letërsinë popullore shqiptare kjo baladë njihet në dy variante: Luto Fukaraja dhe Ali Borxhaliu.

Në të gjitha variantet e kësaj balade, dr. Janura ka evidentuar dukshëm elementët e përbashkët midis tyre si: nderin e burrit e familjes, etikën, humanizmin, përvuajtjen shpirtërore, fjalën e dhënë dhe varférinë e tejskajshme ekonomike. Kjo baladë ka rëndësi edhe përfaktin se tregon që popujt e Ballkanit me shekuj kan bërë jetë të përbashkët dhe në të njëjtat kushte e rrethana ekonomike.

Nëpërmjet krahasimit, dr. Janura nxjerr në pah originalitetin e se cilët përfaktin me gjithë gjithëçka deri edhe bashkëshorten e tij. Gruaja e shitur në momentin e marrëdhënies me blerësin, njeh se ai është vëllai i saj, i cili e rikthen tek i shoqit dhe ia fal atij lekët për shlyerë e borxhit. Në letërsinë popullore shqiptare kjo baladë njihet në dy variante: Luto Fukaraja dhe Ali Borxhaliu.

Dr. Janura interpreton edhe vjetërsinë e kësaj balade të cilën e çon deri në shek. XV, me argumentin se variante të tilla i gjejmë edhe te arbëreshët e Italisë. Ndërsa origjinën e saj e lidh me rregullat ushtarake turke, të cilët merrnin nga zonat e tyre të pushtuara fëmijët të vegjil dhei i bënëjenjen.

Dr. Janura u nda ngajeta më 30 gusht të vitit 1983, duke lënë mbrapa tij një emër të madh e të nderuar në fushën e gazetarisë, arsimt dhe kulturës shqiptare në Maqedoni. Për kontributin e tij publicistikë, pedagogjik e shkencor, ai është nderuar me shumë diploma, mürënjojje e dekorata si: Dekorata e "Vëllazërim - bashkimit me Kurorë të Artë", Dekoratën e Republikës me Kurorë të Artë, Shpërbllimi "11 Tetori," etj.

Emri i tij përkujtohet nga publiku me nderim e reprekët për veçantë në përvjetorë e ngjarje të ndryshme kulturore, veçanërisht në jubilet e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare.

Por mjerisht, në qytetin e Fierit, që është qyteti i tij i dytë, ku kaloi një pjesë të fëmijërisë, ku mbaroi shkollën filllore, ku banoi familja dhe ku prehen prindërit e tij, emri i tij i vepra e dr. Janurës njihet fare pak ose aspak.

NUMRI I ARDHSHËM MË 1 PRILL

# HEJZA

20 MARS, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**  
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000